

SHËRBËTOR APO MIQ



Nga Graham Maxwell

Përmbajtja

Parathënie	3
1. A DO TË KISHE FRIKË NGA PERËNDIA?	4
2. UNË PREFEROJ QË JU TË JENI MIQTË E MI	6
3. NUK KA MIQËSI PA BESIM	10
4. BESIMI NUK MUND TË URDHËROHET	16
5. KUJDES NË ÇFARË BESONI	20
6. MIQTË FLASIN HAPUR ME NJËRI – TJETRIN	26
7. MIQËSIA DHE LIGJI	30
8. PIKPAMJË NDAJ SHPËTIMIT NGA SYTË TË SHËRBËTORËT DHE MIQTË	35
9. BESIMI DHE TRADHËTIA	41
10. MIKU MË I MIRË	44
11. LIRIA E MIQËSISË	49
12. MIQËSIA DHE LUFTA ME MËKATIN	53
13. MIQËSIA DHE DOMËTHËNIA E SHLYERJES	56
14. KEMI NDEJUR MJAFTË AFËR KËTIJ MALI	60
15. MIQTË TË NJË ZOTI MIQËSOR	63

Parathënie

A keni dëgjuar ndonjëherë për një mbret i cili deklaroi që ai nuk do t'i trajtoj vartësit e tij më si shërbëtorë? Përkundrazi, nëse ata kanë dëshirë, ai do t'i trajtojë si miq të ngushtë. Mbreti do që njerëzit ta kuptojnë qartë që ai nuk ka dëshirë për bindje të verbër dhe të



pamenduar të skllavërisë. Ai preferon bashkpunim inteligjent nga një vullnet i lirë. Dhe për ta bërë këtë të mundur, ai ofron që të informoj mirë njerëzit e tij për punën e qeverisjes së tij.

Bibla na kujton se Jezusi faktikisht ka bërë një oferte kaq të pabesueshme dishepujve të Tij para se Ai të kthehej në Qiell.

“Unë nuk ju quaj më shërbëtorë,” Jezusi tha: “por unë ju kam quajtur miq, sepse dua që ju të kuptoni.”

Ai që Bibla përshkruan si “Mbret i mbretërve dhe Zot mbi zotër” preferon të na quaj miq se sa shërbëtorë. Për mua ky është lajmi më i mirë në të gjithë Ungjilin.

Mendoni çfarë kjo na tregon se çfarë Përsoni është Perëndia dhe se si do të ishte të jetoje më një Zot të tillë në përjetësi.

Tema kryesore e 66 librave të Biblës është që të tregojë të vërtetën rreth Perëndisë.

Gjoni 15:15 është çelësi për të kuptuar të gjithë Shkrimet dhe planin e Zotit për të restauruar paqen në Universin e Tij. Perëndia po na ofron miqësinë e Tij.

1. A DO TË KISHE FRIKË NGA PERËNDIA?

Unë pyeta një varrëmihës Skocez: “A do të kishe frikë të takoje Perëndinë?”

“Po, jasht mase!”

“Pse kështu?”

“Për shkak të gjithë atyre historive të tmerrshme në Bibël.”

Unë pyeta një zonjë të moshuar e cila gjithë jetën e saj ja kishte përkushtuar mësimin të Biblës fëmijëve.

“A do të kishe frikë të takoje Perëndinë?”

“Jo, aspak.”

“Pse jo?”

“Për shkak të gjithë atyre historive të bukura rreth dashurisë së Perëndisë.”

“Po për historitë e tmerrshme në Bibël?”

“Ne nuk përqendohemi në aspektet mizore të Shkrimeve. Ne preferojmë të theksojmë historitë që na tregojnë dashuri.”

“Po për liqenin e zjarrit në librin e Zbulesës?”

“Oh, me fëmijët ne nuk e lexojmë librin e fundit të Biblës.”

“Po për historinë e Zanafillës rreth përmytjes kur Zoti përmyti të gjithë njerëzit përveç tetë vetave?”

“Oh, fëmijët nuk kanë vështirësi me këtë. Ata kanë një shqisë të fortë drejtësie dhe ata veçanërisht pëlqejnë se si Perëndia i shpëtoi ata të tetë në arkë.”

Varrëmihësi dhe mësuesja e Biblës nuk e kishin larguar krishterimin për shkak të historive të tmerrshme në Bibël.

Megjithatë, për shumë të tjerë “aspektet mizore të Shkrimeve” kanë qënë shkak për largimin e tyre nga kisha dhe Perëndia. Shumë njerëzve i duket e pamundur t’i besojnë një Perëndie që kërkon bindje duke kërcënuar ata me vuajtje të përjetshme.

Një grua tha: “Perënditë e feve të tjera janë më pak mizore se sa perëndia i Dhjatës së Vjetër!”

Shumë njerëz ashtu si kjo grua e kujtojnë me tmerr vetëm atë perëndi që ata kanë njohur në fëmijërinë e tyre, dhe asnjë perëndi i besueshëm nuk ka zënë akoma vëndin e tij.

Njerëzit e familjeve të cilëve dikur kanë gjetur ngrohtësi dhe miqësi në kishë tani për të njëjtën arsye shkojnë në lokale.

“Pse janë kishat kaq bosh dhe lokalet kaq plot me njerëz?”

“Ndoshta shërbim më i mirë,” tha një burrë.

Shumë njerëzve i’u është thenë që nënat dhe gjyshërit e tyre ishin kujdesur që ata të shkonin në shkollën e Biblës çdo të dielë. Por ndërsa ata rriteshin, pyetjet pa përgjigje i zhgenjyen ata me Biblën, kishën dhe Perëndinë.

Në Britani, shteti që ka bërë kaq shumë për të shpërndarë Shkrimet e Shenjta në të gjithë botën, një pronar librerie tha: “Jam me fat nëse shes dy Bibla në vit!”


Shumë njerëz dëshirojnë që të mund të besojnë

Por edhe pse njerëzit përshkruajnë mosbesimin e tyre, unë ndjeva një mall sikur të ekzistonte Dikush që t’i besoja, një Perëndi veprimet e të Cilit të kishin kuptim.

“A do të doje të besoje sërisht?”

“Po!” Ishte përgjigja e drejt për drejt e një komentatori Irlandez, i cili në fëmijërinë e tij kishte shkuar të paktën në 3 kisha çdo të dielë dhe akoma kujtonte vargje biblike përmëndësh. “Por fatkeqësisht nuk ka asnjë provë.”

Unë fola me një motoçiklist muskuloz i cili tha që kurrë nuk kishte besuar në Zotin.



“A ke lexuar ndonjëherë Biblën?”

“Jo.”

“A ke shkuar ndonjëherë në kishë?”

“Jo.”

“Kur ne do të jemi në fund të jetës sonë, do të shikojmë nëse do të jetë Dikush në anën tjetër.”

“Kështu është.”

“Nëse ti zbulon që me të vërtetë ka një Perëndi, si mendon a do të kesh frikë?”

“Jo. Nëse ka një Perëndi, jam i sigurt, ai është si një prej nesh.

Por ferri nuk ekziston. Ferri janë njerëzit. Njerëzit që nuk janë të ndershëm me njeri-tjetrin.”

Shumë njerëz që vertetojnë mosbesimin e tyre, akoma flasin për një siguri të vakët që ekziston një fuqi e largët por e mirë. “Një prezencë mirëdashëse e gaztë” ishte përshkrimi i një nëne të re.

Unë takova një familje prej katër vetash duke shetitur në Plazhin Veriperëndimit të Anglisë. Nëna foli me trishtim rreth braktisjes graduale të besimit të Krishterë të tyre.

“Zoti dhe kisha janë tepër larg,” shpjegoi ajo. “Ata nuk kanë më kuptim.”

Edhe pse ata kishin vite në kishë, asnjëri prej tyre nuk mbante mënd as edhe një histori nga Bibla.

Nëse do të kishte një Perëndi të cilin ju mund ta adhuronit sërish, si duhet të jetë Ai?”

Lorena, 11 vjeçare, u përgjigj: “Ai duhet të jetë dikush që unë mund t’i besoj, dikush që nuk do të më zhgënjejë.”

A ka ndonjë që ne mund t’i besojmë?

Citimet e Shkrimeve nuk do të ndihmojnë. Pamja biblike e Perëndisë, ashtu siç e shohin njerëzit, është ajo çfarë i ka bërë të dyshojnë. Dhe tregimet rreth dashurisë së Perëndisë nuk do të mjaftonin për të mbuluar ato të tmerrshmet.

Bibla ka humbur autoritetin e saj në sytë e njerëzve mendimtarë sepse jo gjithmonë duket e kuptueshme. Njerëzit shikojnë Zotin si “kontradiktor, arbitrar dhe mizor”.

Njerëzit thonë: “Përse ne nuk mund të mbajmë vlerat e Krishtërit, si p.sh. Të duash të afërmin tënd si vetveten, por pa e adhuruar Perëndinë e të Krishterëve?”

Jo shumë kohë më parë, Mbretëresha Elizabet publikisht ka deklaruar vezhgimet e saj që britanikët nuk vlerësojnë asgjë më shumë se sa lirinë dhe individualitetin.

Për shumë shekuj ata kanë mbrojtur – edhe me jetën e tyre – lirinë për të adhuruar në kishë sipas zgjedhjes së tyre. Në kohën tonë shumë njerëz përdorin këtë liri për të mos shkuar më në kishë.

Shpesh herë Perëndia, Bibla dhe kisha janë parë jo si një kërcënim i lirisë, por si diçka e papërfillshme, si diçka që i përket kohëve kur aristokratet drejtonin duke abuzuar supersticionin e të varfërve. Zoti dhe kisha nuk konsiderohen pjesë e jetës moderne.

A është ky fundi i epokës së Krishtërit?

Ka njerëz që mendojnë që – nuk ka nevojë për të shkuar në kishë për të qënë një njeri i mirë. Ata besojnë që janë njerëz të mirë dhe nuk ndejnë nevojë për Perëndinë.

Disa thonë: “Unë kam besuar kur kam qënë fëmijë. Tani që jam rritur, nuk shikoj kuptim në Bibël dhe nevojë për Zotin.” Zoti për ta është si Babagjyshi i Vitit të Ri – ka qënë e bukur të besosh në të, por jeta e të rriturve ska vënd për mrekulli.

Duhet të jetë një zhgënjim i madh për Perëndinë që kaq shumë njerëz të ndershëm në të gjithë botën e lidhin Atë me kohët më pak të lira dhe më pak të civilizuara.

Cila qeveri mund të jetë më e civilizuar dhe cila shoqëri më e lirë se ajo e drejtuar nga Perëndia e Gjonit 15:15?

“Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, por unë ju kam quajtur miq, sepse dua që ju të kuptoni.”

2. UNË PREFEROJ QË JU TË JENI MIQTË E MI

Jezusi u foli dishepujve të Tij në gjuhën Aramaike. Gjoni u shkruajti atyre në greqisht dhe këtu është një përkthim i saktë në shqip: “Unë nuk ju quaj më shërbëtorë [në greqisht faktikisht “skllëvër”], sepse shërbëtori nuk e di se ç’bën i zoti; por unë ju kam quajtur miq, sepse ju bëra të njihni të gjitha gjëra që kam dëgjuar nga Ati im.”

Vini re dallimin që bëri Jezusi midis të qënurit një shërbëtor dhe një mik. Shërbëtori nuk ka të drejtë të kuptoj punët e zotëris së tij. Ai duhet të bëjë vetëm atë që i thuhet. Pa pyetje dhe pa arsye. Vetëm “Në rrëgull, zotëri. Si të urdhëroni ju.”

Për ta bërë të qartë që Ai nuk do një bindje kaq të verbër, Jezusi u kujtoi dishepujve të Tij që Ai u ka treguar atyre gjithçka që kishte dëgjuar nga Ati rreth punës së Tij. Kjo e bënte të mundur për dishepujt që t’i jepnin Atij atë çfarë Ai donte – bashkpunim vullnetar nga miqtë e kuptueshëm.

A nuk do të ishte më e përshtatshme për ne – mëkatarët dhe vdekatarët e dobët – të ishim vetëm shërbëtorë që nuk pyesim?

Romakët 9:20 zakonisht është përdorur nga disa për të mbështetur idenë që shërbëtorët besnik nuk duhet të pyesin asnjëherë për rrugët e pahetueshme të Perëndisë.

Apostulli Pal këtu është duke u përgjigjur dukshëm një personi të hutuar dhe pa respekt:

“Po kush je ti, o njeri, që i kundërpërgjigjesh Perëndisë? A mund t’i thotë ena mjeshtrit: ‘Përse më bëre kështu?’”

Një përgjigje e tillë duket që do të ndalojë çdo përpjekje për të kuptuar. Dhe patjetër kjo duket si diçka tamam e përshtatshme për qëniet njerëzore.

“Vetëm na thuaj çfarë do që ne të besojmë dhe ne do ta besojmë. Vetëm na thuaj çfarë do që ne të bëjmë dhe ne do ta bëjmë.”

Por kjo është mënyra se si flet një shërbëtor dhe nuk përputhet me ofertën e miqësisë dhe të kuptimit në Gjonin 15:15. Është e rëndësishme, më tepër – thelbësore, të lexosh një varg biblik në kontekstin e tij.

Në tetë kapitujt e parë të letrës drejtuar Romakëve Pali ka shpjeguar që Perëndia ofron lirinë e miqësisë dhe shpëtimin e të gjithë atyre që vendosin të besojnë në Të. Të gjithë njerëzit janë ligjërisht të barabartë, pa dallim race, kombi, gjinie apo gjëndjes shoqërore – sepse Perëndia është Ati i të gjithëve ne.

“Por kjo nuk është e drejtë,” protestojnë disa nga dëgjuesit e Palit. “Zoti i ka bërë këtë ofertë atit tonë, Abraham, dhe vetëm pasardhësit e Abrahamit janë të autorizuar për një privilegj kaq të madh.”

Pali është dakord. Mëgjithatë ai sygjeron që jo të gjithë pasardhësit fizik të Abrahamit e kanë pranuar ofertën bujare të Perëndisë. Pasardhësit e vërtetë të Atit Abraham janë të gjithë ata të cilët ashtu si Abrahami kanë vendosur të jenë miqtë e besueshëm të Perëndisë.

“Kjo nuk është fare e drejtë!” vjen kundërshtimi.

“A jeni ju qenie njerëzore duke u përpjekur tu tregoni Perëndisë se si Ai duhet apo s’duhet të drejtojë universin e Tij?” është përgjigja e Palit në Romakët 9:20.

Perëndia, si Krijuesi i universit dhe i të gjithë neve që jetojmë në të, pa tjetër ka të drejtën të drejtoj sipas dëshirës së Tij. Lajmi i mirë është që Ai ka marrë një vendim të pandryshueshëm të qeverisë në një atmosferë lirie dhe miqësie dhe të gjithë fëmijët e Tij janë të ftuar të marrin pjesë.

Romakët 9:20 nuk është shkruar për të dekurajuar apo për të ndaluar pyetje të shprehura me respekt. Këtu shprehet një çudi që ndonjëri mund të jetë kaq i pafytyrë për të mos thënë irracional si për të sfiduar të drejtën e Perëndisë për të drejtuar universin e Tij në këtë mënyrë të mrekullueshme.

Sigurisht kjo duket shumë e çuditshme dhe e pakuptueshme se si ne vdekatarët mund të jemi miq me Qënien i cili është kaq pafundësisht madhështor sa që edhe Bibla përshkruan engjëj të fuqishëm duke u përlurur në prezencën e Tij? (Zbulesa 7:11-12)

Si mund të bëhemi miq të ngushtë me një Mbret kaq të fuqishëm? Apo ndoshta Jezusi është duke folur në Gjonin 15:15 për veten e Tij të përlurur dhe të afrueshme ndërsa Ai jetoi midis nesh? Ne dimë një këngë “Ç’mik na është Jezus Krishti”, por jo ‘Ç’mik na është Ati’ A mund të përfshinte Ai gjithashtu Atë që ne e quajme At?

Jezusi i kishte përgatitur dishepujt për këtë. “Nëse më keni parë Mua, ju keni parë Atin. Nëse keni besim tek Unë, keni besim tek Ati.” Ai e kishte treguar këtë përpara së Ai të bënte ofertën për miqësi. Pak më vonë Ai shtoi: “Vet Ati ju do.”

Kush është Jezusi, pra? Në shumë vende në Bibël Jezusi është përshkruar si Perëndi dhe Krijuesi. Por nuk ka tekst më të qartë se sa ai që është kënduar çdo Krishtlindje në “Mesian” e Hendelit. “Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë . . . dhe do të quhet. . . Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes.” (Isaia 9:5)

Ne e dimë se kush është Princi i Paqes. Ai është gjithashtu Perëndi i fuqishëm, dhe Atë i përjetshëm! Është Ai që preferon të na quaj miq se sa shërbëtorë.

“Kështu tha Perëndia” Kjo e vendos gjithçka?

A nuk duket sikur Bibla përmend më shumë shërbëtorët e bindshëm – e shoqëruar nga një list çmimesh dhe dënimesh? Kjo është e vërtetë.

Dhe duket që shumë besimtarë pëlqejnë pasazhet për shërbëtorët.



Kështu ata përpiqen të veprojnë ashtu si sipas besimit të tyre se si një shërbëtor i besnik duhet të veprojë. Ata nuk bëjnë pyetje. Ata nuk kërkojnë arsye.

Me tepër ata thonë: “Besimi nuk ka nevojë për arsye.” Ata përdorin atë ngjitesen e famshme të makinave - “Kështu tha Perëndia! Unë besoj atë! Kjo e vendos gjithçka!”

Ndër vite kanë qënë drejtues fesh të cilët kanë preferuar shumë këtë model të marrëdhënies së besimtarit me Perëndinë. Duke pretenduar të jenë përfaqësuesit e Perëndisë ata kanë zmadhuar autoritetin e tyre duke përdorur këtë koncept dhe duke kërkuar që ndjekësit e tyre të sillen si shërbëtorë besnik. Dhe mbani mend që shërbëtorët nuk pyesin “Pse?” Shërbëtorët nuk kanë nevojë për arsye. Shërbëtorët vetëm binden.

Xhim Xhons (në fotografi), drejtuesi i një kulti fetar i bindi ndjekësit e tij për këtë koncept dhe në bindjen e vërbër 900 prej tyre pinë cianur dhe 900 prej tyre

vdiqu. Ah, sikur disa prej tyre të kishin bërë pyetje, shumë nga anëtarët e Tempullit të Njerëzve mund të ishin akoma gjallë.

Por në besimin e verbër ata iu nënshtruan kërkesave të drejtuesit të marrë dhe sakrifikuën veten e tyre në vetvrasjen masive fetare e cila ndodhi në 1978 në xhunglën e Guajanës



“Jini miqtë e Mi përndryshe Unë do t’ju shkatërroj”?

Për të gjithë ata që kanë lexuar paralajmërimet e shumta të shkatërrimit në Bibël, natyrshëm lind pyetja: “Si mund të jemi miq me dikë që na kërcënon të na djegë për vdekje nëse nuk i bindemi? A është Zoti duke thënë, “Jini miqtë e Mi përndryshe Unë do t’ju shkatërroj”?”

Kur mbreti Nebukadnetsari tha, “Uluni në gjunjë, përndryshe unë do t’ju hedh në një furrë me zjarr përvëlues,” (Daniel 3) ai me të vërtetë po thonte: “Me tregoni se sa më doni përndryshe do t’ju hedh në zjarr.”

Mund t’i detyroni njerëzit të përuken në gjunj, por nuk mund t’i detyroni të jenë miqtë tuaj.

Më dashuro ose largohu prej meje!

Pak kohë më parë unë mora një kartolinë për Shën Valentin me maçokun e famshëm Garfilld. Garfilld është duke mbajtur zemrën e tij në duart dhe duke apeluar në mënyrë të bindshme: “Është zgjedhja jote... Duamë ose largohu!”

Pra kjo është mënyra se si ta fitosh një mik, apo jo? Por hape kartolinën dhe brenda ai kërcënon, “Vetëm po të bësh zgjedhjen e gabuar dhe unë do të të thyej këmbët!”

“Ji i dashuri im ose përndryshe t’i theva këmbët”? Qëllimi i kësaj fjalie ishte që të *tingëllonte* absurde.

Por si mund ta shpjegosh lajmërimin e frikshëm e engjëllit të tretë në Zbulesën 14 në lidhje me ofertën e miqësisë shkruajtur tek Gjoni 15:15? A po thotë Perëndia, “Ajo çfarë dua nga ju është dashuria dhe miqësia, por nëse Unë nuk e marr, do t’ju torturoj në përjetësi”?

A ju duket kjo tërheqëse dhe e bindëse? Apo është në rregull të pyesësh për kuptimin? Shërbëtorët nuk bëjnë pyetje. Miqtë po. Miqtë me respekt të thell pyesin: “Pse?”



Vetëm provo të pyesësh!

Unë kam një kartolinë tjetër të Garfilld ku ai duke kërcënuar me çekiç thotë: “Bëj provë të pyesësh!” Fatkeqësisht, disa mendojnë që Zoti thotë të njejtën gjë. Unë mendoj, që është më e rrezikshme të mos pyesësh, përndryshe ne mund t’i japin fund jetës duke pirë cianur me Xhim Xhons.

Mënyra biblike është të siguroj evidencën mbi të cilën miqtë kërkues mund ta bazojnë kuptimin e tyre. Kështu ju mund të prisni që Shkrimet e Shenjta t’ju ofrojnë shembuj që tregojnë se si Ati Ynë Qiellor trajton pyetjet serioze të fëmijëve të Tij.

Abrahami ishte quajtur miku i Perëndisë

Kur Zoti zbriti për të shkatërruar Sodomën dhe Gomorrën, Ai në fillim erdhi të miku i Tij i vjetër për t’i treguar rreth planit të Tij. (Zanafilla 18) A u përgjigj Abrahami: “Epo, kush jam unë që të pyes për rrugët e Tua të pahetueshme? Mirë, O Zot! Unë do të jem tek maja e kodrës për t’i parë ata duke u djegur”? Jo!

“O Zot, për aq sa të njoh Ty, Ti nuk do ta bëje nëse do të kishte 50 njerëz të ndershëm atje, ose 40, 30, 20 apo edhe më pak. Me fal, o Zot, nesë dukem i pafytyr, por a nuk duhet që Gjykatësi i gjithë tokës të bëjë atë që është e drejtë?” (Zanafilla 18:25)

A u përgjigj Zoti me inat: “Ky është fundi i miqësisë sonë. Unë asnjëherë nuk kam parë një sjellje të tillë”? Në të kundërtën!

“Ti duhet të jesh miku im i mirëkuptueshëm që të më flasësh në këtë mënyrë. Dhe Unë do të përdor si një shembull miqësie besnike në të gjithë Shkrimet e Shenjta.”

Dhe kështu, në të dy Dhjatat Abrahami është përmendur si miku më i mirë i Perëndisë. Ai që guxoi ta pyeste Zotin “Pse?”

Perëndia mund të fliste me Moisiun si njeriu flet me mikun e tij

Me vonë Perëndia i tha Moisiut: “Më kanë ardhur në majë të hundës këta njerëz. Hap rrugën dhe më lerë t’i shkatërroj. Dhe Unë do të bëj një komb të madh prej teje.” (Eksodi 32:7–14; Numrat 14:11–19)

A u përgjigj Moisiu: “Në rregull, Zot. Si të urdhërosh Ti. Kush jam unë që të pyes për rrugët e Tua të pahetueshme? Dhe unë e vlerësoj shumë ofertën Tende për të krijuar një komb të madh prej meje”? Në asnjë mënyrë!

“O Zot, për sa të njoh Ti nuk do ta bëje. Gjithashtu nëse Ti e bën këtë, kjo do të prishte reputacionin tënd. Egjiptianët do të dëgjojnë për këtë dhe do të mendojnë që Ti je tepër i dobët për të drejtuar njerëzit e Tu në Tokën e premtuar. Për sa të njoh Ti, o Zot, nuk do ta bëje!”

“Kush tjetër më njeh më mirë se sa ti, Moisi? Ti me të vërtetë je miku Im. Prandaj Unë mund të flas hapur me ty, ballë për ballë si njeriu flet me mikun e tij.” (Eksodi 33:11; Numrat 12:8)

“Faleminderit, Job, që je miku Im!”

Ka edhe histori për Jobin. Duke u ndjer i braktisur nga Perëndia, ai i klithi Zotit:

“O Zot, ti dhe unë kemi qënë kaq miq të mirë. Ne kemi biseduar përditë. Përse nuk do të flasësh me mua tani? Te lutem me thuaj, çfarë ndodhi?” (Jobi 29:1-4; 30:20)

Elihu dhe tre “ngushëlluës të mërzhitshëm” te tjerë (Jobi 16:2) erdhën me qëllime të mira për të këshilluar Jobin. Elihu tha: “Unë, vallë, nuk do ta kërkoj Zotin për të folur me mua. Unë nuk do t’i jipja një shans për të më vrarë.” (Jobi 37:20)

Shikoni, Elihu ishte vetëm një shërbëtor i frikësuar. Por Job vazhdoi: “Por unë dua që Zoti të më flas. Të lutem fol me mua, O Zot, sepse unë e di, që vetëm po të flasim bashkë, unë do të kuptoj, pse po më ndodh e gjithë kjo.” (Jobi 23:3-7)

Në fund Zoti ndërhyri. “Ke të drejt, Job. Këshilltarët e tu nuk më njohin ashtu si më njeh ti. Faleminderit, Job, që je miku im. Faleminderit, që më ke treguar të vërtetën.” (Jobi 42:7, 8)

Ah, sikur dishepujt ta kishin pranuar ofertën e miqësisë të Jezusit dhe do të ishin të lirë për të bërë pyetje në sallën e sipërme. Pyetje të tilla si: “Nëse Ti do që ne të jemi miqtë e Tu, pse Bibla flet kaq shumë për shërbëtorët? Ashtu si dashuria dhe miqësia nuk mund të urdhërohen, atëhere pse ka kaq shumë rregulla?”

Dashuria nuk mund të urdhërohet

Sa i trishtuar duhet të ketë qënë Perëndia duke mbledhur fëmijët të Tij tek Mali Sinait për të urdhëruar ata ta duan Atë dhe njëri-tjetrin dhe të ndalonin së vrari dhe urreyeri njëri-tjetrin dhe të ndalonin së qënuri imoral dhe të vidhnin dhe mashtronin. (Eksodi 20) Kur një baba duhet të bëjë një gjë të tillë me fëmijët e tij, situata në familjen e tij duhet të jetë shumë serioze.

Ashtu si shpjegon apostulli Pal, ligji u shtua për shkak të shkeljeve dhe keqbërjes. (Galatasve 3:19) Faktikisht, atë që Perëndia donte më shumë për fëmijët e Tij — paqe, dashuri, lumturi dhe miqësi besnike — nuk mund të prodhohet me anë të ligjit, aq me pak me anë të forcës dhe frikës.

“Jo për fuqinë dhe as për forcën por për Frymën Time,” thotë Zoti. (Zakaria 4:6)

Vetëm me anë të mënyrës se si punon Fryma e dashurisë dhe e së vërtetës njerëzit mund të binden me vullnetin e tyre të lirë për t’i dhënë Zotit atë çfarë Ai do. Ju mund t’i detyroni njerëzit të jenë shërbëtorët tuaj... Por nuk mund t’i urdhëroni të jenë miqtë tuaj.

Ah, sikur dishepujt ta kishin pyetur Jezusin në sallën e sipërme që t’u shpjegonte për përdorimin e komplikuar të ligjit. Duket kaq kontradiktore nga përvoja dhe logjika të urdhërosh njerëzit ta duan Zotin dhe njëri-tjetrin. Megjithatë pikërisht para dhe pas ofertës së miqësisë tek Gjoni 15:15 Jezusi përsëriti urdhërin e dashurisë.

“Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve. ... Këtë ju urdhëroj: ta doni njëri-tjetrin.” (Gjoni 15:12, 17) Me këtë rast Jezusi edhe shtoi, “Ju jeni miqtë e mi, nëse bëni gjërat që unë ju urdhëroj.” (Gjoni 15:14)

A e keni provuar këtë gjë me dikë që do të donit të ishte miku juaj? Çfarë do të kishte ndodhur nëse në shkollën fillore do të kishit thenë një shokut të klasës: “Mund të jesh miku im për aq kohë sa bën atë që them unë”? Nëse kjo është ideja juaj e miqësisë, do të habitesha nëse do të kishit shumë miq.

Është nder të jesh shërbëtor i Perëndisë

Cili nga ne do të kishte guxim t’i afrohej Perëndisë me idenë e pabesueshme të Gjoni 15:15? “Ne nuk duam të quhemi më shërbëtorët e Tu. Ne këmbëngulim që tani e tutje të na drejtohesh si miq!”

Faktikisht, është një nder të jesh shërbëtor i Perëndisë. Dhe sa e mrekullueshme do të ishte të dëgjosh nga Zoti të të thotë në fund: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik!” Por është vetë Zoti i cili na ofron diçka akoma më të mirë – të jemi miqtë e Tij të mirëkuptueshëm.

Nuk kemi pse të ecim vërdall me ngjitësit: “Kështu tha Perëndia! Unë besoj atë! Kjo e vendos gjithçka!” “Zoti ka thënë, “Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, por unë ju kam quajtur miq, sepse dua që ju të kuptoni.”

Një shërbëtor i mirë dhe besnik do të përshtatet mbishkrimin e ngjitëse e lartpërmendur, por gjithashtu do ta merrte shumë seriozisht çfarë ka thënë Zoti rreth preferencës së Tij për miqësi.

Por është shumë më mirë të jesh miku i Tij

A shikon vetveten si shërbëtor apo miku i Perëndisë?

“Oh,” ndoshta po thuani, “Unë shikoj vetveten si diçka madje më e mirë. Unë jam fëmijë i Perëndisë.”

“Dhe pse është më mirë të jesh fëmijë i Perëndisë?”

“Pa tjetër, për shkakun e drejtave të fëmijës, dhe unë vlersoj shumë këto të drejta që Krishti ka blerë duke paguar një çmim aq i shtrenjtë.”

Një ditë dëgjova një pastor duke predikuar: “Kur të shkoj në Parajsë dhe të takoj Zotin dhe Ai do të habitet se si një person si unë mund të ishte atje, gjithçka që duhet të bëj është t’i tregoj të drejtat e mia. Ai nuk ka pse të më pëlqej. Gjithçka që Ai duhet të bëj është të shoh të drejtën time për të qenë atje.”

Kjo më duket si një e folur prej shërbëtori. Dhe sigurisht jo shumë miqësore.

Unë njoh shumë fëmijë që nuk janë miq me baballarët e tyre. Absalomi ishte djali i Davidit dhe ai ishte armiku më i keq i të atit. (2 Samuelit 15-18)

Kështu që për mua do të preferoja të isha mik i Perëndisë se sa thjesht fëmija i Tij.

Por fatmirësisht, ne mund të jemi që të tre. Nuk na duhet të zgjedhim.

Besoj që është një nder i madh të jesh shërbëtor i Zotit dhe veçanërisht i vlerësuar si besnik.

Është gjithashtu një privilegj i madh të quhesh fëmijë i Perëndisë.

Por mbi të gjitha, do të preferoja të isha miku i Tij.

Një mik besnik dhe i mirëkuptueshëm.

3. NUK KA MIQËSI PA BESIM

N

ëse Zoti do që ne të jemi miqtë e Tij, pse aq shpesh në Shkrimet e Shenjta Ai duket kaq jomiqësor?

Tek Fjalët e urta 18:24 lexojmë: “Njeriu që ka shumë miq duhet gjithashtu të tregohet mik, por është një mik që është më i lidhur se një vëlla.”

Shumica e njerëzve ndoshta kanë zbuluar nga eksperiencia e tyre të vërtetën e pjesës së parë të kësaj fjale të urtë. Nëse ti vet nuk je miqësor, mos prit që të kesh miq.

Më i lidhur se një vëlla

Përkthyesit kanë rënë dakord me pjesën tjetër të kësaj fjalie: një mik i vërtet lidhet më afër se një vëlla. Pjesa e dytë e vargut na jep idenë që miqtë në pjesën e parë nuk mund të jenë të besueshëm, prandaj shumë versione të Biblës e përkthejnë kështu:

Ka miq që pretendojnë se janë miq, por ka një mik që është më i lidhur se një vëlla. (RSV, 1952)

Disa miq luajnë miqësinë, por një mik i vërtetë është më i lidhur se një i afërm. (NRSV, 1989)

Disa miqësi nuk zgjasin, por disa miq janë më bështetës se vëllezërit. (GNB, 1976)

Kur Jezusi bëri ofertën e miqësisë dishepujve të Tij, a ishte Ai vetëm duke “luajtur miqësi”? A po pretendonte Ai të ishte kaq miqësor?

Nuk mund të ketë miqësi që zgjat pa bësueshmerinë nga të dyja anët. A ka një arsye të fortë të besosh Birin e Perëndisë si një mik i cili është “më i lidhur se një vëlla”?

Si duhet t’i kuptojmë ne ato histori të tmerrshme të Dhjatës së Vjetër? A janë ato pasazhe ndoshta për të prezantuar karakterin e frikshëm të Atit se sa të Birit e Tij të dashur?

A mund të jetë Ati si Jezusi?

Edhe Filipi u habit nga ndryshimet midis karakterit miqësor të Jezusit dhe pamjes së Atit (sipas mendjes së tij) në Dhjatën e Vjetër.

“Jezus,” kërkoi ai, “na trego Atin dhe na mjafton.”

“A nuk kam qënë me ty gjithë këtë kohë, Filip, dhe ti akoma nuk më njeh Mua?”

“Por pyetje tona nuk janë rreth Teje,” Filipi vazhdonte.

“Ne të njohim dhe të duam shumë, o Zot! Edhe pse të adhurojmë si Biri i Perëndisë, ne nuk kemi frikë të qëndrojmë aq pranë Teje këtu në sallën e sipërme. Ne po pyesim për Atin jo për Ty. Ne duam të mësojmë rreth Perëndisë i cili me bubullima erdhi në Malin Sinai, i cili përmbysi të gjithë botën, i cili shkatërroi me zjarr qytetet e Sodomës dhe të Gomorrës. Duam të mësojmë rreth Atij i cili i dogji Nadabin dhe Abihun dhe hapi tokën për të gëlltitur rebelët – Korahu, Dathani dhe Abirami, i cili urdhëroi goditjen me gurë të Ahanit dhe familjes së tij dhe cili hodhi zjarr nga qielli në malin e Karmelit.” (1 Mbretërve 18)

“Jezus, a mund të jetë Ati si Ti?”


“Po të më kishit njohur mua, do të kishit njohur edhe Atin tim. Kush më ka parë mua ka parë edhe Atin. Si vallë po thua, ‘Na e trego Atin’? A nuk besoni se unë jam në Atin dhe se Ati është në mua? Në se ju besoni në mua, ju mund të besoni edhe tek Ai që më ka dërguar.”

“Dhe për ato historitë stresuese të disiplinës dhe vdekjes,” Jezusi mund të vazhdonte, “mos i keqkuptoni ato. Këto histori nuk tregojnë që Ati është më pak miqësor se unë. Në të vërtetë isha unë që e udhëhoqa Izraelin në shkretëtirë. Urdhërimi për të vlarë me gurë Akani ishte i imi!”

Pali e kuptoi këtë kur shkruajti, duke përdorur simbolin familjar biblik të shkëmbit: “Ata të gjithë pinë nga shkëmbi supernatyor që i shoqëroi në udhëtimet e tyre—dhe ky shkëmb ishte Krishti.”

Nëse dishepujt nuk do ishin aq të interesuar se kush kishte vëndin më të mirë në tavolinë dhe çfarë pozicioni ata do të kishin në mbretërinë e ardhme, ata mund të kishin bërë disa pyetje dhe do të kishin marrë përgjigje shumë të çmuara.

Ata mund të kishin pyetur: “Pse, Jezus, urdhërova të vrisnin me gurë Akanin dhe familjen tij por punove që ta parandalon vrasjen me gurë të gruas që ishte kapur në tradhëti? Pse bëre një bubullimë kaq të madhe në malin Sinai por na flet kaq butësisht neve tani?”



Por ata nuk i bënë këto pyetje. Kështu tani është radha jonë t’i bëjmë këto, dhe Jezusi na fton ne si miqtë e Tij të përpqem të kuptojmë.

Pse e ngriti zërin Zoti në Malin Sinai?

Imagjinoni sikur të ishit të pranishëm atë ditë të mrekullueshme kur Zoti zbriti në malin Sinai për të folur me bijtë e Izraelit. I tërë mali dridhej në praninë e Zotit. Pati bubullima dhe vetëtimë, zjarr dhe tym, dhe një zë shumë i fortë borie.

Dhe Zoti i tha Moisiut: “Ti do të përcaktosh rreth e qark kufij për popullin dhe do ti thuash; ruhuni se ngjiteni në mal dhe prekni skajet e tij, Kushdo që do të prekë malin do të dënohet me vdekje. Asnjë dorë nuk do ta prekë, por do të vritet me gurë, qoftë njeri ose kafshë; nuk do të mbetet gjallë. (Eksodi 19)

Njerëzit u frikësuan dhe qëndruan larg. Ata i thanë Moisiut nëse na flet ti neve ne do të dëgjojmë, por ne kemi frikë se nëse Zoti do të na flasë ne do të vdesim.

Por Moisiu u shpjegoi njerëzve që nuk kishin pse të ishin të frikësuar, sepse ai e njihte Zotin si mikun e Tij. Moisiu i afroheshe Zotit me respekt të thellë por nuk kishte frikë. Dhe Zoti mund të fliste me Moisiun “Ballë për ballë, siç flitet me mikun.”

Por gjatë gjithë rrugës nga Egjipti deri në Sinai njerëzit u sollën parespekt, mërmërisnin dhe ankoreshin— edhe pse Zoti i çliroi mrekullisht tek deti i kuq dhe siguroi ushqim dhe ujë. Si mund t’ia merrte vëmendjen Zoti këtyre njerëzve dhe ti mbante aq gjatë sa ti zbulonte më shumë të vërteta rreth vetes së Tij?

A duhet tu fliste butësisht këtyre njerëzve, me një shushuritje të ëmbël,” ashtu siç Ai do ti fliste disa vite me vonë Elias në shpellë? A duhet të ulej dhe të qante për Izraelin siç do ta bënte disa shekuj më vonë, si u ul në një mal tjetër dhe qau për njerëzit e Jeruzalemit?

Vetëm një shfaqje dramatike të madhështisë dhe fuqisë së Tij mund ti bënte këta njerëz ta respektonin. Çfarë rreziku për tu keqkuptuar si një Zot i frikshëm? Megjithatë, Zoti o të rrezikonte ose të humbte kontaktin me njerëzit e Tij. Pa respektin ndaj Zotit, ata nuk do të dëgjonin apo ti merrnin seriozisht mësimet e Tij.

Në Dhiatën e Vjetër ne lexojmë që “të jesh i zgjuar në fillim duhet të kesh respekt të thellë për Zotin.” (Fjalët e Urta 9:10)

Dhe Zoti ishte i gatshëm të rrezikonte që njerëzit për pak kohë ta urrenin apo të frikësoheshin, se sa të humbte kontaktin me fëmijët e Tij.

A do të bënit edhe ju të njëjtën gjë?

Prindërit dhe mësuesit duhet të jenë në gjëndje ta kuptojnë këtë rrezik. Imagjinoni se jeni një mësuese e njohur për dinjitet dhe mirësi. Në të gjitha vitet e mësimdhënies ju nuk keni pasur nevojë ta ngrini zërin në klasë.

Por sapo drejtori i shkollës ju ka informuar që shkolla po digjet dhe ju duhet ti drejtoni nxënësit të dalin shpejt nga klasa.

Ju hyni në klasë dhe butësisht i thoni që shkolla po digjet. Por në klasë ka shumë zhurmë dhe madje asnjë nuk ju vën re. Për shkak se ju i doni këta fëmijë A nuk do të ishit të gatshëm të bërtisni?

Nëse akoma nuk e keni vëmendjen e tyre, A nuk do të hipnit mbi bankë dhe madje të hidhni edhe nja dy goma?

Me siguri që fëmijët do ta vën re këtë sjellje të pazakontë të mësueses së tyre të sjellshme dhe të mirë— ecila bërtet për herë të parë me inat!

Ata mund të befasohen dhe ndoshta edhe të friksohen.

“Tani fëmijë ju lutem mos i tregoni prindërve që unë u inatosa me ju,” ti ndoshta mund të filloje të shpjegoje.

“Unë thjesht po ju terhiqja vëmendjen. E shikoni fëmijë shkolla është në zjarr dhe unë nuk doja që ndonjëri prej jush të digjej. Prandaj tani le të dalim jashtë në mënyrë e qetë dhe e rregulltë.”

Rreziku i disiplinës

Kush tregon dashuri më të madhe? Ai që refuzon ti bërtasi fëmijëve sepse ata frikësohen? Apo Ai që rrezikon të quhet i frikshëm në mënyrë që të shpëtoj fëmijët? Zoti rrezikon gjithmonë kur Ai vendos të disiplinojë njerëzit e Tij. “Sepse Zoti disiplinon ata që ai i do.” (Hebrenjve 12:6)

Fjala origjinale në Greqishten e vjetër versë do të thotë “Edukim,” “Trajnim,” “Korigjim,” “Disiplin”—mund të përfshijë ndonjë situatë dënimi por gjithmonë është për qëllim mësimi.

“Fëmija im mos e përçmo disiplinën e Zotit ose mos u mërzi nga korigjimi i Tij sepse Zoti korigjon atë të cilin e do, siç do babai djalit e tij.” (Fjalët e Urta 3:11-12)

Në letrën e Hebrenjve Apostulli Pal citon këtë proverb dhe apelon fëmijët e Zotit të mos e anashkalojnë kuptimin inkurajues të këtij vargu.

“Në qoftë se ju do ta duroni qortimin, Perëndia do t’ju trajtoj si bij; sepse cilin bir nuk e korigjon i ati? Por, po të mbeten të pandrequr, ku të gjithë u bënë pjesëtarë, atëherë jeni kopila dhe jo bij. Pastaj etërit tanë sipas mishit i patëm për të na ndrequr dhe i nderonim ata; a nuk do ti nënshtrohemi edhe më tepër Atit të shpirttrave për të jetuar? Sepse ata ndreqën për pak ditë, ashtu siç u dukej më mirë, kurse Ai na ndreq për të mirën tonë që

të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së tij. Çdo ndreqje, pra aty për aty, nuk duket të sjellë gëzim, por hidhërim por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij.” (Hebrenjve 12:7-11)

Zoti preferon më shumë shushuritjen e ëmbël të zërit

Sigurisht nëse ne ngulim këmbë që të kemi mënyrën tonë Zoti do të na lejojë. Sidoqoftë, Ai nuk heq lehtësisht dorë nga ne. Ai bind; Ai paralajmëron; Ai disiplinon.

Ai do të preferonte më shumë të na fliste me qetësi siç bëri më në fund me Elian. Por nëse ne nuk e dëgjojmë shushuritjen e zërit të tij, Ai do të flasë nëpërmjet tërmetit, erës, dhe zjarrit.

Ndonjëherë, në momente shumë kritike, Zotit i dashur të përdorë masa ekstreme për të patur vëmendjen dhe respektin tonë. Në raste të tilla nderimi ynë ngurues në shumicën e rasteve ka qenë për shkak të frikës. But God has thereby gained another opportunity to speak, to warn us again before we are hopelessly out of reach, to win some of us back to trust—and to find that there really is no need to be afraid.

Por kështu Zoti ka fituar një tjetër shans për të na folur dhe paralajmëruar përsëri para se ne të shkojmë tepër largë, Ai ka një shans tjetër për të fituar besimin nga disa prej nesh që ne mund të zbulojmë që në fakt nuk kemi pse të frikësojmë nga Zotin tonë.

Sigurisht në të gjithë këtë Zoti ka treguar veten e tij që është një mik i cili “të qëndron më pranë se sa një i afërm.”


Ai i cili dëshiron që ne të jemi miqtë e tij është vet një mik kaq i mirë sa ai dëshiron të qëndrojë me ne edhe kur ne nuk jemi shumë miqësor kundrejt tij. Ai punon me qetësi të ndryshojë madje dhe armiqtë e tij në miq të kuptueshëm.

Si e fitoi Zoti Saulin?

Zoti “u përballua ” me armikun e tij Saul dhe e ktheu atë në Pal, apostullin më të madh të besimit dhe dashurisë.

Përpara se Sauli të takonte Jezusin në rrugën e Damaskut, ai i ishte dedikuar totalisht të çrrënjoste atë që ai besonte se ishin mësimet të rrezikshme dhe të rreme rreth Zotit. Nëse dikush do të guxonte të thoshte se Sauli ishte aktualisht armiku i Zotit, Sauli do të ishte zemëruar shumë. Ai kishte arsye të besonte për veten e tij se ai ishte shërbëtor i zellshëm dhe dhe mbrojtës i së vërtetës.

Por Sauli adhuronte në Zot aspak miqësor, i cili përdorte forcën për të bërë vullnetin e tij. Në emër të zotit që ai njihte, Sauli u përpoq të detyronte të krishterët e hershëm të hiqnin dorë nga herezia e tyre dhe të ktheheshin



tek e vërteta. Nëse ata do të refuzonin, ai do ti arrestonte ata dhe madje ekzekutuar— pikërisht ashtu siç ai besonte se do të bënte zoti i tij.

Për këtë arsye Sauli asistoi në vrasjen me gurë të Stefanit. Ai nuk u kënaq nga ekzekutimi, por ai “ miratoi vrasjen e tij.” (Veprat 8:1) Ai kujtoi historinë e Sinait. A nuk e drejtoi Zoti që ai i pabinduri të ekzekutohej me gurë?

“Të lutem fale Saulin.”

Si mund ta fitonte Zoti një njeri si Sauli të ishte miku i tij, miku i një Zoti miqësor? Zoti zgjodhi të përballohej me mikun e tij të ardhshëm në rrugën e Damaskut.

Sauli ishte i shqetësuar nga kujtimet e atij ekzekutimi. Stefani kishte treguar njohuri mbresëlënëse nga Shkrimet, dhe ndërgjegja e Saulit akoma pranonte autoritetin e të vërtetës.


Ndoshta e shqetësonte veçanërisht lutja e Stefanit për falje pikërisht përpara se ai të vdiste: “O Zot mos ua ngarko atyre këtë mëkat.” (Veprat 7:60) kzionin raportime se heretiku Jezus ishte sjellur në të njëjtën mënyrë në kryq: “Atë, fali

ata; sepse nuk dinë çfarë bëjnë.” (Luka 23:34)

Nëse këta dy njerëz ishin me të vërtetë heretik të paperëndishëm, si mundeshin ata të duronin një torturë të tillë me një hir kaq të perëndishëm? Por, Sauli mund të kishte arsyetuar, rreth gjithë atyre historive të zemërimit hyjnor dhe ndëshkimit, të ushtrimit të drejtësisë në shtypjen e mëkatarëve dhe mëkatit? A nuk e kishin autorizuar atë shefi i administartorëve dhe teologët ta përmbushte këtë mision jo fort të këndshëm por të shenjtë?

Në këtë mënyrë Sauli vazhdoi rrugën e tij për në Damask, “duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepuje të Zotit.” (Veprat 9:1)

A do ti kishte bërë mirë Zoti po ta prekte me mirësjellje tek shpatulla dhe ti thoshte, Një minut Saul, amund të flas me ty?”



Sauli as nuk do ta kishte ndjerë preken e Zotit. Ai sigurisht që as nuk do ta kishte dëgjuar pëshpërimën e zërit të tij. Pikë së pari duhej të ndodhte diçka dramatike për të pasur vëmendjen e Saulit.

Me një rrezatim drite, Zoti e rrëzoi atë në rrugë. Dhe për më shumë se aq, për të patur vëmendjen e tij të plotë për atë që donte ti thoshte, Zoti i hoqi atij shikimin për pak kohë. Ndërsa Sauli u shtri i pashpresë në rrugë, ai duhet të ketë qenë i shokuar të zbulonte se sulmuesi i tij nuk ishte asnjë nga heretikët e butë dhe të sjellshëm të cilët ai i kishte përçmuar si të dobët — të cilët mësonin gjepura të tilla si ti duam armiq të tanë dhe madje të lutemi për romakët!

“Por ai mund të më kishte vlarë tani,” mund të kishte menduar Sauli. “Do ta kisha bërë po të isha në vënd të tij. Pse nuk më sjkatërron ai mua, unë kam shkatërruar dishepujt e tij? Në vënd të kësaj, e dëgjoj atë të më flasë më butësi në gjuhën time (aramaike). (Veprat 26:14) Dhe ai po i flet ndërgjegjes time!”

“Më fal, Zot. Kam qenë komplet gabim. Të lutem më prano si shërbëtorin tënd, dhe më thuaj se çfarë dëshiron që unë të bëj.”

Vite më vonë në letrën e tij drejtuar besimtarëve në Romë, Sauli – tani i quajtur Pal – ishte i nderuar ta prezantonte veten si “shërbëtor, ose skllav i Jezus Krishtit.” (Romakët 1:1)

Pali – shërbëtori

Por Zoti donte më shumë nga Sauli sesa vetëm shërbim të nënshtruar. Ai nuk i dha atij urdhëra të veçanta në atë kohë, përveç se të ngrihej dhe të shkonte në Damask. “Atje do të të thuhet çduhet të bësh.” (Veprat 22:10)

Një burrë i quajtur Ananias e takoi atë në qytet me një mikpritje miqësore, “Vëlla Saul, Zoti Jezus, që të është shfaqur në rrugën në të cilën po vije, më ka dërguar që të kesh përsëri dritën e syve dhe të mbushesh me Frymën e Shenjtë!” (Veprat 22:13)

Pastaj Ananiasi vazhdoi ti jepte një përshkrim të planeve të mëdha të Zotit për dishepullin e tij të rie. Sauli ishte caktuar të ishte asistenti i Zotit për të bërë të njohur të vërtetën.

“Perëndia i etërve tanë” vazhdoi Anania, “të ka paracaktuar të njohësh vullnetin e tij, ta shohësh të drejtin dhe të dëgjosh një zë nga goja e tij, sepse ti duhet të dëshmosh për të tek rë gjithë njerëzit për ato që ke parë dhe dëgjuar.” (Veprat 22:14-15)

Pali – miku i kuptueshëm

Ndërsa Pali reflektonte dhuntinë bindëse të Zotit në trajtimin e tij në mënyrë kaq të rreptë, por edhe të hirshme në rrugën e Damaskut, ai u shndërrua në më shumë se një shërbëtor besnik. Ai u bë miku më i kuptueshëm, qëllimi më i madh i të cilit ishte të dëshmonte të vërtetën rreth Perëndisë të tij duke i trajtuar të tjerët ashu si Perëndia e trajtoi atë.

Më imitoni mua, ashtu si unë jam imitues i Krishtit,” i shkroi ai Korintasve (1 Kor.11:1). Ai nuk do ta përdorte më kurrë abuzimin e forcës. Atyre, të cilët nuk ishin dakort me të – madje dhe rreth çështjeve të rëndësishme – ai do tu thoshte, “Gjithësecili të jetë i bindur në mendjen e tij.” (Romakëve 14:5)

Dhe atyre të cilët ndjeheshin të lirë për ta kritikuar dhe për ta dënuar, ai do tu thoshte, “Kush jeni ju për të gjykuar të tjerët?” (Romakëve 14:1-23)

Pali tregoi sesa mirë e njihte ai Zotin , dhe se i kuptoi mënyrat e miqësisë dhe të besimit, duke trajtuar anëtarët e pabindur të kishës së Korintit ashtu si Krishti kishte trajtuar atë.

Në fillim ai u bëri thirrje me dashuri dhe me arsye. I shkroi pikërisht atyre kapitullin e famshëm për dashurinë, të cilin ne e njohim si 1Korintasve 13. Por ata nuk u prekën aspak, dhe e refuzuan duke e përçmuar këshillën e tij.

Përpara rrugës për në Damask Pali e dinte ekzaktesisht se çfarë të bënte — ti burgoste ose ti vriste me gurë disa nga ata! Por tani, as që bëhej fjalë sigurisht.

Ai vendosi ti vizitonte vetë ata, duke udhëtuar nga Efesi në Korint. Atje atë e ofenduan si të dobët dhe të pavendosur. Ata e përçmuan thirrjen e tij e të qenurit apostull dhe sfiduan autoritetin e tij për ti korigjuar ata.

Disa talleshin duke thënë, “Letrat e tij janë me pesh dhe të forta, por prezenca e tij trupore është e dobët, dhe të folurit e tij është përçmues.” (2 Korintasve 10:10) Sigurisht që ata nuk do ta merrnin seriozisht derisa ai bëri diçka për të fituar respektin e tyre.

Pali u kthye në Efes për të vendosur lëvizjen e tij të ardhshme. Dukej qartë sesa më butë të fliste ai rreth dashurisë aq më shumë do ta keqësonte çështjen. Ashtu si mësuesi me shkollën në zjarr, ai duhet të rrezikojë të keqkuptohet se ngriti zërin? A do ta akuzonon atëherë atë për pavendosmëri, që kundërshton kapitullin e tij të dashurisë?

Ai ishte i përkushtuar të ndiqte shembullin e Krishtit — vetëm ta dinte se çfarë do të bënte Zoti në një situatë të tillë. Por ai e dinte. Krishti e ngriti zërin në malin Sinai për të patur vëmendje dhe respekt. E ngriti përsëri zërin në rrugën e Damaskut, gjë për të cilën armiku i tij do ti ishte përjetësisht mirënjohës.

Pali mori vendimin e tij . Ai dërgoi një letër qortuese. Ishte kaq qortuese sa ai qante vetë ndërsa e shkruante atë. I shqetësuar se mund të keqkuptohej, ai nuk mund të priste për një përgjigje, dhe u nis përsëri për në Korint. Ai u ndje keq për atë që kishte shkruar, por vetëm për pak kohë.

Ndërsa ishte rrugës, ai mori lajmin se masat urgjente kishin patur sukses. Ngritja e zërit të tij kishte funksionuar! Letra ishte pritur me “frikë dhe dridhje.” Dhe me respektin e fituar këshilla e apostullit ishte pranuar plotësisht.

A mund t'i besohet Perëndisë që vrau me gurë Akanin?



Ashtu si Pali qau ndërsa shkruante letrën mëkatarëve në Korint, kështu duhet të ketë qarë edhe Zoti gjithashtu, ndërsa urdhëroi ekzekutimin e Akanit dhe të gjithë familjes së tij. Dhe Ai i kërkoi ndjekësve të tij izraelit ti vrisnin ata me gurë dhe pastaj të digjinin kufomat.

A mund të jetë një Zot i tillë i besueshëm si një mik?

Ndërsa ata kaluan kufirin në Kanaanin aspak miqësor, shpresa e vetme e njerëzve për të mbijetuar qëndronte në të kuptuarit seriozisht të Zotit dhe në të zbatimin e mësimave të tij në çdo detaj. Ekzistonte rreziku se shpirti mosrespektues dhe rebelues i Akanit mund të përhapej në të gjithë kampin. (Jozueut 7:1-29)

Në një ditë kur jeta merrej shumë lehtë — njerëzit vet i kishin thënë Joshuas se kush nuk i bindej atij duhej të dënohej me vdekje — ishte e nevojshme që disiplina e Zotit të ishte mjaft e tmerrshme dhe dramatike për të bërë përshtypjen e duhur. (Jozueut 1:18)

Por ndërsa gurët hidheshin drejt qëllimit të tyre, sa duhej ti kishte urryer këto momente të tmerrshme Ai i cili shikon edhe një harabel të

vogël të bjerë! (Mateu 10:29,30 dhe Luka 12:6,7)

Një pamje konstante e Zotit

Studimi i kujdesshem i Biblës tregon një pamje konstante të një Zoti të fuqishëm në pafundësi, por njëkohësisht të hirshëm dhe të mirëbesueshëm, qëllimi i fundit që ai ka për fëmijët e tij është liria e të kuptuarit të miqësisë.

Ndërsa ai ecën drejt qëllimit të tij, ai dëshiron të zbrësë dhe të na takojë aty kudo që ne të jemi, të na drejtojë ne jo më shpejt se sa ne të jemi në gjendje ta ndjekim, duke folur një gjuhë të cilën ne mund ta kuptojmë dhe të respektojmë.

Për të mbajtur të hapura rrugët e komunikimit, ai është shpesh i detyruar të marrë masa që rrezikojnë të keqkuptohen.

Për armiqët e tij dhe për të pakujdesshmit, këta janë veprime të një Zoti jomiqësor. Por për miqtë e kuptueshëm, ata janë të dhënat e besueshmërisë së Zorit, që është baza e besimit të tyre.

Dhe pa një besim të tillë nuk mund të ketë miqësi të vërtetë.

“G

4. BESIMI NUK MUND TË URDHËROHET

junjëzohuni, ose unë do t’ju hedh në zjarr!”

Nebukadnetsari, mbret i Babilonisë dhe sundues i perandorisë së madhe nuk po kërkonte që njerëzit të adhuronin atë.

Ai sapo kishte ndërtuar një skulpturë madhështore floriri —90 metra të lartë dhe 9 metra të gjerë— dhe kishte urdhëruar të gjithë zyrtarët e mbretërisë të merrnin pjesë në adhurim. (Daniel 3)

Kur ishin grumbulluar të gjithë, një lajmëtar njoftoi urdhërin e mbretit që kur të jepej sinjali muzikor, të gjithë duhet të përuleshin para imazhit që ishte vendosur aty.

Ai që do refuzonte do të dënohej dhe “hidhej i lidhur në një furrë zjarri përvëlues.” (Daniel 3:6)

Nebukadnetsarit i dukej normale dhe për të s’kishte asgjë të pazakontë në urdhërimin e adhurimit nën presionin e kërcënimit me hedhje në zjarr. Vetë perënditë a nuk kërcënonin me hakmarrje të tilla ata që nuk bindeshin dhe nuk i adhuronin?

Pas njëzet e pesë shekujsh, shumicës prej nesh kërcënimi i mbretit për adhurim i duket tmerrësisht i egër dhe shenjë moscivilizimi.

Por a ishte mbreti më mizor se apostulli Pal—para eksperiencës së tij në rrugën për Damask—ku, “duke shfryrë kërcënime dhe kërdi”, ai udhëtonte për të detyruar me forcë njerëzit që të adhuronin Zotin e tij të frikshëm?

Dhe a nuk ka sot në kohët moderne me miliona njerëz që besojnë në një zot që jo vetëm kërkon adhurimin e tyre, por edhe tërë dashurinë dhe besimin— të gjitha nën kërcënimin, jo vetëm për të vdekur në një furrë të nxehtë, por të një torture të përjetëshme në zjarr?



Sinjali i muzikës u dha, dhe të gjithë u gjunjëzuan, —përveç tre izraeliteve të rinj, Shadrak, Meshak, dhe Abed-Nego. Ata ishin sjellë në Babiloni si robër lufte gjatë pushtimit të Judës. Por Nebukadnetsar i kishte zgjedhur ata për ti edukuar në punët e gjykatës së perandorisë, dhe së fundmi u kish dhënë atyre një ngritje duke i emëruar në pozicione drejtuese në perandori.

Mbreti u egërsua kur mësoi për mosbindjen e tyre, dhe i thirri ata para tij.

“A është e vërtetë, Shadrak, Meshak, dhe Abed-Nego, që ju nuk u shërbeni perëndive të mia, dhe nuk adhuronit figurën e artë që unë kam ngritur? Tani nëse ju jeni gati të bini përmbys për të adhuruar figurën që unë kam bërë, mirë. Por në rast se nuk do ta adhuronit, do t’ju hedhin menjëherë në mes të një furre të ndezur; dhe cila është ajo perëndia që do të mund t’ju çlirojë nga duart e mia?” (Daniel 3:14,15)

Burrat e rinj me tërë respektin për mbretin refuzuan, dhe i argumentuan se Zoti të cilit ata i shërbenin do të kujdesej për ata dhe nuk do ti braktiste.

I mbushur me zemërim, Nebukadnetsari urdhëroi që furra të nxehej shtatë herë më shumë se zakonisht dhe që të hidheshin të tre në furrë.

Si e disiplinoi Zoti Nebukadnezarin?

Si mund të korrigojë Zoti një njeri aq arrogant dhe të fuqishëm? Si mund ai të komunikonte me një tiran të mësuar të merrte atë që donte dhe që shkatërronte këdo që i vihej kundër? Sigurisht, Zoti lehtësisht mund ta kishte shkatërruar atë ndërsa ai ishte i ulur në fronin e tij. Spektatorët mund të ishin mahnitur. Por shkatërrimi nuk mund të disiplinojë të shkatërruarin. Dhe Ati qiellor sapo kish filluar mësimin e djalit të tij brilant, por arrogant.

Një gjë që Nebukadnetsari respektonte ishte fuqia superiore. Kur Danieli kishte mundur ti shpjegonte mbretit ëndrrën që ai kishte harruar, Nebukadnetsari ishte gjunjësuar para këmbëve të profetit.

‘Në të vërtetë,’ tha ai, ‘Zoti yt është Zot i Zotërve dhe Mbret mbi mbretër, me që ti ishe në gjendje të zbuloje këtë sekret.’” (Daniel 2:47)

Zoti i takon njerëzit atje ku ata janë. Kështu, ashtu siç takoi Moisiun në ferrishten që flakëronte, (Eksodi 3) Zoti takoi Nebukadnetsarin në flakët e furrës përvëluese.

“Atëherë Mbreti Nebukadnetsar, shumë i shqetësuar, u ngrit në këmbë dhe u tha gjyqtarëve të tij, ‘A nuk ishin tre burrat që të lidhur ne i hodhëm në zjarr?’”

Ata iu përgjigjën, ‘Po, sigurisht, madhëria juaj.’ ‘E megjithatë’ ai nguli këmbë, ‘Ja, unë po shoh katër burra të palidhur, që ecin në mes të zjarrit, pa pësuar asnjë dëm; zjarr, të lirë dhe të palidhur; dhe pamja e të katërtit i përngjan asaj të një biri të Perëndisë.’” (Daniel 3:24,25.)

Mbreti urdhëroi katër burrat të dëlnin nga furra dhe pastaj u shpalli publikisht se:

I bekuar qoftë Zoti i Shadrakut, Meshakut, dhe Abed-Negos, që ka dërguar engjëllin e tij dhe ka çliruar shërbëtorët e tij, që kanë pasur besim tek ai; ata kanë shkelur urdhrin e mbretit dhe ia kanë ekspozuar trupin e tyre vdekjes në vend që të shërbenin dhe të adhuronin tjetër perëndi përveç së tyres. (Daniel 3:28)

Zoti kishte arritur të kishte vëmendjen e mbretit dhe respektin e tij. Por Nebukadnetsari ende nuk e njohte mirë Zotin—jo aq sa Pali pas eksperiencës në rrugën për Damask. Mbreti ishte ende larg për të pohuar si Pali: “Gjithsecili të jetë plotësisht i bindur në mendjen e tij.” (Romakëve 14:5)

Në të kundërt, Nebukadnetsar shpalli një tjetër vendim tiran:

“Kushdo, cilitdo populli, kombi o gjuhe që t’i përkasë, që do të flasë keq për Perëndinë e Shadrakut, të Meshakut dhe të Abed-Negos, të pritët copë-copë dhe shtëpia e tij të katandiset në një vend plehrash, sepse nuk ka asnjë perëndi që mund të shpëtojë në këtë mënyrë.” (Danieli 3:29)

Përmes demonstrimit të forcës, Zoti kish bërë të mundur që Nebukadnetsari të ndërmernte një hap para drejt përlules dhe të kish dëshirën për të dëgjuar. Kurse mbreti, nga ana e tij, mbeti tek përdorimi i forcës për të detyruar njerëzit e tij të tregonin respekt për këtë zot të plotfuqishëm.

Nebukadnetsar me sa duket nuk ishte akoma gati për të marrë dhuratën e mrekullueshme të miqësisë e Gjoni 15:15.

Në një rast të shënuar, Danieli mori përsipër të informonte mbretin se Zoti priste prej tij që ti trajtonte nënshetësit e mbretërisë me më shumë dashamirësi:

“Prandaj, o mbret, prano këshillën time: jepu fund mëkateve të tua duke praktikuar drektësinë dhe paudhësive të tua duke treguar mëshirë ndaj të varfërve; ndofta begatia jote do të zgjasë.” (Danieli 4:27)

Dhe më herët, Nebukadnetsari kishte shprehur admirim për besimin e treguar në Zotin e tre hebrenjve të rinj.

Më në fund, pas shumë vitesh mashtrimesh, mbreti ishte bindur të pranonte publikisht se “Ai i Plotëfuqishmi mbretëron në mbretërinë e njerëzve dhe ua fal atë të përzgjedhurve të tij. Ai vepron sipas vullnetit të tij me mbretërinë në parajsë dhe me ata që jetojnë në tokë. Askush nuk mund ti kundërvihet pushtetit të tij apo të vërë në dyshim atë çfarë ai bën.”

“Tani, unë Nebukadnetsar, i lutem, lartësoj dhe nderoj Mbretin e hyjnishtëm; sepse të gjithë veprimet e tij janë të mira dhe mënyrat e tij të drejta, dhe ai mund të gjykojë ata sjellja e të cilëve është arrogante.”

“Është kenaqësia ime,” deklaroi mbreti, “të listoj shenjat dhe mrekullitë që Më i Madhi Zot më ka shfaqur mua: sa të mëdha janë shenjat e tij, sa të madhërishme mrekullitë e tij!” (Danieli 4:32,35,37,2,3)

Nebukadnetsar ishte ende i impresionuar nga fuqia, e megjithatë ai theksoi se përdorimi i forcës nga Zoti është me vend dhe e drejtë. Por këtë herë ai nuk e pasoi rrëfimin e tij me një urdhër të egër se të gjithë ata që nuk e ndiqnin në adhurimin e Zotit të Qieellit do të “priteshin copa-copa, apo do hidheshin në zjarrin përvëlues”.

Interesante, a Nebukadnetsari vazhdoi të bëhi më shumë se një shërbëtor i përlurur që vetëm pranonte autoritetin e Zotit të tij sovran?

Historia e jetës së tij në Bibël përfundon pa na thënë nëse ai u mësoi njerëzve për dashurinë dhe besimin - kaq ndryshe nga historia e miqve të Zotit, Moisiut dhe Palit.

Ndoshta Nebukadnetsari duhet të mësojë ende për lirinë në miqësi në jetën tjetër. Dhe si një shërbëtor i bindur dhe i përlurur, ai do ketë vullnetin për të dëgjuar.

“As prej forcës as prej fuqisë”

Vendi ku Nebukadnetsari urdhëroi njerëzit e tij të gjunjëzoheshin nuk është shumë larg nga qyteti i kohëve tona i quajtur Bagdad, kryeqyteti i Irakut. Ka të dhëna se ish sunduesi i këtij vendi kishte një admirim të madh për mbretin e Babilonisë së lashtë. Por admirimi i tij nuk çoi në kohë paqeje midis shteteve të Lindjes së Mesme.

Sikur Nebukadnetsar të kishte shërbyer si model i udhëheqësit midis miqve, në qeverisje të përkushtuar ndaj bashkimit që bazohet në besim dhe jo në forcë dhe frikë. Por, nëse do të ishte kështu, sigurisht që disa nga liderët e kohëve tona nuk do ta konsideronin si me vlerë për tu adhuruar!

Sa e madhe do ishte dëshira e Zotit, që besimi dhe miqësia të restauroheshin në atë cep të botës ku shumica e njerëzve janë bij të mikut të tij të vjetër Abraham.

Atëherë pse nuk zbret Ai i gjithëpushtetshmi dhe të vendosë vullnetin e tij? A nuk na mësoi vetë Jezusi se “për Perëndinë çdo gjë është e mundur”? (Mateu 19:26) A do të kishte guximin ndonjëri të sugjeronte se ka gjëra që Zoti nuk mund t’i bëjë?

Por, nëse Ai nëpërmjet fuqisë dhe pushtetit mund t’i kthente që të gjithë në Lindjen e Mesme – për të mos përmendur pjesën tjetër të botës – në miq të dashur dhe të besueshëm, atëherë kush do të akuzohej për armiqësi dhe urrejtje të vazhdueshme?

Zoti iu përgjigj Vetë këtyre pyetjeve. Dhe pjesa tjetër e Biblës është dëshmi e besimit dhe kuptimit të shpjegimit të Tij.

“Jo për fuqinë dhe as për forcën, por për Frymën tim,” thotë Zoti i ushtrive.” (Zakaria 4:6)

Ky mesazh iu trasmetua nga profeti Zakaria Zerubabelit, sunduesit të Israelit që sapo ishte kthyer në Jude nga mërgimi në Babiloni.

Pas 70 vitesh të kaluara në robëri, njerëzve u ishte ofruar tashmë një mundësi për të treguar se ishin pasardhës të denjë të atit të tyre Abraham, një mundësi për të jetuar së bashku në paqe dhe harmoni dhe Jeruzalemi do të njihej si “Qyteti i të Vërtetës”, “Qyteti i Besnikërisë”. (Zakaria 8:3)

Ky do ishte një vend kaq miqësor dhe i sigurt sa “nëpër sheshet e Jeruzalemit do të ulen akoma pleq e plaka, secili me shkopin e vet në dorë për shkak të moshës së shtyrë. Sheshët e qytetit do të jenë plot e përplot me djem dhe vajza që do të lozin në sheshët e tij.” (Zakaria 8:4,5)

Lajmi mbi ndershmërinë dhe mirësinë e njerëzve në Jeruzalem do të përhapej aq larg sa “shumë popuj dhe kombe të fuqishëm do të vijnë të kërkojnë Zotin e ushtrive në Jeruzalem dhe ti përgjërohen fytyrës së Zotit. . . Në ato ditë dhjetë burra nga të gjitha gjuhët e kombeve do të zënë një jude nga cepi i robës do të thonë: ‘Ne duam të vijmë me ju sepse kemi dëgjuar se Perëndia është me ju.’”(Zakaria 8:22,23)

Kjo është ajo që Zoti gjithnjë ka dëshiruar për pasardhësit e mikut të tij Abraham,—por jo vetëm për ata, por për të gjithë ata që përmes miqësisë dhe besimit në bijtë e Abrahamit do të donin të njihnin të vërtetën për Zotin që besonte Abrahami.

Por mesazhi që Zoti i çoi Zerubabelit ishte që, sado shumë ai të donte të ndihmonte Izraelin dhe njerëzit të bëheshin kështu, Ai nuk do ta përmbushte këtë përmes forcës dhe fuqisë, por vetëm përmes mënyrës në të cilën punon Fryma e Shenjtë.

Dhe ndërsa askush nuk mund të kundërshtojë vullnetin e Zotit, si Nebukadnetsari e kuptoi më në fund, akoma është e mundur për njeriun më të dobët në botë ti thotë JO shushuritjes së ëmbël të dashurisë dhe të vërtetës.

Përmes forcës dhe fuqisë Zoti i dha ekzistencë universit të madh. Por as fuqia e pafund nuk mund të siguronte besnikërinë e Luçiferit, (Zbulesa 12:7-9) engjëllit të tij më të shkëlqyeshëm, apo të bindte shumë prej fëmijëve të Adamit dhe Evës për të dashur dhe besuar Krijuesin e tyre.

Përmes fuqisë dhe forcës – kur gati kishte humbur kontaktin me racën njerëzore—Zoti me dhimbje përmbysi botën.

Por forca dhe fuqia nuk i siguruan besimin e pasardhësve të Noes. Ata nuk dyshonin në ekzistencën e Zotit. Ata pranonin fuqinë e Tij superiore.

Por sikurse djalli përshkruan në librin e Jakobit, ata dridheshin nga frika kur mendonin për Zotin. (Jakobi 2:19) Mund të thuhet se ata besonin në Zot, por ata nuk kishin dëshirë t'i besonin Atij si mik. Në të kundërt ata ndërjuan kullën e Babelit për t'u larguar prej Tij.

Përmes fuqisë dhe forcës Zoti shpëtoi nga robëria egjiptiane njerëzit e Tij dhe i vendosi ata në tokën e Kanaanit. Por fuqia e Tij nuk bëri që njerëzit ta besonin.

Vazhdimisht ata tregonin më shumë adhurim për perënditë e tyre mizor paganë.

Mbreti Solomon e njohu aq mirë Zotin sa i frymëzuar prej Tij shkroi librin e Fjalëve të Urta. Por më vonë edhe ai sakrifikoi disa prej fëmijëve të tij për nder të zotit Molek. (1 Mbretërit 11:7,8; 2 Mbretërit 23:10)

“Por përmes Frymës time,” thotë Zoti i ushtrive

Nuk ishte prej mungesës së fuqisë apo forcës që Zoti i çoi atë mesazh Zerubabelit.

Ishte vetë “Zoti i ushtrisë” Ai që i foli.


Kush do ti njihte më mirë kufinj të përdorimit të forcës?

Disa e interpretojnë Zakarian 4:6 për të theksuar se qëllimi i Zotit nuk mund të përmbushet nga *forca njerëzore apo nga fuqia e njerëzve*, por vetëm përmes fuqisë dhe forcës së vetë Zotit.

Por atëherë kjo do të ishte si kontradita me mënyrën se si vepron Fryma e Shenjtë.

Gjërat që Zoti dëshiron më shumë—një paqe që zgjat, liri, besim dhe miqësi, —nuk mund të arrihen përmes forcës, aq më pak prej frikës.

Nëse gjithçka që Zoti do të dëshironte do ishte bindja dhe shërbim pa përdorur mendimin, Ai do ta kishte bërë këtë të mundur në një çast të vëtëm.



“Gjunjzohuni, ose Unë do t’ju hedh në flakët e zjarrit!”

Por Zoti nuk është Nebukadnetsari hyjnor.

Ai do preferonte të vdiste se sa të mbretëronte përmes forcës dhe frikës. Dhe në ditë, për ta bërë këtë të qartë përgjithmonë, kjo në të vërtetë i kushtoi Atij vdekjen.

Jezusi shpjegoi se si punon Fryma e Shenjtë. Ajo mëson, Ajo bind, dhe përgjeron.

Kjo s’do të thotë se Fryma e Shenjtë zotëron më pak fuqi dhe pushtet se Ati dhe Biri, sepse në fakt Ajo gjithashtu është Perëndi.

Por Ajo punon veçanërisht me fuqinë më të madhe dhe më jetëgjatë- autoritetin bindës të së vërtetës. Pali flet për fuqinë e së vërtetës për ti kthyer njerëzit në besim. (Romakëve 1:17)

Por kjo lloj fuqie nuk është e pranueshme për të gjithë.

Ajo është efikase vetëm në ata që kanë vullnetin për të dëgjuar, ata që janë të prekur thellësisht, jo nga bubullimat e malit të Sinait, por nga e vërteta e treguar në dashuri.

Fryma ishte në anën e Judës ndërsa Mësusi po i lante këmbët e ndotura tradhëtare.

Engjëjt besnikë duhet të jenë tronditur teksa shihnin Krijuesin e universit, atë të cilin ata adhuronin dhe nderonin, të gjunjzohej për t’i larë këmbët me përlujtje dhe të vihej në shërbim të dishepullit të tij të pa besë.

Fryma e Shenjtë po u fliste engjëjve gjithashtu, dhe të kuptuarit e tyre për Zotin e mëshirshëm duhet të jetë rritur atë pasdite në sallën e sipërme.

Por Juda, tradhëtari, mbeti i pa paprekur. Ai i tha JO shushurimës së ëmbël të Frymës së Shenjtë

Pse një Zot i zemëruar nuk e dënoi atë për refuzimin jofisnik që i bëri kësaj bindjeje të dashur?

Engjëjt ishin ende duke mësuar, ndërsa Ati në trishtim lejoi një prej bijve të tij jobesnikë të mbante pasojat e veprimit.

Pas disa orësh, në errësirën e tij mohuese të të vërtetës, Juda vrau veten.

Vite më vonë, Fryma e Shenjtë, frymëzoi Gjonin të shkruante një përshkrim të kësaj ngjarjeje të paharrueshme, në mënyrë që ne sot të kishim mundësi ta lexonim.

Atëherë, ndoshta shumë prej nesh, do të ishim prekur fuqishëm, ashtu si ishin engjëjt, për të besuar më shumë në një Zot kaq të hirshëm. (Gjoni 13:1–20)

Një besim i tillë nuk komandohet. Ai nuk fitohet nga kërcënimi për shkatërrim. Kjo fitohet nga e vërteta mbi Zotin, që në mënyrë prekëse është portretizuar në këtë dhomë, dhe në qindra raste të tjera të shpalosura në 66 librat.

Kjo është metoda e fuqishme që Fryma e Shenjtë kërkon të përdorë për të përmbushur qëllimin e Zotit: për të mbushur universin me miq të besueshëm.

“ ‘Jo për fuqinë dhe as për forcën, por për Frymën tim,’ thotë Zoti i ushtrive.” (Zakaria 4:6)

S

5. KUJDES NË ÇFARË BESONI

tudime të kohëve të fundit tregojnë se njerëzit më të besuar në shoqërinë tonë janë pastorët dhe mjekët. Më pak të besuarit janë politikanët dhe shitësit e makinave të përdorura –megjithëse disa janë të mendimit se përfaqësuesit e ligjit duhet të jenë në fund të listës.

Njëherë më ndodhi të shihja një bluzë me një stampë të madhe të një peshkaqeni të uritur dhe me mesazhin, “Peshkaqenët nuk hanë avokatët: Xhentilesë profesionale!”

E gjithë kjo mund të tingëllojë aspak e këndëshme për këto profesione.

Padyshim që kjo tingëllon e padrejtë për përfaqësues të këtyre profesioneve që aktualisht janë modele të mirë besimit.

Dhe nga ana tjetër fakti që një person ka zgjedhur të jetë predikues i Ungjillit nuk na garanton se ai është një person krejtësisht i besueshëm. Përkundrazi, shumë shpesh kronikat mbi tragjeditë në lajme provojnë të kundërtën.

Studime të shumta janë bërë gjithashtu për të matur tendencat në mendimet e njerëzve mbi besimin në Zot. Me sa duket edhe në vende të ashtu quajtura kristiane të botës, besimi në Zot ka pësuar rënie serioze.

Zoti duhet të ndjehet i lënduar ndërsa mëson për këto tendenca. Por jo për arsyen më të dukshme, që njerëzit duket sikur i besojnë më pak Atij. A janë njerëzit duke refuzuar Zotin miqësor të Abrahamit, Moisiut dhe Jakobit, Zotin që ashtu si Jezusi do që të jemi miq me Të?

Ndoshta është shkaku për shpresë nesër njerëzit mendimtare e gjejnë të pamundur ti besojnë zotit që në fakt nuk e meriton besimin e tyre. Ajo që më shumë i sjell keqardhje Zotit është se shumë nga bijtë e Tij nuk e njohin Atë se si është.

Ç’do të mendoit para faktit se Zoti i gjithëpushtetshëm por dhe i mëshirshëm, një Zot që mbi të gjitha vlerëson lirinë dhe individualitetin tonë dëshiron të na trajtojë jo si shërbëtorë por si miq?

A ka kuptim të besosh pa prova?

Si mundet ti bindi Zoti bijtë e Tij mbi të vërtetën për Vehten e Tij?

“Kjo është diçka që një person e pranon përmes besimit,” kjo është përgjigjia tradicionale e shumë besimtarëve të devotshëm.



“Besimit në çfarë?” mund të pyesnit ju.

“Jo, unë nuk do të them të besosh në diçka apo tek dikush,” përgjigjet besimtari. “Unë nënkuptoj se ka shumë gjëra të cilat ti mund ti njohësh vetëm përmes besimit.”

Kjo do të thotë të përdorësh fjalën “besim” për të përshkruar një mënyrë që përdoret për të njohur gjërat në mungesë të provave të mjaftueshme ose të asnjë prove fare.

Ka dhe një legjendë për këtë, një djalë në shkollë i pyetur nga mësuesi se çfarë është “besimi” u përgjigj: “Të besosh në diçka për të cilën di që s’është ashtu”

Sigurisht pak besimtarë do të shkonin kaq larg. Por disa kanë shpjeguar se “besimi është të besosh kur arsyeja të thotë të mos besosh.”

A është kjo arsyeja pse shumë njerëz e kanë të vështirë të besojnë në Zot? A ndodh kjo sepse ata thjesht e kanë të pamundur ose nuk dëshirojnë të bëjnë diçka që shkon kundër arsyes dhe logjikës së tyre?

Gjatë gjithë jetës së tyre fëmijët dëgjojnë prindërit e tyre që u lutën të përdorin sa më shumë arsyen. A mund t’u themi atyre që kur çështja është për të besuar Zotin, të ndjehen të sigurt dhe të mos e përdorin këtë rregull?

“Unë thjesht e di se kjo është e vërteta”

Në një ditë pranvere një dekanë e një kolegji të krishterë ftoi një student për ta bërë të mendonte mirë para se të martohej me vajzën me të cilën ai prej kohësh shoqërohej.

“Djalë i ri, ti në të vërtetë nuk ke patur shumë mundësi dhe kohë për ta njohur dhe besuar këtë vajzë të re. A nuk mendon se arsyeja të sugjeron se duhet ta njohësh mirë dikë para se të ndërmarësh një vendim të rëndësishëm dhe final?”

“Unë nuk kam nevojë t’a njoh më mirë. Unë jam lutur për këtë, dhe kam një ndjenjë të fortë besimi se ajo është gruaja që Zoti do që unë të zgjedh për të qenë bashkëshortja ime”

“A s’e di ti, djalë i ri, se jo gjithnjë është e sigurt t’u besosh vetëm ndjenjave—veçanërisht në pranverë. Duhet të jesh shumë i kujdesshëm kur të duhet të zgjedhësh personin me të cilin dëshiron të kalosh pjesën tjetër të jetës.”

“Por a nuk na thatë ju dekanë, në predikimin e djeshëm, se kur të duhet të vendosim për t’i hapur zemrën Zotit, ne nuk duhet të jemi dyshues dhe të bëjmë shumë pyetje ashtu siç bëjmë në shkencë dhe histori?”

“A jeni duke më thënë se kur çështja është të zgjedhësh një shoqe me të cilën të kalosh jetën, ne duhet të jemi dyshues? Por kur çështja është në zgjedhjen e Zotit me të cilin do të jetojmë në përjetësi, ne mund të besojmë të sigurt zemrave tona në vend të mendjes?”

“Djalë i ri, ky është ndryshimi midis dijes sekulare dhe besimit fetar. Kur duhet të vendosim për çështje shpirtërore, ne nuk duhet kurrë të lejojmë arsyen tonë të na ndërpresë rrugën drejt zemrës.”

“Faleminderit, dekanë, për këshillën tuaj. Por unë e kam vendosur tashmë dhe jam i bindur. Në fakt, ajo e ka pranuar propozimin tim tashmë dhe ju jeni e ftuar në dasmën tonë. Por mos u shqetësoni, ç’do gjë do të shkojë mirë. Brenda zemrës time unë e di se ajo është e duhura për mua.”

Kohët e fundit kam dëgjuar një predikues të pohojë me zë të lartë,

“Unë besoj se mund të mbeshtetëm në Zot sepse nga besimi e di se kjo është e vërteta.

Doni t’a dini se si jam kaq i sigurt për të vërtetën? Unë thjesht e di se e di që ajo që di është e vërtetë!”

“Nga buron një besim i tillë?” ju mund të pyesni.

“Është një dhuratë e Zotit, një fryt i Frymës së Shenjtë.”

“Atëherë pse nuk iu është dhënë të gjithëve kjo dhuratë?”

“Oh, Zoti ia jep besimin vetëm të përzgjedhurve të tij. Dhe nëse kjo të bën të mendosh se Zoti është arbitrar dhe i padrejtë, kujto vargjet e Palit tek Romakët 9:20 për të mos vënë në dyshim mënyrat e panjohshme të Zotit.”

Por shumë njerëz zor se kanë ditur të gjejnë përgjigje për këtë zgjedhje të Zotit, dhe duke dështuar për ti dhënë përgjigje pyetjes, kanë zgjedhur të mos besojnë në Zot dhe t’i largohen Atij.

A mundet që dikush të refuzojë dhuratën e besimit?

Ka dhe një mënyrë tjetër për të shpjeguar se pse nuk e zotërojnë të gjithë dhuratën e besimit. Argumenti pse Zoti ja dhuron besimin disave dhe jo të gjithëve çënon dy dhurata të tjera që Zoti u ka bërë njerëzve – lirinë dhe fuqinë e zgjedhjes.

Disa njerëz besojnë se Zoti ja bën këtë dhuratë të gjithë njerëzve, dhe çdo njeri ka lirinë të zgjedhë për të pranuar për të besuar ose të refuzojë besimin dhe të thotë jo. Fatkeqësisht disa zgjedhin të refuzojnë. Shumë nga ata që vendosin kështu, sidoqoftë, akoma e kuptojnë besimin si aftësinë e dhënë nga Zoti për të besuar me vullnet të plotë pa nevojën e fakteve.

Por kjo akoma nuk i jep përgjigje pyetjes: Mbi çfarë baze dikush vendos të bëjë zgjedhjen jetësore për të pranuar dhuratën e besimit apo për t'a refuzuar atë? A është pranimi i dhuratës së besimit nga Zoti një akt besimi në vetvete – një besim që akoma nuk është marrë? A i përshtatet kjo arsyes suaj? Duke rikujtuar përskrimet mbi besimin, dikujt mund ti duket e pamundur të besojë pa përdorur arësyt.

Kush është ndryshimi midis Belief, Faith, and Trust?

Të tre sinonimet Angleze, *faith*, *belief* and *trust*, janë përkthime të të njëjtës fjalë Greke *pistis*. Për shembull, kur i burgosuri Filip pyeti Pjetrin dhe Silas se ç'duhej të bënte që të shpëtohej, ata i dhanë përgjigjen që është bërë objekt i shumë predikimeve.

Por çfarë i thanë ata saktësisht? Vepra 16:25-34

“Beso (*believe*) në Zotin Jezu Krisht”, 1611 *King James version*.

“Vendos besimin (*faith*) tënd në Zotin Jezu Krisht,” 1989 *God's New Covenant* translation.

“Vendos besimin tënd (*trust*) tek Zoti Jezu Krisht” 1989 Bibla Angleze e rishikuar.

Besimi (*Belief*, *faith*, *trust*)—ato janë të gjithë në thelb të njëjtë. Nëse *faith* dhe *trust* janë besim i çiltër, dhe *belief* më shumë se thjesht një opinion apo shpresë, mund të përcaktohen nga konteksti në frazën ku janë përdorur.

Tek libri i Gjonit mund të vërejmë se edhe për djajtë mund të themi se kanë *besim* tek Zoti.

Në këtë kontekst, Gjoni shpjegon se në çfarë ata besojnë tek Zoti, dhe çfarë i bën ata të dridhen nga frika . (Gjoni 2:19)

A është besimi tek Zoti një kapërcim në errësirë?

Duhet të besojmë tek Zoti, ose kurrë nuk mund ta kemi miqësinë e Tij (Gjoni 15:15.) Por Ai nuk do që ne ta besojmë Atë si një të huaji.

Të besosh dikë të cilin nuk e njeh mund të bëhet për ne një kapërcim në errësirë.

Zoti nuk na inkujaron të ndërmarrim një rrezik të tillë.

Mendoni për mënyrat që Ai ka përdorur për të na prezantuar vehten e tij. Në mënyra të shumta dhe të ndryshme, Ai na ka folur përmes profetëve.” (Hebrejtë 1:1)

Për më tepër, Ai “na ka folur përmes Birit”— të Vetmit që munda të thotë në fund të jetës së Tij të pakrahasueshme, “Nëse më keni parë Mua, ju keni parë Atin.”(Hebrejtë 1:2; Gjoni 14:9)

Mënyra se si jetoj Jezusi, mënyra se si Ai i trajtoi njerëzit, gjërat që Ai u mësoi për Atin e Tij, dhe mbi të gjitha mënyra unike dhe e tmerrshme se si Ai vdiq, ishin zbulesa më e pastër mbi të vërtetën për besimin në Zotin të cilën universi mund ndonjëherë të shohë.

Kjo nënkupton, sigurisht, besimin tek mësimet e Biblës. Të besosh tek Bibla nuk do të thotë dhe nuk presupozon një kapërcim në errësirë.

Ka edhe dokumenta të tjerë fetarë që na ftojnë në këtë “udhëtim fetar”. Por Bibla vetë na imponon një vështrim të kujdesshëm mbi dëshmitë para se të zgjedhim të vendosim të besojmë.

Një akuzë e vjetër

Sipas historisë në librin e Zanafillës, i pari që argumentoi se Zoti nuk duhej të besohej ishte gjarpri në kopshtin Eden. Tek libri i Zbulesës gjarpri identifikohet dhe akuzohet si “Djall dhe Satan, mashtrues i të gjithë botës.”

Ai përshkruhet si lider i rebelimit në Qiell, karakteristikë që përcakton qënien e tij si “i hedhur në këtë tokë, dhe engjëjt e tij u hodhën së bashku me të.” (Zbulesa 12:7-9)

Emrat Djall dhe Satana të dy nënkuptojnë *paditës* dhe *kundërshtar*.

Edhe vetë Jezusi, që ishte aq i mëshirshëm me të gjithë mëkatarët, e quajti “një gënjeshtar dhe baba të të gjitha gënjeshtreve.” (Gjoni 8:44)

“Zoti ju ka gënjyer,” ishte ajo që u la të nënkuptonin Satani prindërve të parë të racës njerëzore. “Si mund ti besosh një Zoti që nuk thotë të vërtetën? Nëse hani nga pema e ndaluar (Zanafilla 3) ju nuk do të vdisni. Në fakt, ngrënia e fruteve të asaj peme do t’ju bëjë juve më të ngjashëm me Zotin. Si mund Ai me kurnacëri t’ju privojë nga diçka kaq e dobishme? Dhe si mund të jetë Ai kaq pa zemër dhe i pafalshëm sa t’ju kërcënojë me vdekje vetëm për një mosbindje të vëmtë? Në fund të fundit një Zot që ju do të paktën do t’ju japë një shans të dytë? ‘M’u bindni mua, ose do të vdisni!’ si mund të adhuroni dikë që është kaq i rreptë dhe hakmarrës? Një Zot kaq kërkues dhe arbitrar nuk ia vlen të adhurohet dhe besohet.”

Nëse Zoti është ashtu siç e ka përshkruar Satani se Ai është, kundërshtari ka të drejtë që nuk mund të besohet një tiran. Dhe sigurisht që s’do ketë mundësi për të vendosur marrëdhënien e lirisë dhe miqësisë të ofruar nga Jezusi dishepujve të Tij.


Por akuzat e ngritura nga Satani drejtoheshin pikërisht ndaj Jezu Krishtit Miqësor. Sepse Ai që erdhi të na sjellë të vërtetën është vetë Krijuesi i universit. (Gjoni 1:1-3; Kolosianët 1:16)

Përgjigjja e Zotit

A iu përgjigj Zoti këtyre akuzave? A janë përgjigjet e Tij baza e besimit tonë?

Thjesht mohimi nuk është mjaftueshëm për t’u përballur me akuza të tilla. Edhe nëse mohimi vjen nga vetë Zoti, si mund të jemi të sigurtë nëse ato çfarë Ai thotë janë të vërteta? Satani gjithashtu na ka paraqitur dëshmitë e tij, në shumë raste madje me tërë forcën e autoritetit të tij. Por as dëshmitë dhe as shfaqja e fuqisë superiore nuk mund të vendosin integritetin dhe besimin.

Vetë Jezusi terhoqi vemendjen kundër besimit në dëshmi të rreme, edhe në rastet kur këto mbështetëshin nga fuqi e dukshme mbinatyrore. Ai foli për udhëheqës fetare që do ngriheshin, të cilët do të jepnin dëshmi të rreme - madje edhe duke pohuar se ishin Krishti!



Ata do të kryejnë mrekulli të mëdha dhe çudi për të provuar të vërtetën e dëshmimeve të tyre. “Por mos iu besoni,” tha Jezusi. (Mateu 24:23, 24) “Kujdes,” Ai paralajmeroi, “dhe mos lejoni t’ju mashtrojnë. Shumë burra, që do pohojnë se flasin për mua, do vijnë tju thonë, ‘Unë jam Mesia! dhe ata do mashtrojnë shumë njerëz.’” (Mateu 24:4, 5)

“Miqte e mi të dashur,” këshilloi më vonë apostulli Gjon, “mos u besoni atyre që thonë se kanë Frymën, por i vini në provë për të zbuluar nëse fryma që kanë vjen prej Zotit.

Sepse shumë profetë të rreme janë përhapur kudo.” (1 Gjoni 4:1)

Në përshkrimin e tij për përpjekjen që bën Satani për të përfshirë të gjithë botën në anën e tij pikërisht para ardhjes së dytë të Jezus Krishtit, Gjoni flet për autoritetin dhe fuqinë e Djallit të shoqëruara nga përmbushja e mrekullive të mëdha, madje edhe duke bërë që “zjarri i parajsës të vije në toke para syve të të gjithëve.”

Si rrjedhojë, “të gjithë njerëzit që jetojnë në tokë” do të mashtrohen “përmes mrekullive”—përveç atyre të paktëve besnike të Zotit. (Zbulesa 13:8, 12-14)

Sergej Torop, Krishti i rrëmë në Siberi

Profetet, gjithashtu, mund të gënjejnë

Kohe më parë Moisiu i kishte paralajmëruar fëmijët e Izraelit të mos mashtrohen nga mrekullite .

“Një profet ose interpretues i ëndrrave mund të premtojë një mrekulli osë një çudi, në mënyrë që t’ju bëjë ta adhuronit dhe shërbeni zotërve të cilët nuk I keni adhuruar me pare. Edhe nese ajo çfare ai premton realizohet mos I kushtoni rendesi atij.” (Ligji i përtërirë 13:1-3)

Tek Testamenti i Vjetër, historia tregohet nga një profet nga Judah që u çua nga Zoti për të përcjellur një mesazh tek Mbreti Jeroboam.

Pasi të kishte përmbushur misionin e tij, ai duhej të refuzonte ç’do ftesë për mikpritje dhe të kthehej në shtëpi nga një rrugë tjetër nga ajo në të cilën do shkonte.

Ky “njeri i Zotit” ishte një shërbëtor besnik I Zotit dhe ishte betuar t’i bindej pa bërë asnjë pyetje.

“Zoti e ka thënë ! Unë e besoj ! ” ishte menyra e tij e përlulur për të përcaktuar të vërtetën.

Profeti e përçoi mesazhin e tij. Dhe kur mbreti e ftoi të qëndronte dhe të hante diçka, s’kishte hezitim në përgjigjen:

“Edhe nëse do të më ofronit gjysmën e pasurisë tuaj, unë nuk do vija me ju apo të haja apo të pija me ju. Zoti më ka urdhëruar që të mos ha ose pi asgjë dhe të mos kthehem në shtëpi nga e njëjta rrugë në të cilën erdha.” (1 Mbreterit 13:8, 9)

Bijtë e një profeti të vjetër, i cili jetonte aty pranë, i treguan atit të tyre për këtë sjellës të mesazhit nga Judah dhe për çfarë ai i tha mbretit.

“Nga cila rrugë iku ai ?” pyeti plaku.

Ata i treguan atij rrugën.

“Më bëni gati gomarin,” ai urdhëroi bijtë e tij, dhe pastaj u nis të arrinte djaln e ri që i bindej Zotit.

Ai e gjeti atë ndërsa ishte ulur nën një pemë ahu përgjatë rrugës.

“ A je ti profeti nga Juda?” e pyeti plaku.

“Unë jam.”

“Atëherë eja në shtëpi dhe ha diçka me mua.”

“S’mundem. Zoti ma ka ndaluar rreptësisht të ndaloj dhe të ha me dikë gjatë këtij udhëtimi. Dhe kur Zoti më thotë ç’të bëj, ky është urdhër për mua.”

“S’ka problem,” tha plaku. “ ‘Unë, gjithashtu jam një profet si ti, dhe me urdhër të Zotit një engjëll erdhi dhe më tha të vija të të ftoja në shtëpinë time.’ ”

Por profeti plak po gënjente.” (1 Mbreterit 13:18)

“Do të thuash se Zoti ka ndërruar mendje? Mirë, sikurse unë them gjithnjë, ‘Nëse e ka thënë Zoti, unë e besoj.’ ”

I mashtuar , njeriu besues nga Judah shkoi në shtëpi me profetin e vjetër. Historia ka një fund të trishtë dhe një njeri mund të pyesë: “Pse është përfshirë kjo histori në Bibël?” Profeti i ri nuk kishte arsye të dyshonte se burri plak po gënjente. Do ishte e pakëndëshme që ai të kishte dyshuar. Por ai gjithashtu nuk kishte asnjë arsye për të pranuar pa dyshuar më parë në kontradiktën në urdhëresat e Zotit. Sikur ai të kishte mundur me edukatë të ushtronte të drejtën e tij për të dyshuar.

Sa shpesh në kohët moderne ne dëgjojmë për dëshmi të mësuesve të fesë se Zoti, përmes engjëve të Tij apo Frymës, u ka thënë atyre kështu apo ashtu. Do ishte e paedukatë ta mohojë këtë. Përveç kësaj, Zoti shpesh ka folur duke përdorur këtë mënyrë. Por Zoti gjithashtu na ka këshilluar të bëjmë kujdes. Profetët, gjithashtu , mund të gënjejnë.

A do të blinit ilaçe nga ky njeri?

Me 1902 Sears, katalogu Roebuck në Amerikë ofroi ilaçe të papara më parë.

‘Një lehtësim i shpejtë ofrohet për dhimbjet që mjekësia moderne akoma përpiqet t’u gjejë zgjidhje. Gjithçka vjen me siguri absolute nga Sears.

Me siguri ka një Kurë të Sigurtë për vesin e duhanit, të pijes, të opiumit, morfinës, dhe obezitetit.

Ka një Kurë Meksikane për Dhimbjen e kokës, “e garantuar për sukses” për të lehtësuar dhimbjen e kokës brenda 15 minutash... nëse merret 15 minuta para se të fillojë dhimbja e kokës.

Ekzistojnë Vaferet Franceze Komplekse me Arsenik të Dr. Rose’s , “të padëmshëm totalisht” dhe të sigurtë se e bëjnë cilindo të bukur, “s’ka rëndësi se çfarë shpërfytyrimi keni.”

Pilulat e Dr. Hammond për Nervat dhe Trurin, “të garantuara për rezultatet” për të kuruar një listë të pafund sëmundjesh, madje edhe humbjen e memories. “S’ka rëndësi kush është shkaku apo sa i rëndë është shqetësimi juaj, Pilulat e Nervave dhe të Trurit të Dr. Hammond do t’ju shërojnë.”

Klientët kërkues sigurohen se ilaçet e Sears janë përgatitur nga receta të siguruara nga “autoritetet më të larta mjekësore,” dhe ai paralajmëron të “kemi kujdes nga doktorët e pazotë të cilët premtojnë shërim kundrejt pagesave të mëdha.”

Sears, Roebuck do të ishin të parët që do lajmëronin konsumatorët për të mos u besuar këtyre thënieve!

Rreth e rrotull nesh, në rrethin e besimtarëve, në supermerkatë, në ekranin e televizorit, në vazhdimësi përballemi me dëshmi të tilla. Padyshim që shumë prej tyre s’mund të jenë të vërteta.

Do bënim mirë të ndiqnim këshillën e apostullit Pal: “Provoni të gjitha, Mbani të mirën.” (1 Thesalonikasve 5:21)

S’ka shkurtime në besim

Fakti që Bibla ngre pyetje, nxit kërkimin e kujdesshëm dhe paralajmëron për të mos qenë lehtësisht të bindur—edhe nëse na ndodh të ndeshim shenja mrekullish apo çudish- na tregon për besimin e plotë që duhet të kemi në atë libër.

Sigurisht edhe katalogu i Sears, Roebuck i paralajmëron klientët të bëjnë kujdes ndaj reklamave fallse.

Por unë nuk mund të besoj në një lëvizje fetare, mësues apo libër që është dekurajues- apo më keq akoma, ndalon pyetjet e sinqerta për besimet bazë.

Kur një mësues feje ndjehet i kërcënuar nga pyetje të respektueshme por dyshuese mbi Fjalën në klasën e tij, ai menjëherë mer pozicion vetëmbrojtës, madje edhe inatoset, ndërkohë që studentët shtojnë presionin e pyetjeve, atëherë mund të ketë vend për të dyshuar që pozicioni dhe informacionin që zotëron mësuesi ka mungesë provash, — dhe e gjithë kjo çënon themelet e besimit.

Besimi mund të shkatërrohet shumë shpejt. Dhe nuk ka programe që ta riinstalojnë atë. Pretendimet për të qenë I besuar nuk na provojnë asgjë. Hitleri pretendonte se ai ishte i besueshëm. Kur Satanai vuri në dyshim vërtetësinë e besimit të Jobit, Zoti nuk e zgjidhi këtë përmes shfaqjes hyjnore. Ndërkohë, ai lejoi që gjërat të ndodhnin, edhe pse demonstrimi i fakteve ishte i dhimbshëm në këtë rast. Kjo është mënyra e Zotit për të provuar të vërtetën.

Edhe pse Zoti është akuzuar me të padrejtë se është i pasigurt për t’u besuar, ka vetëm një mënyrë për të arritur tek Ai. Vetëm përmes besimit të plotë përgjatë një kohe të gjatë dhe nën presionin e rrethanave të ndryshme—veçanërisht në ato më të vështira—mundet që besimi të ri vendoset dhe konfirmohet.

Bibla— me të gjithë gjashtëdhjetë e gjashtë librat- është një provë e këtij demonstrimi.

Autoriteti i së vërtetës

Të dielën pasi Jezusi ishte kryqëzuar, ndërsa dy nga ndjekësit e tij të dekurajuar po shkonin në shtëpi tek Emmaus, besimi i tyre ishte vënë seriozisht në provë. Ata u çoroditën nga vdekja e Udhëheqësit të tyre, pasi ata “kishin shpresuar se ai do të ishte i vetmi që do ti sillte Izraelit lirinë” (Luka 24:21)

Jezusi i arriti rrugës , por ata gjithsesi nuk e njohën. Të dy burrat kishin pyetje të rëndësishme që kërkonin sigurisht përgjigje nga Zoti. Por Ai nuk u zbuloi kush Ai ishte.

Në vend të kësaj, ai i shoqëroi përgjatë Dhiatës së vjetër, që ishte libri në të cilin Zoti kishte folur “me mënyra të ndryshme dhe të shumta” “përmes profetëve”.

Më në fund të dy burrat e kuptuan se kishin marrë përgjigje për pyetjet e tyre- dhe pa e kuptuar aspak se ishte vetë Zoti që po i udhëhiqte përmes Shkrimeve të Shenjta.

Pse nuk u tregoi Jezusi se kush ishte?

Bazuar në nderimet dhe adhurimin për të ata do të kishin pranuar çfarëdo shpjegimi që ai t'u kish thënë.

“Nëse e thotë Jezusi, ne e besojmë, dhe kjo është baza e besimit !”

Unë besoj se kjo është arsyeja pse Jezusi mbeti i fshehur.



Ai nuk donte të rrezikonte që ata t'a besonin atë çfarë Ai u tha, bazuar vetëm në autoritetin e dëshmisë së Tij. Ai mund të ketë qenë Satani i maskuar, ai që “shndërohet në engjell drite.” (2 Korintasve 11:14)

Dhe Jezusi nuk u kënaq derisa të dy burrat arritën të besojnë bazuar mbi dëshmitë dhe provat. Vetëm atëherë ai u tregoi se kush Ai ishte.

Me sa duket Zoti nuk do që ne të besojmë në fjalën e Tij, vetëm për arsye se ne e dimë se kush është Ai, Krijuesi, Sovran i Universit.

Ai dëshiron që ne t'a besojmë pasi ne ta kemi njohur Atë ashtu siç Ai është.

Ai dëshiron që ne t'i besojmë Atij në dritën e së vërtetës.

K

6. MIQTË FLASIN HAPUR ME NJËRI - TJETRIN

a të krishterë që shqetësohen me të vërtetë se mos,

“A ekziston ndonjë rrezik që vetë theksi mbi rëndësinë e të pasurit miqësi me një Perëndi miqësor të prishë miqësinë e vërtetë me Të?”

Kjo çështje duhet marrë seriozisht në konsideratë, sepse shumë njerëve u duket e vështirë ta respektojnë Zotin si Krijues dhe si Mik të mirë në të njëjtën kohë.

Kjo ishte e de monstruar shumë mirë në Sinai – kur frika u kishte ikur, kur nuk kishte më shfaqje të fuqisë dhe madhësisë, përlujta ndaj Zotit nuk ekzistonte më.

Përsa kohë në qiell u shfaqën vetëtimat dhe toka filloi të dridhej nën këmbët e tyre, Izraelitët ishin gati të premtinin Zotit gjithçka.

Disa mund ta quajnë këtë nënshtrim si “respekt të vërtetë.” Por jo shumë kohë pasi vetëtimat në qiell ishin zhdukur, njerëzit filluan të kërcenin dhe adhuronin një imazh floriri të një viçi! (Eksodi 32)

Për sa kohë Jezusi ushqeu turmat, mjekoi të sëmurët dhe ngriti të vdekurit, njerëzit ishin të gatshëm ta adhuronin dhe ta kurorëzonin si mbret. Por kur ai iu përgjigj armiqve të tij me butësi, kur ai i trajtoi mëkatarët me durim dhe respekt, kur shpjegoi se Mbretëria e tij nuk bazohej tek forca, dhe kur me përlulësi ia nënshtroi veten e tij dhimbjeve dhe vuajtjeve në Kalvar, shumë nga ndjekësit e tij e braktisën ose u tallën me pohimin e tij se ishte Bir i Zotit.

Juda ishte njëri nga ata që keqkuptoi mirësinë për dobësi. Kur Jezusi u gjunjëzua ti lante këmbët, Juda e përçmoi Atë për përlulësinë e Tij. Zoti të cilit adhuronte Juda nuk do ta bënte kurrë këtë, të degradoheshe në këtë mënyrë.

Kush është për ju burim më i madh nderimi: manifestimi i tmerrshëm i fuqisë së Zotit në malin Sinai apo imazhi i përlotur i Krijuesit në malin e Ullinjve? Nëse të dyja historitë, ajo e malit të Ullinjve dhe ajo e atij të Sinait, na bëjnë të shohim Zotin si Mbret i madhërishtë dhe njëkohësisht si Mik i lavdishëm, atëherë ne mund të themi se kemi mësuar ta adhurojmë Zotin sipas mënyrës që ai do që ne ta nderojmë - nderim pa frikë, nderim si mik.

Miq të tillë mund ti kuptojnë më mirë mënyrat se si Zoti vepron, pasi Ai mund të flasë me ta në mënyrë të hapur. Këta ndryshe nga disa besimtarë që mjaftohen me shërbim dhe adhurim të përlulur, duan të dinë më shumë rreth Atij të cilin ata adhurojnë. Xhelozë për reputacionin e Zotit—ashtu si duhet që miqtë të jenë — ata kanë provuar se mund t'u besohen informacione që mund të ishin keqkuptuar ose keqpërdorur nga të tjerë.

Atyre Zoti mund tu shfaqë mirësinë e tij, pa patur frikë se ata do ta interpretojnë atë si dobësi. Ai mund tu pohojë atyre se për të më e rëndësishme është liria e tyre, pa patur frikën e zbehjes se respektit për disiplinën dhe rregullin. Ai mund tu tregojë atyre se është personifikimi i faljes, pa rrezikuar që ata ta marrin mëkatin më

pak seriozisht. Ai mund ti sigurojë ata që s'kanë përse të kenë frikë, pa lëkundur kështu nderimin dhe përluljen e tyre.

Jezusi nuk i zbuti fjalët kur paralajmëroi mbi rrezikun e përhapjes së një informacioni kaq të çmueshëm me ata që nuk janë gati ose nuk mundin ta kuptojnë atë, ose për ata të cilëve ky informacion mund ti duket ofendues.

Dhe kur ishte në fund të përshkrimit të tij të mrekullueshëm mbi Zotin në Predikimin në mal, Ai në mënyrë serioze këshilloi: **“Mos ua ofroni çfarë është e shenjtë qenve; mos i hidhni perlat përpara derrave, sepse përndryshe ata do ti shkelin ato me këmbë dhe do t'ju nëpërkëmbin edhe juve.”**(Mateu 7:6)

Nëse ky do t'ju duket si një pohim i fortë, trajtimi që iu bë Jezusit në tre vitet pasardhëse është pohim i vërtetësisë së paralajmërimit të Tij.

S'ka “shprehje të errëta” midis miqve

Imagjino sikur dëgjon Zotin që të thotë se Ai mund të flasë me ty ashtu siç nuk mund të bëjë me dikë tjetër, sepse ti je miku i tij.

Moisiu e mori këtë mesazh, dhe është interesante se si mund të jetë ndjerë ai teksa dëgjonte Zotin ti fliste Miriamit dhe Aaronit se Ai mund ti fliste më qartë vëllait të tyre sesa mund të bënte me vet profetët.

Miriam dhe Aaroni u bënë shumë xhelozë për marrëdhënien e veçantë të Moisiut me Zotin, edhe pse vetë Moisiu përshkruhet si njeri “shumë i përlulur, më shumë se çdo kush tjetër në faqe të tokës.” (Numrat 12:3)

Dikush mund të mendojë se nëse Moisiu e shkroi këtë për veten e tij, atëherë kjo nuk është një shenjë përlulësie, të lavdëroresh për përluljen tënde! Por në fakt duhet goxha përlulësi për të pranuar se je i përlulur.

Përlulësia është rrallë herë e admirueshme dhe e besueshme tek liderët. Në zgjedhje presidenciale, kandidatët nuk shesin mënd tek të qenurit të urtë dhe të përlulur, si faktorë që do favorizojnë përzgjedhjen e tyre.

Ashtu si kishte parashikuar profeti Isaia, se kur Jezusi të vinte tu fliste për Atin, shumë njerëz do ta përbuznin dhe kundërshtonin për mirësinë e Tij. (Isaia 53:3, 7) Shekuj më parë, Zoti i kish thënë të urtit Moisi se një ditë Ai do të ngrinte midis njerëzve të Izraelit një profet të veçantë, “një profet si ti.” (Ligji i Përtërirë 18:15-18) Jezusi pranoi se kjo i referohej Atij vetë. (Luka 24:27, 44; Veprat 3:17-26)

Dhe Moisiu duhet të ketë vëzhguar me admirim dhe me adhurim Birin e Perëndisë të fliste me të gjithë njerëzit dhe veçanërisht me armiqtë e Tij me aq hir dhe përlulje.

Para se Jezusi të kryqëzohej, Moisiu shkoi ti fliste në malin e Transfigurimit. Bashkë me ta ishte dhe profeti Elia, dhe të tre folën “ballë për ballë”, ashtu siç flasin miqtë me njëri-tjetrin. Luka thotë se ata folën për refuzimin dhe ekzekutimin e egër që pësoi Jezusi. (Luka 9:28-36; Mateu 17:1-8, Mark 9:2-8)

Megjithëse shumë e përbuzën Jezusin për përlulësinë e Tij, a mendoni se Moisiut i vinte turp tek qëndronte përkrah me Mjeshttrin e tij? Çfarë nderi të identifikohesh me Jezusin e mëshirshëm, të urtë dhe zemërbutë! Moisiu nuk ndihej i turpëruar kur përshkruante veten e tij tek libri i Numrave si të urtë dhe të përlulur, “më tepër se çdo njeri tjetër mbi tokë.” Të jesh një njeri i tillë është të jesh si Zoti.

Me sa duket, cilësi të tilla të Moisiut nuk gëzonin respektin e të vëllait dhe të motrës së tij. Zoti urdhëroi që të tre ata të vinin para Tij.

“Dhe Zoti tha, dëgjoni tani fjalët e Mia! Nëse ka një profet midis jush, Unë, Zoti i bëhem i njohur atij në vegim, flas me të në ëndërr. Por nuk veproj kështu me shërbëtorin tim Moisi, që është besnik në tërë shtëpinë Time. Me të Unë flas sy për sy, duke bërë që ai të më shohë, dhe jo shprehje të errëta; dhe ai sodit dukjen e Zotit. Pse nuk keni pasur frikë të flisni kundër shërbëtorit tim Moisiut?” (Numrat 12:6-8)

Siç e shihni Zoti ende vazhdon ta konsiderojë mikun e Tij Moisi si shërbëtorin e Tij. Në një pasazh të mëparshëm Zoti është përshkruar tek fliste me Moisiun “ballë për ballë, ashtu si një njeri flet me mikun e tij.” (Eksodi 33:11)

Por miqësia me Zotin nuk është fundi i shërbesës. *Vetë Jezusi tregoi se ishte një mik shërbyes.*

Një bisedë e hapur rreth Atit

Shpejt pasi Jezusi bëri ftesën për miqësi të cituar tek Gjoni 15:15, Ai u deklaroi dishepujve se së shpejti Ai do tu fliste atyre më hapur mbi Atin. Ai shpjegoi se deri më tani Ai u kishte folur atyre përmes simboleve,

metaforave, krahasimeve—në “shprehje të errëta” gjë të cilën nuk kishte nevojë ta bënte me mikun e Tij Moisi.

“Po vjen ora kur nuk do t’ju flas më me shëmbëlltyra, por do t’ju flas haptas për Atin.” (Gjoni 16:25)

Sa shpejt do të vinte kjo orë? Dishepujt dukeshin se mendonin – menjëherë. Pasi Jezusi kish bërë një deklaram të shkurtër por shumë domethënës mbi Atin, dishepujt iu përgjigjën, **“Po, tani ti po flet haptas, dhe s’po përdor shëmbëlltyrë!” (Gjoni 16:29)**

Krahasoni fjalët e Mësuesit vetëm një çast më vonë, kur Ai po tregonte mënyrën se si dishepujt do ta braktisnin Atë: **“Ja po vjen ora, madje tashmë ka ardhur...” (Gjoni 16:32)**

Jezusi e ka bërë këtë pohim të qartë në gjuhën Aramaike. Gjoni e ka përkthyer atë në gjuhën Greke. Ne mund ta lexojmë të përkthyer nga përkthimi i Gjoni. Por nuk duhet të shqetësohemi nëse nga përkthimi në përkthim diçka nga origjinali mund të ketë ndryshuar. Shumica e versioneve të këtij pasazhi janë të njejtë.

“Jua kam thënë këtë gjëra në shëmbëlltyra, por po vjen ora kur nuk do t’ju flas më me shëmbëlltyra por do t’ju flas haptas për Atin. Në atë ditë ju do të kërkonin në emrin Tim; dhe nuk po them se Unë do t’i lutem Atit për ju. Ati vetë në fakt ju do, sepse ju më dëshët Mua dhe keni besuar se Unë dola nga Perëndia. Unë dola nga Ati dhe erdha në botë; përsëri po e lë botën dhe kthehem tek Ati.” (Gjoni 16:25-28)

Ne versionin e Noksit vargu 27 është: **“Sepse vetë Ati është miku juaj, qëkurse ju jeni bërë miq të mi . . .”** Imzot Noks (Knox) e përktheu këtë nga përkthimi Latin i përkthimit Grek të Gjoni. Por si në gjuhën Latine ashtu dhe në atë Greke, fjalët për “dashuri” dhe “miqësi” vijnë nga e njëjta rrënjë fjale.

Në ato çfarë tha Jezusi për Atin, a ju duket se ka ndonjë gjë të thënë më hapur dhe në mënyrë më pak të figurshme se më parë? Unë mund të gjej vetëm fjalët e thjeshta, që nuk janë të vështira për tu përkthyer.

“Nuk po them se Unë do t’i lutem Atit për ju” (Gjoni 16:26) Goodspeed e perktheu kete pasazh kështu, **“Unë nuk premtoj të ndërmjetësoj me Atin për ju, sepse vetë Ati ju do juve.”**

Si miq të këtij Zoti të dashur, dishepujt u inkurajuan ti drejtoheshin direkt Atit. Nuk ishte më e nevojshme që këtë ta bënte Jezusi. Ata sidoqoftë, duhet të kërkonin në emrin e Jezusit.

Kjo s’do të thotë se nëse Ati nuk dëgjon emrin e Birit të Tij atëherë Ai ka më pak dëshirë të përgjigjet. Përmendja e emrit të Jezusit shpreh mirënjohje të thellë që nëse Biri i Perëndisë nuk ka treguar të vërtetën mbi Atin e Tij, ne atëherë nuk do të dinim si ti afroheshim Atij. Ndoshta ne as nuk do të donim ta bënim këtë.

Në këtë kuptim, ne kemi me të vërtetë nevojë për dikë që të “ndërmjetësojë” ose të “ndërhyjë.”

Sa herë ne lutemi në emër të Jezus Krishtit, ne falenderojmë Zotin për Krishtin, Ndërmjetësuesin tonë, Ai që erdhi për tu bërë urë në hapësirën midis nesh dhe Zotit dhe për të na sjellë të vërtetën mbi dashurinë e Atit Qiellor. Përmes Jezusit, ne dimë se mund të flasim me Atin Qiellor “ashtu siç flasim me miqtë.” Nuk kemi nevojë për një mik tjetër ndërmjetësues, sepse vetë Zoti është Miku Ynë.

Në të gjithë këtë, Jezusi duhet të jetë treguar i qartë rreth Atit të Tij, por pse Ai zgjodhi pikërisht këtë informacion të veçantë, dhe pse pikërisht në momentin para kryqëzimit të Tij? A ishte kjo diçka që dishepujt duhet të kujtonin ndërsa dëshmonin për çfarë ndodhi në orët që pasuan? A ishte kjo diçka që Ai dëshironte që dishepujt ta mësonin shumë qartë, në të kundërt ata do të keqkuptonin sakrifikimin në kryq?

Misteri për zhdukjen e pjesëzës ‘Nuk’

Për çudi, jo të gjithë janë të kënaqur kur mësojnë për pohimin mbi Atin tek Gjoni 16. Në fakt, unë vet kam dëgjuar një pastor ta quante këtë “një herezi të mallkuar.” Ai tha: “Nëse Jezusi nuk është Ndërmjetësues mes nesh dhe Atit,” vazhdoi ai, “atëherë ne nuk kemi shpresën e shpëtimit.”

Jam i sigurt se ky pastor vet nuk kuptonte se po mallkonte vetë fjalët e Jezusit. Ai thjesht, si shumë të tjerë, është mësuar ta lexojë Gjoni 16:26 pa vënë re pjesëzën shumë të rëndësishme “nuk”.

Jezusi tha, **“nuk po them se Unë do t’i lutem Atit për ju,”** por për shumë lexues, pjesëza “nuk” është zhdukur. Në shumë biseda publike, dhe në disa raste edhe në publikime, unë e kam parë këtë varg të cituar —pa “nuk”—si një prëmtim që në fakt Jezusi do të jetë Ndërmjetësuesi ynë me Zotin.

Shumë njerëz janë çuditur kur iu është treguar pjesëza munguese. Unë vetë kam dëgjuar predikues, të thonë se nëse “nuk” është vërtet pjesë, atëherë ata s’do të dinin si ta interpretonin këtë varg.

Disa kanë zgjedhur thjesht ta injorojnë këtë pjesë. Një mësues dha këtë shpjegim: “Meqënëse ne të gjithë e dimë se Jezusi është Ndërmjetësuesi ynë me Atin, Gjoni 16:26 është një paradoks i vështirë.”

Por Jezusi nuk tha se kjo do ishte e vështirë. Ai tha se ishte e qartë dhe e kuptueshme!

Një mundësi për të bërë pyetje

Dishepujt e humbën dhe një herë tjetër mundësinë të silleshin si miq, dhe të bënin pyetje ashtu siç bëjnë miqtë. Ata mund ta kishin pyetur Jezusin mbi vërtetësinë e asaj që Ai sapo u tha.

“A je duke thënë se nuk është nevoja që Ti ti lutesh Atit për ne? Atëherë pse u mësua Moisiu të ndërtonte një sistem priftëror në Sinai?”



“A nuk ishte detyra e një prifti të ndërmjetësonte me Zotin në favor të mëkatarëve?” (Levitiku 16)

“A nuk ndërmjetësoi Moisiu me Zotin që Ai të mos derdhte mërinë e Tij mbi njerëzit mosbindës?”

“A nuk pohon vetë Moisiu se ia doli mbanë të bindte Perëndinë të ndërronte mendje?”

Dishepujt mund ti kenë tërhequr vëmendjen Jezusit, drejt fjalës së Shkrimit të Shenjtë: **“Atëherë Moisiu e luti Zotin Perëndinë e tij, dhe i tha. . . ‘Hiq dorë nga zemërimi Yt i zjarrtë dhe nga qëllimi Yt për t’i bërë keq popullit Tënd;’. . . Kështu Zoti ndryshoi mendim lidhur me të keqen që kishte thënë se do t’i bënte popullit të Tij.”** (Eksodi 32:11-14)

“A je duke na thënë, Zot, se dhe Moisiu vetë u keqkuptua?” Në kohët tona, duke patur avantazhin e mundësisë për të lexuar librin e Hebrenjve, ne mund të ngremë një çështje tjetër: “Jezus, nëse puna e drejtë e priftërinjve përfaqëson punën që ti erdhe të bëje – dhe ke vazhduar të bësh edhe kur u ktheve tek Ati —pse atëherë thua se nuk ka nevojë që Ti të jesh Ndërmjetësuesi midis nesh dhe Atit në favorin tonë? Dhe në kundërshtim me këtë deklaratë të qartë, pse atëherë miqt e Tu të mirë si Pali dhe Gjoni do të vazhdonin të të përshkruanin në Dhjatën e Re si Avokatin që lutet për ne në Gjyqin e Qiellor? (1 Gjoni 2:1; Romakët 8:34) A në

të vërtetë e keqkuptuan ata? Mos Gjoni e ngatërroi që Ti do ti kërkosh Atit të bënte diçka për dishepujt, pikërisht pasi Ti Vetë kishe pohuar se Ti s’do ta bëje këtë?” (Gjoni 17:6-26)

Unë do ta doja që Gjoni ti ketë kërkuar Jezusit që ta ndihmonte të kuptonte pohimin e Tij mbi Atin. Atëherë Gjoni do të kish marrë përgjigjen e çmuar; dhe ne do të kishim mundësinë ta lexonim sot. Sidoqoftë, nga Shkrimi i Shenjtë, ne mund të krijojmë një ide për shpjegimin që mund të ketë dhënë Zoti.

“Unë nuk kam ardhur që të kundërshtoj Moisiun”

Jezusi mund të ketë filluar duke përsëritur atë çfarë Ai u tha kritikëve që e akuzuan se ishte kontradiktor me mësimet e Shkrimit të Shenjtë. **“Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose profetët; Unë nuk erdha për t’i shfuqizuar po për t’i plotësuar.”** (Mateu 5:17)

Atëherë, ashtu sikurse e kish zakon kur përgjigjej për pyetje të tilla, Jezusi mund të ketë treguar historinë që flet se si njerëzit e Zotit kishin nevojë për dikë që të qëndrojnë mes tyre dhe Atit Qiellor. Ai mund t’ia ketë kujtuar dishepujve të Tij se si Zoti zbriti në Sinai për ti folur njerëzve të Tij, mbi masat që Ai do merrte për të fituar vëmendjen e tyre, dhe se si njerëzit të frikësuar iu luten Moisiut që të mos e lejonte më Zotin tu fliste atyre, përndryshe ky do të ishte fundi për ta.

“Fol ti me ne dhe ne do të të dëgjojmë, por të mos na flasë Perëndia që të mos vdesim.” (Eksodi 20:18,19)

“E shihni,” mund të ketë vazhduar Jezusi, “ishin njerëzit ata që zgjodhën që dikush të ishte midis tyre dhe Zotit; dikush që ishte miku i Zotit, i cili mund të qëndronte si ndërmjetës midis tyre dhe Zotit nga i cili ata kishin aq

shumë frikë. Por ju dishepujt e mi e dini se isha Unë Ai që ishte në Sinai. A është dikush nga ju i frikësuar nga Unë? Unë ju kërkova juve të ishit miqtë e Mi. Ju e dini se mund të uleni e te flisni pa frikë me mua hapur, kështu.”

Nuk doja asnjë midis nesh

Më vonë Jezusi mund të ketë vazhduar i mërziutur: “Unë do të kisha dashur të kisha folur kështu me njerëzit e Mi atje në shkretëtirë. Unë do të kisha dashur që askush të mos hynte mes nesh, sikur Unë të mos i doja bijtë e Mij. Por ata nuk Më njihnin kështu si ju. Në fillim ata u treguan mosnderues. Pastaj ata ishin të frikësuar. Unë nuk mund ti urdhëroja të mos kishin frikë. Ashtu sikurse ju, dishepujt e Mi, mund të kuptoni, besimi dhe miqësia nuk mund të urdhërohet. Kështu që ramë dakort që derisa ata të Më njihnin më mirë Moisiu të bëhej ndërmjetësi Im. Ata nuk i druhashin atij, dhe ai nuk Më dritej Mua.

“Sigurisht, nuk ishte asnjëri tjetër përveç Meje dhe Moisiut. Ai më njohu me të vërtetë dhe u bë mik i Im. Nuk kishte njeri tjetër përveç Meje dhe mikut Tim të vjetër Abraham kur Unë fola me çiltërsi rreth planeve të Mia për njerëzit e Sodomës. Dhe nuk ishte askush tjetër përveç meje dhe Jobit kur ai u ndje i lirë të më shprehte mendimet dhe ndjenjat e tij. Këshilltarët e tij kishin menduar se Unë do të inatosesha, po në fakt Unë u ndjeva i nderuar që ai më besoi.”

“Dhe tani,” mund të ketë përfunduar Jezusi, “Unë kam ardhur për të qenë midis —sikurse i thashë dhe Moisiut se do të isha. Shumë do ta keqkuptojnë qëllimin e ardhjes sime. Shumë mund ta falenderojnë Atin për ardhjen Time, atë të mëshirshmin, që do të jetë ndërmjetës për ta dhe Atin Qiellor të fyer—sikur Unë të isha më i dashur se Ai. Por ju e dini në të vërtetë se kush jam Unë. E keni kuptuar se Isaia kish të drejtë kur tha se Princi i Paqes është vet Zoti. (Isaia 9:6)

“Tani më thoni të vërtetën, dishepujt e Mi. A keni nëvojë që t’ju mbrojë dikush nga Unë? Atëherë ju nuk keni nëvojë për askënd që t’ju mbrojë juve nga Ati. Kur ju po silleshit aq keq në darkë, a ishte dikush tjetër mes jush dhe Zotit ndërsa Unë po ju laja këmbët? Dhe Unë dua që të kujtoni në të ardhmen, se kur Unë po i laja këmbët Judës, nuk ishte askush tjetër përveç atij dhe Zotit e tij. Unë jam përpjekur t’ju shpjegoj sa më qartë dhe mirë që mundem se Ati ju do po aq sa edhe Unë. Ai është po aq miqësor dhe i mëshirshëm sa shpresoj që keni zbuluar së jam Unë. Ai do të kishte po aq dëshirë të gjunjëzohej dhe të lante këmbët tuaja të ndotura.

“Por tani Unë do të shkoj të kryqëzohem. Unë dua që ju të jeni me mua në Kalvar. Unë dua të më shihni ndërsa vdes. Ndoshta kjo do t’ju ndihmojë të kuptoni më qartë atë që Unë jam përpjekur t’ju tregoj rreth Atit.”

Fatkeqsisht nga dymbëdhjetë dishepujt, vetëm Gjoni ishte atje. Por ai shkroi për ato që pa dhe dëgjoi.

Kush na do më shumë – Jezusi apo Ati?

Shumë vite me parë, kur vajza ime ishte 6 vjeçe në adhurimin tonë familjar unë lexova një histori për fëmijë nga një reviste e Krishterë. Unë po lexoja me emocion se si Jezusi qëndronte para Atit të Tij dhe i kërkonte që ti falte,—veçanërisht fëmijët e vegjël që nuk ishin sjellë mirë!

“Babi,” më ndërpreu Alisa, me një pamje të shqetësuar, “a mos do të thotë kjo se Zoti nuk na do po aq sa edhe Jezusi?” Ajo e kishte të qartë se ai që kërkonte që ti falte ishte më i dashur se ai që duhej ti lutej.

Unë i tregova asaj atë çfarë Jezusi u mundua t’ia bënte të qartë dhe të dukshme dishepujve të Tij në sallën e sipërme. Tani Alisa i shpjegon fëmijevë të saj se Zoti i do ata po aq sa edhe Jezusi.

N

7. MIQËSIA DHE LIGJI

ëse do t’i bënit vetëm një pyetje Zotit – çfarë do të ishte ajo?

“Unë do ti kërkoja Atij të më bënte të pasur!” qeshte një adoleshente Angleze. “Si ta gjëjmë mjekimin për kancerin,” “Si ti bëjmë të gjithë njerëzit të kenë jetë të mirë,” ishte zgjedhja e dy miqve të saj.

“A keni ndonjë pyetje për ti bërë Zotit?” pyeta kasapin e lagjes.

“Po. Unë desha të pyesja, nëse Ai është kaq i plotfuqishëm, pse Ai nuk iu ushqen të uriturit e Etiopisë. Por faktikisht unë jam tepër i zhgënjyer me Perëndi, prandaj unë nuk besoj më në Atë.”

Unë e pyeta të njëjtën pyetje një fshatari i cili ishte akoma një besimtar i fort.

“Unë do ti kërkoja Zotit të më thotë më qartë se çfarë Ai do që unë të bëj dhe se si duhet ta bëj.”

Një profesori i Universitetit të Kembrixhit tha: “Unë do doja ta dëgjoja shpjegimin e qartë se pse Ai ka zgjedhur në mënyrë të tillë. A s’kishte një rrugë tjetër? Dhe nëse po, pse?”

Pyetjet e dishepujve shpesh reflektoni egoizëm, si p.sh. – kush prej tyre që më i madhi. (Mateu 18:1; Marku 9:34; Luka 9:46-48) Ata ishin duke u grindur rreth kësaj gjatë darkës së fundit me Jezusin përpara se Ai të kryqëzoheshe! (Luka 22:24)

Më përpara dy nga dishepujt të cilët ishin vëllezër, kërkonin të uleshin pranë Birit të Perëndisë (vendet më të nderuara) në Mbretërinë Qiellore. Madje ata sollën edhe nënën e tyre për të manipuluar Jezusin dhe të mernin përgjigjen që ata dëshironin. (Marku 10:35-45; Mateu 20:20-28) Kërkese nuk iu plotësua, por dishepujt të tjera u inatosën me të dy vëllezërit. Jo se ata nuk do i dëshironin këto vende të nderuara!


Çfarë do të kishe kërkuar ti?

Nëse ti do të ishe me Jezusin dhe dishepujt e Tij atë natë në sallën e sipërme dhe do kishe shansin të bëj një pyetje Zotit – çfarë do të ishte ajo?

Çfarë pyetje do të kishte bërë Apostulli Pal, nëse ai do të ishte atje? Pas disa vitesh në letrën e tij për besimtarët e kishës së Galatasve, ai bëri një pyetje e cila do të ishte e përshtatshme edhe për dishepujt për ta pyetur Jezusin atë natë në sallën e sipërme. Pyetja e Palit ishte: “Pse u dha ligji?” (Galatasve 3:19)

Shumë prej nesh janë bashkuar me Palin duke menduar për këtë pyetje. Ne na pëlqen shumë se çfarë tha Jezusi për lirinë, miqësinë, dashurinë dhe besimin. Ne gjithashtu e dimë nga përvoja që asnjë prej këtyre gjërave nuk mund të urdhërohen. Pse atëhere Zoti dha kaq shumë ligje? Pse do ti urdhëronte Ai fëmijët e Tij ta donin Atë dhe njëri-tjetrin – nën kërcënimin e pasojave të tmerrshme nëse ata nuk binden? A nuk do të prodhonte kjo mënyrë shërbëtorë frikacak, mermërues dhe rebel më shumë se sa miq të kuptueshëm dhe besnik? Pse Zoti do të zgjidhte të rezikonte?

Disa prej nesh gjithashtu pëlqejnë atë që Jezusi tha për të folur haptas dhe qartë. Ka aq shumë “shprehje të errëta” kur njerëzit flasin rreth Zotit dhe shpëtimit. Por nëse Zoti preferon thjeshtësi dhe kuptimin, pse atëhere Ai i tha Moisiut të bënte një sistem kaq të komplikuar ceremonial dhe sakrificash me të gjitha simbolet e çuditshme? A nuk do të rriste largësinë ndërmjet Atit dhe fëmijëve të Tij e gjithë ky sistem misterioz dhe a nuk do të bënte të vështirë për fëmijët të Tij të mendonin dhe flisnin qartë rreth Tij? Pse Zoti donte të rrezikonte?



Në letrën e tij drejtuar Galatasve Pali i përgjigjet pyetjes së tij: “**Pse u dha ligji? Ai u shtua për shkak të shkeljeve.**” (Galatasve 3:19) *Good News Bible* thotë: “**Ligji u shtua në mënyrë për të treguar se çfarë janë gabimet.**” Dhe *Revised English Bible* shpjegon që “**ligji u shtua për të bërë shkeljen një ofens legale.**”

Një gjë duket e qartë. Nëse njerëzit e Perëndisë nuk do të kishin bërë shkelje, nuk do të kishte nevojë të shtoheshe ligji. Si iu shpjegua pastorit të ri Timoteu: “**Ligji nuk është vënë për të drejtin po për të pabesët dhe të rebelët, për të ligët dhe mëkatarët, për të pamëshirshmit dhe të ndyrët, për ata që vrasin babë e nënë, për vrasësit, për kurvarët, për homoseksualët, për grabitësit, për rremët, për ata që shkeln betimin për çdo gjë tjetër që bie në kundërshtim me doktrinën e shëndoshë.** (1 Timothy 1:9,10)

Përkthimi i Phillips-it: “**Ligji nuk është vënë për njerëzit e mirë, por për ata që nuk kanë parime dhe as vetkontroll.**” Perëndia e shtoi ligji sepse Ai e dinte që ne kemi nevojë për atë.

Si mund të gjejmë kuptimin e vërtetë?

Edhe pse Pali u bë miku i Zotit, ai akoma i përdorte “shprehjet të errëta” në shpjegime teologjike. Pasi përdori oratorin e tij në Athinë, (Veprat 17:22-31) Pali informoi besimtarët në Korint që tani e tutje do të fliste qartë dhe thjeshtë për Zotin. (1 Korintasve 2:1-5)

Edhe apostulli Pjetër vëzhgoi – me shumë respekt – që letrat e Palit përmbanin “disa gjëra të vështira të cilat të paditurit dhe të paqëndrueshmit i shtrëmbërojnë.” (2 Pjetër 3:16)

Për këtë arsye kur lexojmë shkrimet e Palit është shumë e rëndësishme që ta lexojmë të gjithë pasazhi, madje nganjëherë të gjithë letrën në mënyrë që t’i japim shansin Palit të shpjegoj qëllimin e tij.

Theksimi i vazhdueshëm i Palit është për të vërtetën rreth Zotit e cila është baza për paqen, lirinë, dashurinë dhe besimin besimin si i Abrahamit, mikut të Zotit. Pali e dinte shumë mirë që këto gjëra kaq të çmuara nuk janë rezultat nga përdorimi i forcës apo pushtetit ashtu si Zoti i tha profetit Zakaria. Ashtu as nuk mund të detyrohen nga ligji. Ato mund të krijohen vetëm si përgjigje ndaj zërit të së vërtetës të Zotit i cili na flet butësisht por me këmbëngulje në zemrat tona. Në të njëjtën letrë drejtuar Galatasve Pali shpjegon që gjërat si “dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutesia, vetëkontrolli” të gjitha janë “fryti i Frymës.” (Galatasve 5:22)

Fryma e së Vërtetës me durim vazhdon punën e Tij të ndriçimit dhe bindjes dhe Zoti përdor shumë mënyra për të kontrolluar dhe mbrojtur fëmijët e Tij gjersa ata kanë mundësinë të mësojnë të vërtetën. Zoti përdor ligjin në mënyrë të veçantë.

“Shoqëruesi” jonë në rrugën drejt Krishtit

Ligji, vazhdon Pali të shpjegoj në *Galatasve 3*, na ka shërbyer si “kujdestar”, “rojtari”, ose “mësues.” Ligji ishte “përgjegjës për ne” “dëri sa Krishti të vij”, ose “të na drejtoj tek Krishti.”

Në *American New Testament* ne lexojmë: **“Kështu Ligji që shoqëruesi ynë për te Krishti . . . Por mbasi besimi erdhi, ne nuk jemi më nën ndonjë shoqërues.” (Galatasve 3:24,25)**

Në përkthimin shqip ne lexojmë **“ligji që mësuesi ynë për te Krishti.”**

“Mësuesi” mund të jetë një përkthim që keqkuptohet lehtësisht, sepse kjo fjalë varet nga përjetime tona personale në shkollë.

Nëse Pali kishte ndërmend që roli i ligjit të ishte si mësuesi ynë, ai do të kishte përdorur fjalën *didaskalos*, nga e cila vjen fjalë “didaktik.” Por, termi që Pali përdori është *paidagogos*. Kjo shpjegon pse kjo fjalë lehtësisht është përkthyer “mësues” se nga kjo fjalë e kemi termin - “pedagog”.

Në Greqisht termi *paidagogos* fjalë për fjalë përkthehet “udheheqës djemsh,” kuptoheshe si shoqërues, zakonisht një skllav, i cili kishte përgjigjësi për fëmijët. Një nga detyrat e tij ishte të shoqëronte djemtë për në shkollë për t’i mbrojtur ato nga rreziku dhe kujdesëshin që të mos bënë prapësira. Ai nuk ishte mësues. Mësuesi ishte në shkollë. Kur fëmijët u rritën dhe u bënë më të përgjegjshëm shoqërues nuk kishte më pse të kujdesesh për ta — sepse nuk kishte më asnjë nevojë për atë.

Pali shpjegon që Zoti e shtoi ligjin për të kryer shërbim të njëjtë si “udheheqësi fëmijësh”. Por cili ligj? Apostulli Pal kishte në mend? Zoti ka dhënë shumë ligje. Cili ligj duhet të ishte shoqëruesi jonë për te Krishti?? Moral? Ceremonial? Ndonjë tjetër? Pali nuk na e thotë.

Por për një gjë ne jemi të sigurtë – Zoti i cili i dha të gjitha ligjet na ka ofruar edhe miqësinë siç shkruhet tek *Gjoni 15:15*.

Ka njerëz që thojnë që nuk ka seç na duhet ne se çfarë Zoti bën me ligjin. Kështu flet shërbëtori. Kurse Zoti Vet na ka ftuar të kuptojmë – kjo është diçka që vetëm miqtë do ta bëjnë.

Dështimi i të kuptuarit të ligjit të Zotit mund të na udhëheqi në një bindje të pamenduar dhe pa zemër, siç ka shkruar Isaia.

“... Ky popull më afrohet Mua vetëm me gojën dhe më nderon me buzët e tij, ndërsa zemra e tij më rri larg dhe frika e tij ndaj Meje është vetëm një urdhërim i mësuar nga njerëzit.” (Isaia 29:13)

Krahësoni përkthimin e Good News Bible:

“Ky popull shpall se më adhuron Mua, por fjalët e tyre janë të pakuptimta dhe zemra e tyre është diku tjetër. Feja e tyre është bazuar vetëm në rregullat dhe traditat njerëzore, të cilat ata i kanë mësuar përmendësh.”

Në Bibël zemra shpesh herë nënkuptohet njëri i brendshëm – vëndi ku personi mendon dhe burimi i emocioneve dhe qendrimeve. P.sh., në Ungjili sipas Markut përmendet që disa skribë “arsyetonin në zemrën e tyre.” (Marku 2:6)

Profeti Jeremia me zi priste atë ditë kur Zoti do të plotësonte premtimin e tij: **“Do ta shtije ligjin Tim në mëndjen e tyre dhe do ta shkruaj mbi zemrën e tyre.” (Jeremia 31:33)**

Kur ligji i dhjetë urdhërimeve iu dha Moisiut që t’ia jepte popullit, Zoti i shkruajti ato në gur. Nëse Zoti donte bindje të verbër dhe të pamenduar nga njerëzit e Tij, Ai nuk do të premtonte të shkruante ligjin e Tij në zemrat e njerëzve të Tij – vëndi që është qendra e arsytimit dhe inteligjencës. Ai mund ta linte ligjin të shkruar në pllakat e gurit dhe të kërkonte mbajtjen e tyre.

Apostulli Pal ishte një përsôn jashtzakonisht inteligjent. Ai ishte i zellshëm për të kuptuar dhe shpjeguar kuptimin e të gjithave ligjeve të Zotit. Si një mik i një Zoti miqësor ai e dinte që ishte i lirë për të bërë pyetje: **“Pse u dha ligji?”**

Sa më shumë Pali studionte dhjetë urdhërimet, aq më shumë ai i admironte ato dhe pranonte që ato janë të dobishme. Ai i shkruajti besimtareve në Romë: **“Unë gjej kenaqësi në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm.” (Romans 7:22)** Ligji i shkruajtur në gur ishte shkruar në zemrën e tij.

Qëllimi kryesor i ligjit ceremonial

Po të gjitha ligjet e ofertave dhe sakrificave – “shprehje të errëta” e ritualeve dhe ceremonialeve? A janë ato të përfshirë në shpjegimin e Palit për ligjin i cili është “shoqëruesi jonë për te Krishti” dhe imazh i qartë mbi të së vërtetës rreth Zotit?

Shpesh herë profetët e Dhjatës së Vjetër shpjegojnë që nëse njerëzit duke bërë rituale nuk arrijnë të njohin Zotin dhe të trajtonin njëri-tjetrin më mirë, ato janë të pa kuptim. Profetët nuk shpallnin se duhet të ndaloheshin këto rituale – ishte Zoti që i kishte urdhëruar ato – vetëm theksi ishte që asgjë nuk është më e rëndësishme se të njeh Zotin.

Profeti Osea, i shkruajti këtë mesazh njerëzve për Zotin: ***Unë dëshiroj mëshirë dhe jo flijimet, dhe njohjen e Perëndisë më shumë se olokaustet. (Osea 6:6)***

“Unë do të preferoj që njerëzit e Mi të më njohin Mua se sa të më ofronin flijime,” lëxojmë në Good News Bible.

Jeremia profetizoi që kur ligji i Zotit do të jetë shkruar në zemrat e njerëzve, “ata nuk do të mësojnë secili të afërmin e tij dhe secili vëllanë e tij duke thënë: "Njihni Zotin!" sepse të gjithë do të më njohin.” (Jeremia 31:34)

Në Bibël fjalët në Hebraishte dhe greqishte që përkthehen “të njoh” mund të ketë kuptim më shumë se një njohje përciptasi ose intelektuale. Duke u varur nga konteksti, fjalë "të njohësh" dikë mund të nënkuptojnë një qëndrim vlersimi dhe aprovimi, një marrëdhënie me dikë që ka një vlerë të veçantë. Pali i tha Korintasve që “në qoftë se dikush e do Perëndinë, ai është i njohur prej Tij.” (1 Korintasve 8:3)

Zoti e njohte Abrahamin, dhe Abrahami e njohte Zotin. Ja pse ata mund të ishin miq të mirë. Kur Zoti thotë që Ai dëshiron që të njihet nga ne, Ai në fakt po na fton neve të bëhemi miqtë e Tij.

Ligjet e Zotit nuk janë kërcënim për miqësinë

A do të ishte e mundur të ishe miqësor me një perëndi i cili vendos ligje arbitrare thjesht për të shfaqur autoritetin e tij dhe për të testuar gatishmërinë dhe bindjen tonë? A do të dëshiroje ta njihje atë? A do të dëshiroje të jetoje me një perëndi të tillë përjetësisht?

Disa besimtar të përkushtuar besojnë se është e rëndësishme për Zotin të vendos të paktën disa rregulla arbitrare. Ata shpjegojnë - Si ndryshe ai mund ta di që ne i bindemi atij apo jo? Ndoshta ne vetëm bëjmë gjëra që na duken të drejta.

Nëse është e vërtetë se disa ligje nuk kanë kuptim, atëherë më kotë përpiqemi ti kuptojmë atë. Në thjesht duhet të ulim kokat tona dhe si shërbëtor të pamëndjë të bëjmë atë çfarë na është thënë.

Po, jam i gatshëm të ul kokën time. Por do të bëj këtë sepse jam i mahnitur që Krijuesi jonë, i cili ka të drejtën të jetë arbitrar, në vënd të kësaj ka zgjedhur të kundërtën.

Kur një parashutist hidhet nga aeroplani në lartësi 1,5 km, ai nuk është i detyruar të hapi parashutën e tij. Nuk ka njeri pranë që ta detyroj ta bëjë këtë gjë. Ai mund ti thotë vetes: "Më ka ardhur në majë të hundës ti bindem

urdhërave!" Këtu është mundësia e tij për të treguar pavarsinë ndaj rregullave. Por nëse ai dëshiron të jetoj dhe të fluturoj përsëri një ditë tjetër, është e logjikshme ta hapi parashutën.

Le të mendojmë për Dhjetë Urdhërimet. Disa njerëz thojnë që këto rregulla janë arbitrare dhe privojnë lirinë tonë. Por nëse ne i mbajmë këto urdhërime, ashtu siç i mbajti Jezusi, në cilën aspekt ne do të jemi më pak të lirë? Jakobi i quan Dhjetë Urdhërimet **"ligji i lirisë."** (Jakobi 2:8-12)

Jezusi dhe Pali ranë dakort me Moisiun që të mbash Dhjetë Urdhërimet do të thotë të duash Zotin me gjithë zemrën tënde dhe të duash të afërmin tënd si vetveten. Pali konkludon kështu: "Ai që e do tjetrin e tij e ka përmbushur ligjin. Sepse urdhërimet: **'Mos shkel kurorë, mos vraj, mos vidh, mos thua dëshmi të rreme, mos lakmo,'** dhe në pastë ndonjë urdhërim tjetër, përmbledhin në këtë fjalë: **'Duaje të afërmin tënd porsivetveten.'** dashuria nuk i bën keq të afërmit; dashuria, pra, është përmbushja e ligjit." (Romakëve 13:8-10; shiko edhe Mateu 22:36-40; Ligji i Përtërirë 6:5; Levitiku 19:18)



Për tu siguruar që ne e kuptojmë se çfarë do të thotë të duash, Pali shpjegon kuptimin e dashurisë në letrën e tij drejtuar Korintasve. **"Dashuria është e durueshme; plot mirësi; dashuria nuk ka smirë, nuk vë në dukje, nuk kreket, nuk sillet në mënyrë rëpahijshe, nuk kërkon të sajat, nuk pezmatohet, nuk dyshon për keq; nuk gëzohet për padrejtësinë, por gëzohet me të vërtetën."** (1 Korintasve 13:4-6)

Imagjinoni të jetoni në një shoqëri ku të gjithë sillen kështu. Çdo njeri mund ti besohet, asnjëri nuk mashtron tjetrin dhe gratë dhe fëmijët mund të ecin në çfarëdo lloji orë në rrugë pa rrezik.

Por le të shqyrtojmë urdhërimin e dhjetë. Fjalët "mos lakmo" faktikisht ndalon çdo lloj dëshire të keqe. Tani imagjinononi të jetoni në një shoqëri ku njerëzit jo vetëm që nuk bëjnë ndonjë gjë të keqe, por madje as nuk duan ta bëjnë këtë! Askush nuk ka pse të urdhëroj njerëzit që të mos gënjejnë, vjedhin, vrasin, të paduruan dhe egoist. Dhjetë Urdhërimet nuk mund ti gjeshe në asnjë mur. Të gjithë janë të bindur që ja vlen ti mbash këto urdhërime në jetën tonë.

Shërbëtor i bindur apo një mik i bindur?

Nëse ju jeni besimtar dhe doni të bëni vullnetin e Zotit, çfarë ju bën ju ti bindeni Atij?

A do të thonit: "Unë bëj atë që bëj sepse Zoti më ka thënë ta bëj dhe Ai ka pushtetin të më shpërblej apo të më shkatërroj"? A është kjo arsye përse ju nuk vrisni apo vidhni – sepse Zoti ju ka thënë të mos e bëni? Apo thoni që ju do ta bënit por nuk keni asnjë dëshirë të inatosni Zotit?

Kështu flet një shërbëtor i frikësuar. Mund të jetë e kuptueshme edhe për fëmijët dhe besimtarët fillestar. Por kjo e folur sugjeron që ligjet e Zotit janë arbitrare dhe jo të llogjikshme. Kjo llojë bindje nuk i jep një nam të mirë Zotit.

A do të thonit: "Unë bëj atë që bëj sepse jam Zoti më ka thënë, unë e dua Atë dhe dua ta kënaq"? A është kjo arsye përse ju nuk vrisni apo vidhni? Nuk ju duket asgjë e gabuar për ti bërë këto gjëra, por thjesht ju doni të kënaqni Zotin. Për ndonjë arsye Ai nuk e pëlqen kur ju vidhni ose gënjeni, dhe për shkak se Ai ka qenë shumë bujar me ju, ju ndiheni të detyruar ta kënaqni Atë duke treguar mirënjohjen tuaj.

Përsëri, kështu flet një shërbëtor. Dhe përsëri mund të jetë e kuptueshme për fëmijët dhe besimtarët fillestar. Kjo është të paktën më e mirë se bindje për shkak të frikës apo shpërblimit. Por përsëri ky qëndrim shfaq urdhërimet e Zotit arbitrare dhe nuk tregon Zotin si një Mbret me karakter të mirë.

Ka një mënyrë tjetër për të shfaqur bindjen. A mund të thonit: "Unë bëj atë që bëj sepse kjo është e drejtë dhe e llogjikshme. Unë kam një respekt dhe admirim të thellë për Atë që i vendosi këto urdhërime kur unë isha akoma i paditur. Dhe për shkak se jam i paditur jam i gatshëm të besoj dhe ti bindem (edhe nëse nuk arrij ta kuptoj plotësisht akoma) Atij këshilat e të cilat janë provuar të kënë qenë të drejta."

Kështu flet një mik i kuptueshëm. Dhe ky qëndrim e tregon Perëndinë si një Person miqësor, i admirueshëm dhe i besueshëm.

Kur Zoti i kërkoi mikut të tij Abraham të sakrifikonte birin e tij, Abrahami e njihte Zotin aq i mirë sa iu bind këtij urdhërimi të pabesueshëm. Por gjatë udhëtimit për tek vendi i sakrificës Abraham me respekt vazhdimisht pyeti Zotin: “Pse?” Duke reflektuar në dritën e njohurisë për Zotin ai arriti në përfundimin se Zoti o do të siguronte një zëvendësues, ose do të ringjallte birin e tij. Miku i vjetër i Perëndisë kishte të drejtë! (Zanafilla 22:8; Hebrejët 11:19)

Në atë ditë të trishtueshme kur qeni ynë ngordhi, ne e ngushëlluam veten tonë duke blerë një këlysh mastif Anglez. Edhe pse ajo është e rritur tani, ajo akoma sillet si një këlyshe. Veçanërisht ajo bën prapësira në kopshtin tonë duke shkatërruar lulet.

Moli zbuloi shumë shpejtë që nuk ishim të kënaqur për atë që bënte me lulet. Kështu ne vendosëm një rregull që ajo as nuk duhet ti preki atë lule tunduese.

Moli është një qen shumë e dashur dhe kur ne shfaqim mërzitjen tonë për mosbindjen e saj, ajo qendronte e bindur. Deri sa ajo mendonte që ne po e shikonim atë! Por në atë moment kur ne kthehem në shtëpi, ajo direkt sulmonte lulet.

Na duheshe të vraponim në kopsht dhe ti tregonim prap rregullin. Me kalimin e kohës Moli mësoi të bindeshe edhe kur ne nuk ishim pranë saj. Tani ajo thjesht shikon ato lule me dëshirë, por nuk i prekë më ato.

Ne nuk presim që Moli do të vendos vet që kjo është një gjë e drejtë dhe e logjikshme të mos këputi lulet. Na mjafton që ajo bindet nga dashuria dhe dëshirë për të na kënaqi neve.

Por padyshim do të ishte shumë zhgënjyese për Zotin, nëse fëmijët e Tij inteligjent bindin Atij si qenjt të dashur dhe mirë-trajnuar.

Pse i lajmë ne dhëmbët?

Kur unë isha i vogël, nëna ime vinte tek dhoma e gjumit çdo natë. Dhe shpesh herë ajo na pyeste: “A u lute? A e lexove Biblen? A i lave këmbët dhe dhëmbët?”

Nëse përgjigja do të ishte JO, nëna do të insistonte që ti bënim këto para se të flinim. Në atë kohë unë i laja dhëmbët vetëm sepse nëna ime më thoshte. Unë e doja atë dhe nuk kisha asnjë dëshirë të dënohesha.

Por tani që unë jam i rritur, askush nuk më urdhëron mua të laj dhëmbët. Unë e di që është e shëndetshme ti lajë dhëmbët, sepse e di se çfarë ndodh nëse nuk e bëj këtë. Tek muri i dentistit tim është një poster: “Ju duhet të pastroni vetëm ato dhëmbat që doni ti mbani.”

Nëse nëna ime do të kishte mundësi të më pyeste përsëri – a i ke larë dhëmbët – si mëndoni – a do të murmurisja: “Prapë me këto rregullat e tua?” Jo. Unë do të kisha dëshirë që ajo të mi bënte këto pyetje.

Unë do të doja ta falenderoja atë për vitet që më bëri ti lajë dhëmbët. Prandaj dhe sot e kësaj dite më kanë ngelur disa dhëmb për të larë. Dhe do të doja ta falenderoja që ajo na ndihmoi neve ta kuptojmë pse Zoti i përdori aq shumë rregullat.

8. PIKPAMJE NDAJ SHPËTIMIT NGA SYTË TË SHËRBËTORËT DHE MIQTË

Duket që opinioni që njerëzit kanë rreth Zotit dhe kuptimi i tyre ndaj ligjit të Tij ndikojnë shumë në mënyrën se si ata e shikojnë mëkatit dhe planin e shpëtimit. Por çfarë thotë Bibla rreth mëkatit?

‘Mëkati është shkelje e ligjit. (1 Gjonit 3:4)

Madje, ‘Ai, pra, që di të bëjë të mirë edhe nuk e bën, bën mëkat.’ (Jakobi 4:17)

Nëse ne përpiqemi të lexojmë dhe të kuptojmë Biblën si njësi dhe shkojmë tek teksti origjinal, shumë shpejtë jemi të qartë që Bibla jo gjithmonë përshkruan mëkatit thjeshtë si rregull të shkelur.

Në përkufizimin i famshëm të 1 Gjonit 3:4 fjala greke “shkelje e ligjit” fjalë për fjalë mund të jetë gjithashtu përkthyer si “paligjësia.” Kjo do të thotë që mëkati së pari është një qëndrim rebel dhe armiqësor ndaj Zotit dhe ligjit të Tij, i cili mund të drejtoj një njeri për të shkelur atë ose të veproj në mënyrën e pabindur.

The New Revised Standard Version të vitit 1989 përkthen 1 Gjoni 3:4 : **“Çdo njeri i cili mëkaton është fajtor ndaj paligjësisë; mëkati është paligjësia.”**

Bindja që vjen nga besimi

Në parafjalën e letrës të drejtuar besimtarëve në Romë Pali shpall besimin e tij që ai i është dërguar veçanërisht për të përhapur një bindje të re. Kjo bindje duhet të jetë ndryshe nga asaj që ai kishte ofruar Zotit para se ai të takonte Krishtin në rrugën për ne Damask. Këtë bindje të re ai fjalë për fjalë e quan “bindje e besimit.”

“Bindje ligjore” është ajo bindje që Pali kishte vënë në praktik me një zellë të madh dhe ajo nuk e kishte kënaqur atë fare. Ajo e bënte Palin intolerant ndaj njerëzve të tjerë, bile zemërgur. Për shkakun e “bindjes ligjore” ai kishte dhunuar Frymën e ligjit të Zotit – ligjit të dashurisë.

Por tani, duke inkurajuar “bindjen e besimit” a është Pali duke refuzuar ligjin? **“Kështu mos qoftë!”** thotë Pali. **“Përkundrazi e forcojmë ligjin.” (Romakët 3:31)** Përkthimi Phillips thotë: **“Ne vëmë Ligjin në vendin e duhur.”**

Një nga vendet e duhura të ligjit ka qënë të na shërbej ne si “udhëheqësi ynë për te Krishti”. Por vendi themelor i ligjit është ai për të cilën flet Jeremia. Pali bie dakort me profetin. Ajo që kërkon ligji mund të jetë shkruar në zemër – vendin ku, si shpjegon Pali besimtareve në Romë, ndërgjegjja vepron dhe njerëzit mendojnë. (Romakëve 2:15)

“Bindja e besimit” është rezultat i “njohjes” së Zotit në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Ajo vjen kur njerëzit mësojnë të vërtetën rreth Zotit dhe përdorimit të ligjit të Tij. Kjo bindje krijohet kur njeriu përsëri ka besim tek Zoti si një Mik dhe e admiron Atë për rrugët e urta dhe të mëshirshme.

Kjo do të thotë që Fryma e së Vërtetës ka patur sukses në shkruajtjen e ligjit “në zemrat tona”. Tani ne jemi të lirë për të zbatuar atë çfarë kërkon ligji, jo sepse kështu është urdhëri, por sepse ne jemi bindur në mendjen tonë që ajo që kërkon ligji është e drejtë.

Dëgjueshmëri që vjen nga bindja

Të veprosh pa ose kundër bindjes së vet është mëkat, u thotë Pali besimtareve në Romë. **“Çdo gjë që nuk bëhet me besim është mëkat.” (Romakët 14:23)**

Një domethënie e fjalës e cila zakonisht është përkthyer si “besim” është “bindje.” Në përkufizimin i famshëm të besimit tek Hebrenjve 11:1, besimi është përshkruar si “regjim i gjerava që nuk shihen,” dhe në fakt “bindje” është domethënie origjinale e fjalës greke.

Nga diskutimi i Palit në kapitullin 14 është shumë e qartë që në vargun 23 ai përdor fjalën “besim” me domethënie “bindje.” Prandaj *New Revised Standard Version* përkthen: **“Çdo gjë që nuk vjen nga besimi është mëkat,”** me shënim: **“ose bindjes.”**

Nuk është shumë e vështirë të kuptosh se si veprimi *kundër* bindjes së vet mund të jetë parë si mëkat. Jo që personi i cili ka bërë ndonjë gabim tani është në telashe ligjore me Zotin. Por duke dhunuar ndërgjegjen ai/ajo dobëson aftësinë e tij/saj për të dalluar të drejtën nga e padrejta. Kjo do të thotë të jesh një person të cilit i mungon ndershmëria dhe kështu nuk është e sigurt ta besosh atë.

Ky nuk është mënyra se si vepron një mik i besueshëm. Paga e dhunës së bindjes së vet është shumë e shtrenjtë.

Por duket që Pali gjithashtu na paralajmëron që të veprosh *pa bindje* personale gjithashtu është mëkat dhe e padrejtë. **“Gjithsecili të jetë plotësisht i bindur në mendjen e tij,”** na inkurajon Pali tek *Romakët 14:5*. Si mund të jetë parë si mëkat refuzimi i kësaj ftesë fisnike?

Dështim në pranimin e lirisë dhe përgjegjësisë në vendosmërinë për vete dhe mbështetja tek të tjerët duke kërkuar drejtimin, na bën ne shumë të hapur për ndonjë ndikim të dëmshëm. Një person i tillë bëhet si fëmijët të cilët Pali i përshkruan si **“të lëkundur dhe të transportuar nga çdo erë e doktrinës.”** (Efesianëve 4:14) Ai **“i ngjan valës së detit,”** Jakobi bie dakort me Palin, **“të cilën e ngre dhe e përplas era... sepse është një njeri me dy mendje, i paqëndrueshëm në gjithë rrugët e veta.”** (Jakobit 1:6-8)

Hebrenjve na e përshkruan një person të tillë si një fëmijë të pandihmë, sepse “vetitë” e tij nuk kanë qënë të zhvilluara nga përvoja **“për të dalluar të mirën dhe të keqen.”** (Hebrenjve 5:13, 14) Nëse njeriu nuk zhvillon këtë aftësi të dhënë nga Zoti për të marrë vendime vetë, ai dëmton atë vend me të cilën ai mendon – atë vend në të cilën Fryma e së Vërtetës kryen punën e Tij më të rëndësishme.

Një person i tillë – i lëkundshëm – nuk mund të jetë një mik i besueshëm në të cilën mund të mbështetësh. Ashtu si rezultati e të vepruarit *kundër* bindjes personale, edhe paga e mos të formuarit të bindjes është e shtrenjtë gjithashtu.

Mëkati i Moisiut tek shkëmbi

Jo shumë kohë para se Israeli kaloi lumin Jordan për të hyrë në Kanaan, miku më i mirë i Zotit – Moisiu – kreu një mëkat aq serioz sa nuk u lejua për të hyrë së bashku me popullin e tij në Tokën e Premtuar.

Njerëzit sërish ishin duke u ankuar rreth mungesës së ujit. “Pse na solli nga Egjipti në këtë vend të mjeruar?” Atëherë Moisiu dhe Aaroni foli me Zotin për këtë çështje.

“ ‘Mblidhi njerëzit së bashku,’ i tha Perëndia. ‘Foli shkëmbit para syvë të tyre dhe ai do të nxjerrë ujë.’ ”

Moisiu dhe Aaroni mblodhën popullin. Por Moisiu nuk iu bind urdhërit të Zotit. Ai akoma ndihej shumë i acaruar me njerëzit mosmirënjohës që ankoheshin.



“ ‘Tani dëgjoni, o rebelë,’ ” Moisiu bërtiti me inat, “ ‘a duhet të nxjerrim ujë për ju nga ky shkëmb.’ ” Pastaj Moisiu ngriti dorën, goditi shkëmbin me bastunin e tij dy herë dhe prej tij doli ujë me bollëk; Kështu asambleja dhe bagëtia pinë ujë.

“Por Zoti u tha Moisiut dhe Aaronit: ‘Me qenë se nuk më besuat për të më mbuluar me lavdi para syve të bijve të Izraelit, ju nuk do ta futni këtë asamble në vendin që unë u dhashë atyre.’ ” Numrat 20:8-12

Moisiu iu përgjërua Zotit për ta ridiskutuar këtë vendim. **“ ‘Lejomë të shkoj dhe të shikoj tokën në anën tjetër e Jordanit!’ ”**Në fakt, ai iu përgjërua Zotit aq shumë sa Zoti më në fund iu përgjigj mikut të Tij troç: **“‘Mjaft me kaq; mos më fol më për këtë gjë.’ ” (Ligji i Përtërirë 3:23-26)**

Në fotografi - Shkëmbi prej së cilit doli ujë

Para se Moisiu të ngjitej në Malin Nebo për të vdekur, Zoti i kujtoi atë se çfarë saktësisht ishte ai gabim fatal tek shkëmbi që meritoi dënimin e rrept të humbjes së çmimit të shërbimit besnik të 40 viteve. Interesante si Moisiu ndjeu duke e shkruar këtë për brezat e ardhshëm?

“ ‘Sepse u treguat të pabesë [shkelet besimin] me mua në mes të bijve të Izraelit ... Dhe sepse nuk më shenjtëruat në mes të bijve të Izraelit.’ ” (Ligji i Përtërirë 32:51)

Moisiu ndaloi mbrojtjen e reputacionit të Zotit. Kujtoni se si ai bindi popullin që nuk ka nevojë që të kishin frikë nga Zoti. Kujtoni historinë se si ai këshilloi Zotin që të mos njolloste reputacionin e Vet.

Tani Moisiu kishte tradhëtuar Zotin. Ai kishte “shkelur besimin.” Ai nuk lejoi Zotin të shfaq Vetën para njerëzve në mënyrën se si Ai donte ata të shikonte Atë.

Para se populli të hynte në tokën e Kanaanit me gjithë rrezikun që po e priste atë, ishte shumë e rëndësishme që populli kishte besim të palëkundshëm tek Zoti ose përndryshe nuk do të kishin mbijetuar. Por në atë moment duke qenë në shkretëtirë populli ishte në një gjendje armiqësore dhe dyshuese. Si mund të ndryshoj Zoti mendjen atyre që të ndiheshin të sigurt dhe të besonin se Ai do të kujdesej për ata?

Si e shpjegoi Pali më vonë, pikërisht se mirësia dhe zemërgjerësia shkakton pendimin dhe besimin.

Atë ditë Perëndia zgjodhi t’u jap njerëzve ujin e nevojshëm edhe pse ata nuk e meritonin. Pa zemërim. Pa dënim. Pa qortim. Vetëm rrëke uji të freskët. Ah sikur ne të kishim një shënim që disa zemra të njerëzve u preken nga ajo!

Por Moisiu ngatërroi atë çfarë Zoti donte të tregonte. Me inatin dhe padurimin e tij ai e keqpërfaqësoi Zotin. Vite përpara njerëzit i kishin kërkuar Moisiut që ai të ishte ndërmjetësi midis tyre dhe zemërimit të Zotit dhe që të ishte folësi i Tij. Dhe tani nëse madje Moisiu i përlur ishte aq i zemëruar me ata, aman, sa i tërbuar është vet Zoti.

Kur njerëzit morën vesh që Moisiut nuk i lejohej që të hynte me ata në Tokën e Premtuar, ata pa tjetër duhet të ishin shumë kurioze rreth hakut të këtij dënimi kaq të rreptë. “Si mendoni, çfarë ka bërë plaku?” “Dhe pse ai nuk ofron një sakrificë për fajin e tij dhe pse nuk kërkon falje? Zoti do ta lejonte atë që të hynte më pas.” Këto janë thashëthemet e mundshme të popullit.

Por Zoti e kishte falur mikun e Tij. Moisiu pa tjetër ishte i tmerruar nga serioziteti i mëkatit të tij. “O Zot, më vjen keq që të tradhëtova. Por të lutem, a mund të jemi miq përsëri?”

Zoti e dinte që trajtimi i ashpër i mikut të Tij të vjetër nuk do ta shkatërronte miqësinë e tyre. Ai e dinte që Moisiu si miku i Tij do ta kuptonte.

Zoti kështu tregoi para gjithë universit që nuk ka një gjë më serioze se sa tradhëtia nga miku. Nuk ka mëkat më të dëmshëm se sa kur një udhëheqësi me ndikim të madh keqpërfaqëson të vërtetën rreth Zotit. Zoti ishte me Moisiun në malin Nebo kur ai vdiq. (Ligji i Përtërirë 34:1-6.) Dhe Ai e solli Moisiun në Malin e Shpërfytyrimit për të folur ballë për ballë. (Mateu 17:3; Marku 9:4; Luka 9:30) Zoti dhe Moisiu akoma janë miqtë e mirë.

Kuptimi i mëkatit si një Problem Juridik

Fakti që mëkati është shkelja e besimit nuk është merak i parë i shërbëtorëve – dmth. ato shërbëtor që përshkruan Krishti tek Gjoni 15:15.

“Shërbëtorët,” Ai i shpjegoi dishepujve të Tij, “nuk e dinë ç’bën i zoti.” Ata nuk kanë asnjë pikë interesi për të kuptuar se ç’bën padroni i tyre. Dëtyra e tyre është të bëjnë atë çfarë u është urdhëruar atyre – pavarësisht a bien dakort ata me të apo jo.

Besimtarët të cilët mendojnë dhe veprojnë si shërbëtorët e tillë janë preokupuar me qëndrimin e tyre juridik para Zotit, si ta kënaqin Atë dhe si të mos hapin ndonjë telash. Mëkati në sytë e tyre së pari është shkelje e ligjeve.

Sipas kuptimit të tyre shkelja e ligjeve do të shkaktojë zemërimin e Perëndisë dhe kjo do të thotë që ata do të jenë në probleme serioze juridike me Zotin. Nëse nuk është bërë diçka për të shlyer fajin e tyre, ata do të vuajnë denimin ligjor. Dhe mosbindja më e vogël e rregullave është denimi i vdekjes në mënyrë shumë të dhimbshme ose madje torturat e përgjeshme.

Disa besimtarë-shërbëtor janë aq të mësuar me qeverisjen e tillë sa bile mbrojnë me zellë të madh këtë sistem në emër të drejtësisë, sipas kuptimit të tyre. Ata do të bien dakort që në gjykata të civilizuara drejtësia kurrë nuk e justifikon torturën. Por në qeverinë e Perëndisë? Atëherë shërbëtorët pyesin: “Kush je ti që pyet për rrugët misterioze të Zotit? Si një shërbëtor besnik ti vetëm duhet të ulesh kokën dhe të besosh. Një trajtim aq i frikshëm nga anë e Perëndisë nuk është vetëm i drejtë por madje plot me dashuri.”

Unë kam dëgjuar një shërbëtor të mirë dhe besnik duke thënë: “Ligji, drejtësia dhe shenjtërimi i karakterit dhe qeverisjes së Tij, kërkon që Zoti jo vetëm të shkatërrojë ata që kundërshtojnë vullnetin e Tij por para kësaj edhe të dënojë ata në mënyrë të dhimbshme për një kohë të përshtatshme.”

Kur unë e pyeta si një denim aq mizor mund të jetë një veprim plot dashuri, ai mu përgjigj: “A nuk beson ti në Shkrimet? Bibla thotë që Perëndia është dashuri. Kjo do të thotë që veprimet e Tij edhe pse nuk na duken kështu, gjithmonë janë plot dashuri.”

Kjo më kujtoi përsëri atë ngjitsën në makinat e të krishterëve.

“Perëndia juaj është tepër xhentil!”

Unë kam dëgjuar nganjëherë shërbëtorët duke akuzuar miqtë që atyre u mungon sensi i drejtësisë. Miqtë nuk i kushtojnë vëmendje faktit që Zoti është i detyruar për të kryer një dënim të drejtë dhe të nevojshëm. Perëndia e miqve është tepër i dobët dhe xhentil.

Në fakt, e vërteta është e kundërta. Besimtarët-miq i kushtojnë shumë vëmendje drejtësisë.

Miqtë admirojnë drejtësinë e Zotit dhe deshirojnë që t’i ngjajnë Atij. Të jesh i drejtë do të thotë të veprosh në mënyrë të drejtë, apo jo? Por shërbëtorët mendojnë rreth drejtësisë vetëm në kornizat e pagës dhe dënimit.

“Unë gjej ngushëllimin kur mendoj që Zoti një ditë do të dënojë ata që më kanë lënduar aq shumë,” unë dëgjova një besimtar duke thënë. “Nuk është që unë po kërkoj hakmarrjen, më kuptoni drejtë, thjeshtë unë po kërkoj manifestimin e drejtësisë.”



Në 24 Janar, 1989, Ted Bandi (Ted Bundy – në fotografi) – një vrasës serial jashtzakonisht mizor, ishte denuar me vdekje në karriken elektrike. Sa po afroheshe ora e ekzekutimit, një turmë e madhe u mbledh jashtë burgut. Atje mund të shikoje disa njerëzit shumë fetare duke bërë titur:

“Digju, Bandi, digju!”

Më vonë disa ishin duke ankuar që kjo është padrejtësia e madhe që Bandi duhet të digjeshe për një kohë aq të shkurtër. Drejtësia nuk ishte kënaqur me këtë. Por këto njerëz ngushëllojnë vetveten duke menduar që një ditë Perëndia vet do të marrë këtë çeshtje në dorë dhe atëherë drejtësia do të festoheshe sepse Bandi do të digjet në përjetësi.

Shkatërrimi nuk i disiplinon të shkatërruarit

Miqtë kuptojnë nevojën për dënim. Ata e dinë që Perëndia i disiplinon ata që Ai do. Arsyeja e disiplinimit është mësim dhe qortim, dhe miqtë besojnë Zotin duke pranuar ndëshkimin kur ata kanë nevojë për atë. Dhe ata nuk acarohen me disiplinimin siç bëjnë zakonisht shërbëtorët.

Ata e dinë që disiplinimi nga Zoti është për të mirën e tyre. “Faleminderit, o Zot, unë kisha nevojë për këtë,” është përgjigjja e një miku mirënjohës.

Por shkatërrimi nuk është disiplinë. *Shkatërrimi nuk i disiplinon të shkatërruarit*. Dhe vuajtja e vazhdueshme e ekzekutimit nuk u mëson gjë. Se jeta e tij/saj ka marrë fund.

A duhet Zoti të zgjasë vuajtjen për t’u mësuar diçka atyre që po shikojnë dënimin? A do t’i thojnë shënjtoret Perëndisë, duke vëzhguar në Mbretërinë Qiellore agoninë e njerëzve të humbur: “Faleminderit, o Zot, ne kishim nevojë për këtë. Drejtësia kërkoi që ata duhet të dënoheshin kështu dhe ne kishim nevojë ta shikonim këtë. Dhe nëse kjo është mënyra se si Ti i trajton mëkatarët, mund të na besosh që ne do të të bindemi Ty në përjetësi!”

Kjo bindje vjen nga frika, bindja e shërbëtorëve të tmerruar të cilët vetëm plotësojnë urdhërat. Kjo nuk do të ishte bashkpunim i lirshëm midis miqve, siç dëshiron Perëndia. Si mendoni – çfarë do të thoshin miqtë e Perëndisë duke vëzhguar vdekjen e njerëzve të ligë?

Pikëpamja e shërbëtorëve mbi shpëtimin

Sipas kuptimit të shërbëtorit mbi mëkatin dhe ndëshkimin hyjnor, shpëtimi është parë si kusht i mëshirshëm i Zotit me anë të cilit qëndrimi ligjor i shërbëtorit të fajshëm mund të shfajsohet dhe ai nuk ka për të marrë dënim.

Si vdekja e një zëvendësuesi të pafajshëm mundëson këtë gjë, nuk është një pyetje serioze për shërbëtorët. E vetmja gjë që intereson shërbëtorin është – a është Zoti i kënaqur dhe a është i qetësuar ose i “shlyer” zemërimi i drejtë rreth shkeljeve e mëkatarit?

Fjalë të veçanta

A e dini domethënien e fjalës “shlyerje”? Kur vajza ime e madhe ishte akoma e vogël, një ditë ajo ishte duke mësuar me zë vargun e Romakëve 3:25 për klasën biblike. Ajo gaboi në shqiptimin e “shlyerjes” dhe unë pas korrigjimit e pyeta a e dinte ajo kuptimin e kësaj fjale.

“Jo, Babi, nuk na kërkohet që të dime kuptimin e fjalëve. Thjesht ne duhet të mësojmë përmendësh një varg çdo javë dhe për këtë ata na japin një yll ngjitës.”

Kjo më kujtoi historinë rreth një gruaje e cila i tregonte pastorit që Bibla përmban një fjalë veçanërisht frymëzuese për zemrën e saj. “Cila fjala?” e pyeti pastori me kureshtje. “Oh,” tha ajo me sytë e ndriçëm, “është një fjalë e mrekullueshme Mesopotamia!” (Zanafilla 24:10 dhe Veprat 7:2)

Një nga karakteristikat e pikëpamjes mbi mëkatin dhe shpëtimin e një shërbëtori është përdorimi i shpeshtë i termave dhe frazave që miqtë do t’i konsiderojnë si “fjalët e errëta.” Termat si p.sh. “shfajsimi,” “shenjtërimi” dhe pa tjetër, “shlyerja.”¹

¹ Ne anglisht – justification, sanctification, expiation dhe propitiation.

Është mirë të kujtojmë që në fakt shkrimtarët e Biblës kurrë nuk kanë përdorur fjalë të tilla. Madje Pali kurrë nuk ka përdorur fjalën “shënjtërim”, për të cilën ai është aq i famshëm. Shfajsimi (justification) në anglisht ka rrënjë në gjuhën latine. Pali shkruajti letrat e tij në greqishtjen e vjetër, dhe kjo gjuhë mund të përkthehet më thjesht se sa na ofrojnë disa përkthime të Biblës.

Fraza të shenjta

Frazat e famshme si “i pastruar në gjak,” “gjaku ka fuqi,” “i mbuluar me drejtësinë e Tij,” “i shpëtuar me anë të gjakut të Qengjit,” dhe shumë të tjera klasifikohen si “fjalë të errëta.” Kjo pa tjerët nuk do të thotë që domethëniet e tyre nuk janë të rëndësishme. Por çfarë do të thojnë këto fraza?

Përpikuni të shpjegoni një fëmijë i cili sapo ka vrarë gjurin – çfarë do të thotë “i pastruar me gjakun e Qengjit.” Besoj që ky është një provim i rënd për kuptimin tonë për t’i shpjeguar fëmijës e vogël së çfarë do të thotë mëkat dhe shpëtim.

Në leskionin mbi fenë, unë e pyeta një student të mjekësisë që të më shpjegonte mendimin e tij – pse Krishti duhej të vdiste. “Sepse ‘pa derdhur gjak nuk ka ndjesë,’ ” ai mu përgjigj pa hezitim, duke cituar vargun e famshëm të Hebrenjve 9:22 dhe u ul në karrigën e tij sikur asnjë gjë nuk mund të shtoheshe.

“A do të thotë kjo,” unë këmbëngula, “që nëse Krishti vdiq pa derdhur gjak, Zoti nuk mund të kishte falur mëkatat?”

“Pse nuk mund të pranoni Biblën në mënyrën se si ajo është shkruar?” m’u kthye ai i shqetësuar. “Pse gjithmonë duhet të ngatërroji gjëra duke pyetur rreth kuptimit të tyre?”

A nuk është kjo mënyrë se si flasin shërbëtorët?

Pikëpamje të miqve të Perëndisë

Fakti që miqtë e Perëndisë nuk shqetësohen aq shumë rreth gjendjes së tyre juridike nuk do të thotë që ata e shikojnë ligjin me mendjelehtësi. E kundërta! Shërbëtorët shqetësohen që të mos shkelin ndonjë rregull, kurse miqtë shqetësohen për të mos tradhëtuar besimin që Zoti ka për ta dhe të mos shkatërrojnë marrëdhënien me Perëndinë. Dhe mbi të gjitha ata kujdesin që të mos keqpërzantojnë Perëndinë – pavarësisht a janë detaje të tilla të përcaktuara nga ndonjë ligj.

Miq të kuptojnë shpëtimin si shërim e dëmin e shkaktuar nga mëkati. Dhe dëmi i mëkatit, pa shërim, është fatal. Sjellje e çregullt dhe e papërgjegjshme në mënyrë të vazhdueshme, mund të shkatërrojë kapacitetin, e besimit dhe besueshmërisë.

Shërbëtorët ruhen nga mëkati sepse ai zemëron Perëndinë.

Miq të ruhen nga mëkati për shkakun se çfarë mëkati i bën mëkatarit. Të vazhdojnë të mëkatojnë do të thotë të shkatërrojnë vetveten.

Mëkati është si një helm

Nëse do të kishit nevojë të mbanit ndonjë helm në shtëpinë tuaj, ku do ta vendosni atë? Atje ku fëmijët e tu mund të gjenin kollaj? Ose në raftin më të lartë të garazhit tuaj?

“Në asnjë mënyrë nuk duhet ta prekni helmin,” ju i paralajmëroni fëmijët. “As mos t’i afroheni raftit. Nëse nuk do të më bindeni mua, do t’ju dënoj shumë rëndë.”

Pas ca kohë ju dëgjoni një përplasje. Ju nxitoni për në garazh dhe atje në dyshe me është biri yt dhe shishja e thyer pranë tij.

Çfarë do të bëni me fëmijën tënd që po vdes? Ai nuk u është bindur juve. A do të mendoni që ai duhet të jetë i dënuar me vdekje për mosbindjen e tij? Ai është tashme duke vdekur!

Ju e dini që helmi ka efekt të shpejt. Nuk keni shumë kohë në dispozicion. A do të humbisni çaste e çmuara për të qortuar birin? A do të këmbëngulni që ai duhet të pendohet dhe t’ju kërkojë falje? A do të shëronte falja atë që ai të mos vdiste?

Ju vraponi për të marrë antihelmin. Por biri yt refuzon ta pijë atë dhe kështu ju me vajtëm shikoni se si ai po vdes.

Çfarë shkaktoi vdekjen e tij? Ju e keni dashur atë. Ju e keni falur atë. Ju i keni ofruar antihelmin atij. Por megjithatë ai vdiq.

Miqtë nuk shikojnë mëkatin si një problem juridik. Në pikpamjen e tyre mëkati vepron si një helm. Dhe ata e kuptojnë planin e shpëtimit si një antihelm i ofruar nga Perëndia.

Por çfarë ndodh kur ne refuzojmë antihelmin? Çfarë ndodh me ata që hedhin posht ofertën e shpëtimit?

9. BESIMI DHE TRADHËTIA

Profiti Osea fillon librin e tij duke treguar histori se si Zoti i kërkoi atij të bëj diçka që në sytë e tij patjetër ishte si diçka e pabesueshme. Zoti i kërkoi atij të martohen me një grua, sjellja e së cilës ishte si e një prostitute.

Ky urdhër nuk ishte sipas ligjeve që Zoti kishte dhënë për përdorimin e përditshëm. Dhe gjithashtu ky urdhër nuk është aq i logjikshëm sa që njeriu do ta bënte këtë edhe pa asnjë kërkesë nga ana e Zotit.

Ky urdhër ishte po aq i veçant si ai i dhënë Abrahamit. Zoti kishte diçka shumë të rëndësishme për t'i treguar njerëzve të Tij, prandaj Ai i kërkoi mikut të Tij Osea që jo vetëm të tregoj mesazhin me gojë por edhe ta demonstroj kuptimin e këtij mesazhi.

Për shkakun se Osea e njihte Zotin shumë mirë, siç kuptojmë nga libri i tij, ai iu bind Zotit dhe u martua me Gomerën. Ata kishin tre fëmijë. Varet se si e lexoni këtë histori, por ndoshta vetëm një për tyre ishte i Oseas. Më vonë ajo e la burrin për të jetuar me dashnorët e saj.

“O Zot, a do të thotë kjo që kam plotësuar urdherin Tënd dhe jam i lirë?” ndoshta mendoi Osea.

“Jo, gjëja më e rëndësishme që do të bësh e ke përpara. Tani shko dhe gjeje gruan tënde. Merr para me vete në rastin nëse duhet të paguash për atë. Kur ta gjeshe atë, përpiku ta bindesh atë që të kthehet në shtëpi dhe të ishte nga tani e tutje një nuse besnike.”

Kështu Osea iku për të kërkuar nusen e tij. Imagjinoni se si ai shkonte nga një vend në tjetër duke pyetur: “Mos keni parë Gomerën?”

Më në fund ai e gjeti atë. Nëse ju do të ishit në vendin e Oseas, çfarë do të kishit për t'i thënë nuses? Nëse do të kishit dashuri për atë, a do të ndëshkonit atë për gjërat që ajo ka bërë? A do ta kishit kapur atë dhe tërhiqur zvarrë atë në shtëpi me forcë? Nëse bëri kështu a mendoni që ajo deshtë të jetoj me ju përsëri? Nëse ajo refuzoi absolutisht për të kthyer tek ju, a do të ishin dakort të lejoj asaj të largohej prej ju?

Pavarsisht çfarë bëri Osea Gomera erdhi me të në shtëpi.

Si ndihet Zoti për njerëzit e Tij jobesnik

Historia e profetit dhe gruas së tij si duket përfaqëson marrëdhënien midis Perëndisë dhe njerëzve të Tij të pabesë. Për një kohë të gjatë Perëndia u përpoq t'i mbushë mendjen Israelit rebel për t'u kthyer tek Ai, të ketë besim dhe të sillej si njerëzit e besueshëm. Por edhe pse ata ishin pasardhësit e Abrahamit – mikut të ngushtë të Zotit – ata përqeshnin dashurinë e Tij dhe refuzonin çdo thirrje të Tij.

Kështu që besimi nuk fitohet me forcë, çfarë tjetër mund të kishte bërë Zoti veç të lejonte me trishtim të madh ata, që të largoheshin nga Ai? Por pa mbrojtjen e Tij rezultatet ishin të tmerrshme.

Me vajtim Perëndia kujton shekuj të gjatë të dashurisë së përcëmuar.

"Kur Izraeli ishte fëmijë, unë e desha dhe nga Egjipti thirra birin tim. Sa më shumë i thërrisnin profetët, aq më tepër janë larguar prej tyre, u kanë bërë flijime Baalëve dhe u kanë djegur temjan figurave të gdhendura.

Unë vetë i mësova Efraimit të ecë, duke e mbajtur nga krahët; por ata nuk e kuptuan që unë po i shëroja. Unë i tërhiqja me litarë të dashamirësisë njerëzore, me lidhje dashurie; isha për ta si ai që e ngre zgjedhën nga qafa e tyre, dhe përulesha për t'u dhënë të hanë.

Izraeli nuk do të kthehet në vendin e Egjipti; por Asiri do të jetë mbreti i tij, sepse nuk kanë pranuar të konvertohen. Shpata do të bjerë mbi qytetet e tij, do të shkatërrojë shufrat e tyre dhe do t'i hajë për shkak të planeve të tyre të këqija.

Populli im synon të largohet nga unë; megjithatë e thërresin Shumë të Lartin, asnjë prej tyre nuk e përlehtë.

Si mund të të braktis, o Efraim, ose të të lë në dorë të të tjerëve, o Izrael? Si mund të të bëj si Admahu, ose të të katandis si Tseboimi? Zemra ime ngashërohet brenda meje, dhembshuria ime ndizet e tëra. (Osea 11:1-8)

Tek përkthimin e Phillips ne lexojmë tek vargun 8:

“Si, oh si mund të heq dorë nga ty, Efraim! Si mund të të dorëzoj ty, Israel!”

Pali patjetër e ka lexuar librin e Osesë

Apostulli Pal si një hebre me arsim të lartë shpesh herë ka lexuar shkrimet e Osesë. Interesante, se si është ndjerë Pali duke lexuar se si i trajton Perëndia ata që e refuzojnë Atë. Ka mundësi që kujtimet rreth këtij teksti i brenin ndërgjegjen e tij gjatë rrugës për në Damask kur ai ishte duke përsekutuar njerëzit të cilët sipas mendjes së tij kishin refuzuar Zotin.

Te paktën kur erdhi koha për të shkruar rreth kësaj teme, Pali shpjegoi tre herë në letrën e drejtuar Romakëve që Perëndia “e hoqi dorën” dhe “dorëzoi” njerëzit të cilët Ai nuk arriti t’i prekë me të vërtetën.

“Sepse zemërimi i Perëndisë zbulohet nga qielli për çdo pabesi e padrejtësi të njerëzve, që mbysin të vërtetën në padrejtësi, meqenëse ajo që mund të njihet prej Perëndisë është bërë e dukshme në ta, sepse Perëndia ua ka shfaqur atyre.

Në fakt cilësitë e tij të padukshme, fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij, duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pafalshëm. Sepse, megjithëse e njohën Perëndinë, nuk e përlëvduan as e falënderuan si Perëndi, përkundrazi u bënë të pamend në arsyetimet e tyre dhe zemra e tyre pa gjykim u errësua.

Duke e deklaruar veten të urtë, u bënë të marrë, dhe e shndërruan lavdinë e Perëndisë së pakalbshëm në një shëmbëllim të ngjashëm me atë të një njeriu të kalbshëm, të shpendëve, të kafshëve katërkëmbëshe dhe të rrëshqanorëve.

Prandaj Perëndia ia dorëzoi papastërtisë në epshet e zemrave të tyre, për të çnderuar trupat e tyre në mes vetë atyre, që e ndryshuan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtëri dhe adhuruan dhe i shërbyen krijesës në vend të Krijuesit, që është i bekuar përjetë.

Prandaj Perëndia i dorëzoi ata në pasione të ulëta...Dhe meqenëse nuk e quajtën me vend të njihnin Perëndinë, Perëndia i dorëzoi në një mendje të çoroditur, për të bërë gjëra të pahijshme. (Romakëve 1:18-28)

Sa e përpiktë është kjo shëmbëlltyrë për Zotin i cili dëshiron dashuri dhe bashkpunim me miqtë e kuptueshëm! Vini re që Zoti nuk është duke dënuar njerëzit me një mendje të çoroditur. Mendjet e tyre bëhen të çoroditura si pasojë e natyrshme e kundërshtimit të tyre dhe e refuzimit të së vërtetës. Ata e këmbyen, “e ndryshuan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtëri” dhe madje kishin filluar të adhuronin kafshët. Disa njerëz në ato ditë madje adhuruan brumbullat dhe krokodilët!

Kështu që sipas ligjit shpirtëror ne përpiqemi t’u ngjasojmë atyre gjërave që ne adhurojmë dhe admirojmë, imagjinoni efektin e adhurimit të një brumbullit. “I dashur Zoti Brumbull,” fëmijët mund të luteshin. “Beko Mamin, beko Babin dhe na ndihmo që të ngajmë më shumë me ty.”

Në fillimin e shpjegimit të tij rreth çfarë bën Zoti me ata që refuzojnë shpëtimin e ofruar, Pali flet rreth zemërimit të Perëndisë.

Është e qartë që zemërimi i Zotit nuk ngjan fare me zemërimin njerëzor. Pali bien dakort me Oseun: Zoti atyre që nuk donë Atë nuk bën tjetër gjë veç tregon rreth dashurisë dhe zhgënjimin e Tij dhe pastaj me trishtim lejon të largohen.

Kur njerëzit këmbëngulin duke refuzuar Zotin dhe shuajtur të vërtetën, çfarë tjetër mund të bëjë Ai veç se t’i dorëzojë ata tek pasojat e pashmangshme të mendimit të tyre të marrë dhe zgjedhjes së rebelimit.

Por sa serioze janë pasojat kur Zoti na dorëzon dhe na lejon që të largohemi? A mund të jenë ato fatale? Dhe nëse po, pse?

Doktorat nuk vrasin pacientët të cilët nuk bashkpujnë me ata

Imagjinoni vetveten tek një mjek. Ai është specialist me famë për atë sëmundje që keni. Megjithatë, kur ai po ju jep ilaçe, ju hezitoni për një çast.

“Oh Doktor,” ju pyesni me merak, “çfarë bëni ju me pacientët që nuk pinë ilaçet që ju u keni dhënë atyre?”

“Pse jeni në siklet?” ai ju pyet.

“Dhe ç’kuptim ka kjo pyetje, ‘Çfarë bëni me pacientet?’ Mos e keni dëgjuar ndonjë thashëthem se si unë i trajtoj pacientët e mi?”

“Epo, doktor, disa njerëz thonë që nëse pacientët e tu nuk i përdorin ilaçet, ju i ndëshkoni ata me rreptësi duke i torturuar dhe madje duke i vrarë ata. Njerëzit thonë që ju e bëni këtë si një mesim për të tjerët që të mos ju vjedhin kohën e çmuar. Dhe besoj se kjo gjithashtu motivon njerëzit për të paguar faturat në kohën e duhur.”

“Pse atëherë keni ardhur tek mua?”

“Epo, i kam provuar të gjithë doktorët e tjerë por asnjeri prej tyre nuk ishte i aftë për të më ndihmuar. Dëgjova që ju keni sukses më të madh për të shëruar sëmundjen time, kështu mendova që ja vlen të rrezikoj.”

Doktori duket shumë i mirëkuptueshëm. “Gjithçka që mund të të them është - të inkurajoj që të përdorësh këto ilaçe. Dhe dua që të përdorësh ato pikërisht në mënyrën që të kam udhëzuar. Gjendje juaj është aq serioze sa që nëse nuk më lejoni t’ju ndihmoj nuk do të keni shumë kohë për të jetuar.”

Doktorët nuk i vrasin pacientët që nuk bashkpunojnë me ta. Por nganjëherë ata duhet t’i shikojnë ata duke vdekur. Dhe nganjëherë edhe mjekëve u vjen për të qarë.

Nganjëherë pacienti që po vdes është fëmijë i doktorit. Si babai dhe mjeku ai ka bërë gjithçka për të bindur djalin për të ndryshuar stilin shkatërrues të jetës së tij.

Por djali ka refuzuar me kokfortësi këshillat e babait dhe ai nuk kishte të bënte asgjë tjetër veçse të dorëzohej. Dhe e vetmja gjë që ai mund të bëjë tani është të rri pranë krëvatit duke parë fëmijën e tij duke vdekur.

A mund të besojmë tek Mjeku Qiellor?

Perëndia ka prezantuar vetveten si Ati dhe Mjeku Qiellor. Kur Jezusi jetoi në këtë tokë, Ai shpenzoi shumë kohë duke shëruar njerëzit e sëmurë. Jezusi kishte shumë pak kohë për të kryer misionin e Tij. Pse vallë Ai nuk shpenzoi më shumë kohë duke predikuar?



Të gjitha 66 librat e Biblës na tregojnë që stili i Perëndisë nuk është vetëm të shpjegoj me fjalë por edhe ta demonstroj me vepra. Çfarë na tregoi Krishti rreth Atit dhe si Ai i trajton mëkatarët, duke shëruar falas llojë llojë njerëz? Disa prej tyre kurrë nuk e falenderuan Atë. Disa prej tyre më vonë madje mund të kenë qenë në anën e armiqve të Krishtit.

Është qartë që Krishti nuk erdhi për të demonstruar Perëndinë si shkatërrimtar. Dhe Perëndia nuk ndryshon kurrë. Njerëzit e humbur takojnë Perëndinë, i cili akoma është Mjeku i tyre ashtu siç edhe më përpara - Mjeku që mërkaset për të ndihmuar njerëzit që të jetojnë.

Por pse atëherë Bibla na i përshkruan njerëzit e humbur duke vdekur? Ata nuk dëshironin të dëgjoheshin. Ata nuk kanë pranuar ilaçe. Ata nuk kanë ndjekur recetën e Doktorit. Çfarë tjetër mund të kishte bërë Mjeku Qiellor veçse t’i dorëzoj ata me trishtim tek pasoja e sëmundjes së tyre?

Por pse ata duhet të shkojnë tek doktori në të cilin ata nuk i besojnë? A do të rrezikoni jetën tuaj duke e lënë atë në duart e një mjeku, i cili ka një famë se ai i trajton pacientë e tij me zemërim dhe dhunë?

Nga ajo ditë kur armiku ka gënjyer rreth Zotit në kopshin e Edenit, Zoti ka patur reputacion të njollësor. Madje ata që thonë që janë miqtë e Tij shpesh herë kanë përshkruar Zotin si arbitrar dhe të rreptë. Ati e kupton pse aq shumë prej fëmijëve të Tij e shmangin Atë dhe shkojnë tek mjekë të ndryshëm.

Ja pse Krishti para se të shkonte në kryqëzim për t’ju përgjigjur pyetjeve rreth pasojave të pashmangshme të mëkatit, Ai për ca kohë jetoi mes nesh. Ai deshte të na sigurojë që Ai, i cili në fund do të jetë i detyruar për të dorëzuar disa prej fëmijëve të Tij, është një Mjek dhe Mik absolutisht i besueshëm.

Ai tregoi një Atë me dashuri të pafund për çdo llojë njeriu, madje për fëmijët e vegjël. Dishepujt supozuan që Shpëtimtari ishte tepër i zënë për të kaluar kohë me fëmijët. Por Jezusi tha: **“I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek Unë.”**(Mateu 19:14)

Ai tregoi çfarë durimi të pafund ka Ati, duke trajtuar çdo person me xhentilesë dhe mirëkuptim maksimal — edhe pse shpesh herë pastaj Ai ishte refuzuar. Një ditë dishepujt e pyetën Krishtin mos dëshiron Ai të sjellë zjarrë nga qielli për të konsumuar të gjithë ata që refuzojnë dashurinë e Perëndisë. Zoti i qortoi ata për padurimin e tyre mizor. Ai kishte ardhur jo për të shkatërruar por për të shëruar. (Luka 9:51-55; 19:10)

Jezusi dëshironte të na mesonte që Ati merakoset për çdo detaj të jetës sonë. Në gëzimin e madh pas ringjalljes së vajzës së Jairit vetëm Jezusi siguroi që t’i jepnin asaj të hante. (Luka 8:49-56)

Demonstrimi i një dashurie të pafund

Në fundin e jetës së Tij të pakrahasueshme, Krishti na demonstroi kulmin e dashurisë së Perëndisë. Krishti u arrestua në mbremjen e së enjtës. Ai u gjykua në mënyrë të paligjshme. Ai u akuzua me gënjeshtër. Ai u ofendua tmerrësisht. Por Ai nuk u zemërua asnjëherë të vetme.

Ai u rrah dy herë me kamzhik. Gjatë gjithë natës Atij as nuk i jepnin bukë as nuk e linin që të flinte në gjumë. Por a u bë Ai i acaruar? As për një çast.

Njerëzit talleshin duke e goditur kokën e Tij të plagosur. Ata qeshnin rreth lindjes së Tij misterioze duke quajtur Atë bastard. Ata madje pështynin në fytyrën e Tij. Por a e humbi Ai durimin? A u zemëroi Ai me torturuesit e Tij? Asnjëherë!

Edhe kur ata e gozhduan Atë në kryq, Ai vazhonte duke thënë: **“O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë.”** (Luka 23:34)

Fakti që Krishti i kërkoi Atit t’i falte torturuesit e Tij do të thotë që Ai vet tashme i kishte falur ata. Asnjëri prej tyre nuk kërkoi falje. Asnjëri nuk iu përgjyera Krishtit që ta falte atë. Por Krishti megjithatë e fali. Dhe mos harroni që Krishti gjithashtu është Perëndia.

Krishti u tregoi dishepujve të Tij që Ai nuk ka më nevojë për tui lutur Atit për ne, sepse vet Ati është aq i dashur dhe i zemërbut si Biri. Nëse Ati do të ishte kryqëzuar në vend të Jezusit, Ai do t’i falte ashtu siç bëri Krishti, edhe pse nuk kishte asnjëri për të ndërmjetësuar midis Perëndisë dhe neve.

10. MIKU MË I MIRË

D

y kriminelë ishin të kryqëzuar pranë Jezusit – njëri djathtas, e tjetri majtas dhe Jezusi në mes tyre. Ata ishin gangstera ose grabitës edhe pse në përkthim ata janë quajtur “cuba” ose “vjedhës”.

Në fillim, që të dy gangsterët marrin pjesë në përbuzjen e Krishtit. Më pas një prej tyre i tha tjetrit: **“E di, ne e meritojmë që jemi këtu, kurse ky njeriu nuk ka bërë asgjë të keqe.”** Ai pa mbishkrim tek kryqi i Krishtit. Atje ishte shkruajtur në hebraisht, latinisht dhe greqisht: **“Ky është Jezusi, Mbreti i Judenjve.”**

Pastaj Krishti i dëgjoi fjalët që patjetër për disa çasta i kanë qetësuar dhimbjen dhe i dhanë kurajo që të gjitha ato vuajtje nuk ishin të kota.

“Zot, kujtohu për mua kur të vish në Mbretërinë tënde.” Dhe Jezusi ia dha fjalën për këtë.

Çfarë ishte ajo që e bëri cubin për vete? Mos ishte çasti kur ai dëgjoi se si Jezusi i falte torturuesit e Tij mizorë? Ashtu siç cubi e pranoi faktin që ai ishte një kriminel, ai mund të kishte pyetur veten – ku do të shkonte pas vdekjes? Për atë një vend i sigurt do të ishte Mbretëria e cila kishte një Mbret zemërbutë.

“Jezus,” hajduti mund të kishte menduar, “nëse Ti do të kesh një mbretëri, më lejo që të jem atje.”

Pastaj Jezusi vuri re nënën e Tij Marinë duke qëndruar afër kryqit. Edhe pse Ai ishte duke vuajtur nga një dhimbje e papërshkrueshme, edhe pse mendja e Tij ishte e mbushur me pyetjet a ja vlente ajo që po bënte, Krishti ishte i shqetësuar për Marinë.

Aty afër Ai pa edhe Gjonin. “Të lutem, kujdesu për nënën time,” i kërkoi Krishti. Dhe që në atë moment ai e mori në shtëpinë e vet.

Shpejt pas kësaj Jezusi vdiq. Dhe duke vdekur Ai nuk pyeti: “O Zot, pse po më vret mua? Pse po më dënon mua?”

Jo! Krishti bërtiti: “Perëndia im, përse më ke braktisur? Përse më ke dorëzuar? Përse më ke lejuar që të largohem?” (Mateu 27:46)

Edhe pse Ai kurrë nuk ishte rebelluar për asnjë çast, Krishti përjetoi pasojën finale të mëkatit. Perëndia e trajtoi Atë sikur Ai të ishte një mëkatar i pashpëtueshëm.

“Ai bëri të jetë mëkat për ne Atë që nuk njihte mëkat,” më vonë shpjegoi Pali. (2 Korintasve 5:21)
Përkthimi i *Revised English Bible* është si vijon: **“Krishti ishte i pastër nga mëkati dhe akoma për të mirën tonë Perëndia e bëri Atë një me mëkatshmërinë njerëzore.”**

Shpesh herë unë kam dëgjuar që kur mëkatarët do të vdesin, Perëndia do të “derdh zemërimin e Tij” mbi ta.

Tek kryqi Perëndia “derdhi zemërimin e Tij” mbi Birin e Tij. Kjo do të thotë që, sipas fjalëve të Palit në letrën drejtuar Romakëve, Perëndia “e dorëzoi Atë,” “e lejoi të largoheshe,” “ia la përgjegjësinë.” Dhe tek Romakët 4:25, Pali pohon që kur Krishti vdiq, Ai në të vërtetë ishte “dorëzuar”— e njehta fjalë greke që Pali e përdor tek Romakët 1:24, 26, 28, për të shpjeguar se çfarë ndodh kur Perëndia shfaq zemërimin e Tij.

Disa nga përkthimet e Romakëve 4:25 thonë që Krishti ishte “dënuar me vdekje.” Në fakt ashtu është – kur Krishti “u dha,” Ai vdiq në të vërtetë. Mund të themi që Ai “u dha” për vdekje. Por origjinali grek thotë vetëm që Ai “u dha,” ose “u dorëzua.” Pali ndoshta qëllimisht e zgjodhi këtë fjalë greke që të na ndihmojë ta kuptojmë se çfarë duhej të na demonstronte vdekja e Krishtit.

Qëllimi i demonstrimit

Në këtë pasazh të paharrueshëm tek letra e Romakëve Pali shpall qëllimin themelor të vdekjes së Krishtit në kryq:

Perëndia e shfaqti Atë duke vdekur publikisht si një mjet pajtimi nga i cili duhet të përfitojmë me anë të besimit. Kjo ishte për të shfaqur drejtësinë e Perëndisë, sepse në tolerancën e Tij hyjnore Ai sikur nuk i vuri re mëkatet e mëparshme të njerëzve. Kjo duhet të demonstronte drejtësinë e Tij në të tashmen, për të treguar që Zoti vet është i drejtë dhe që Ai regullon secilin që beson tek Krishti. (Romakët 3:25,26 Përkthimi i Maxwell-it)

Pali nuk mund të kishte nënvizuar më shumë që qëllimi i kryqit ishte të demonstroj të vërtetën rreth karakterit të Perëndisë, të vërtetën që është baza e miqësisë dhe e besimit tonë.



Pamja e Getsemanit dhe kryqit

Shpesh herë unë e kam imagjinuar veten të pranishëm në atë ditë kur Krishti u kryqëzua. Në fakt, më pëlqen të imagjinoj veten duke shkuar në kopshtin e Getsëmanisë për të vëzhguar Krishtin.

Atje Krishti fillon të përjetoj ndarjen e Tij nga Ati që shkakton “dorëzimin” sikur Ai të ishte një mëkatar. Duke ndarë unitetin e Tij me Atin, agonja dhe vuajtje e Tij janë pothuajse tepër të mëdha për t’u duruar. Marku shkruan që Krishti tha: **“Shpirti im është thellësisht i trishtuar, deri në vdekje.”** (Marku 14:34)

Luka na tregon që një engjëll nga qielli u shfaq dhe e forcoi Krishtin. **“Dhe Ai, duke qenë në agoni, lutej edhe më fort; dhe djersa e Tij po i bëhej si gjak i mpiksur që bie për tokë.”** (Luka 22:43,44)

Edhe engjëjt kanë pyetjet e tyre

A po e ndëshkon Perëndia Birin e Tij? A ka ndërmend që ta vrasë Atë? Engjëjt janë duke vëzhguar. (1 Timoteu 3:16; 1 Pjetrit 1:12) Edhe ata kanë nevojë për të parë përgjigjen e akuzave të Satanait që Perëndia “kishte gënjyer”. Ata ishin duke dëgjuar në kopshtin e Edenit se si Gjarpëri përbuzi paralajmërimin e Zotit që nëse Adami dhe Eva mëkatonin ata kishin për të vdekur. Nëse Perëndia dështonte të tregojë të vërtetën, kjo do të ishte fundi i besimit. Dhe pa besim nuk ka miqësi në familje.

Engjëjt kanë vëzhguar se si armiku gjymtoi kuptimin e këtyre fjalëve të paralajmërimit. Paralajmërimi i pasojës së pashmangshme të mëkatit u bë një kërcënim arbitrar.

Engjëjt kanë vëzhguar efektin e tmerrshëm të gjymtimit të së vërtetës. Ata kanë parë se si ky gjymtim ka helmuar qendrimin e njerëzve ndaj Zotit dhe praktikimit të fesë!

Për mijëra vite njerëzit kanë bërë sakrifica —nganjëherë madje edhe fëmijët e tyre — për të fituar pëlqimin e perëndive të ofenduar. Madje në botën e krishterë disa mesojnë që nëse Krishti nuk kishte bërë sakrificë me qëllim që të qetësohej Ati i zemëruar, ne do të ishim shkatërruar kohë më përpara.

A është e vërtetë që nëse Biri nuk ishte gjatë gjithë kohës duke u lutur për ne, zemra e Atit nuk do të falte dhe nuk do të shëronte fëmijët e Tij? Në sallën e sipërme Krishti korrigjoi në mënyrë të qartë para dishepujve të Tij këtë keqkuptim. (Gjoni 16:26,27)

Tani engjëjt janë duke vëzhguar se si Perëndia At dhe Perëndia Bir së bashku janë duke demonstruar të vërtetën. Ndodhitë që engjëjt dëshmojnë këtu në kopshtin e Getsemanit dhe më vonë në Golgothë, do t'i jap përgjigje pyetjeve të tyre dhe prova që do t'i ruajë besimin dhe miqësinë në familjen e Perëndisë në përjetësi.

Engjëjt e dinë se kush është Krishti. Ai është Krijuesi dhe Perëndia i tyre. Ata vëzhgojnë për të parë se çfarë po ndodh me Atë që e duan dhe adhurojnë. A po ia merr Ati jetën Birit të Tij? Engjëjt dëgjuan shpjegimin e Krishtit ndaj dishepujve të Tij: **“Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja; unë kam pushtet ta lë, e pushtet ta marr përseri; ky është urdhri që kam marrë nga Ati im.”** (Gjoni 10:18)

Engjëjt e dinë që vetëm Perëndia ka një pushtet të tillë. Tani ata vëzhgojnë Krishtin duke rënë në tokë për vdekje.

Pyetjeve u është kthyer përgjigje

A është e vërtetë që mëkati shkakton vdekje?

Po. Jezusi vdiq në vdekjen e cila është “paga e mëkatit”. Perëndia i kishte treguar të vërtetën Adamit dhe Evës.

A e vrau Perëndia Birin i Tij?

Jo! Ai e dorëzoi Atë ashtu siç Ai në fund do të dorëzojë mëkatarët. Është e vërtetë që **“paga e mëkatit është vdekja.”** (Romakët 6:23) Por Perëndia nuk është Ai që paguan. Është mëkati që paguan. **“Mëkati paguan shërbëtorët e tij; dhe paga është vdekja,”** Thotë përkthimi i *Phillips*-it.

Pyetja e tretë

Ne mund të bëjmë një pyetje tjetër: “Pse, o Zot, është aq e rëndësishme për ne ta kuptojmë që Ti nuk je zbatuesi i dënimit? Si Mbreti Sovran i Universit, Ti ke të drejta të ligjshme për të shkatërruar shërbëtorët e pabindur.”

“Pikërisht prandaj,” Zoti mund të na përgjigjej. “Unë nuk dua t’ju trajtoj si shërbëtorët. Unë nuk dua që ju të ngelni vetëm shërbëtorë. Unë dua që të jeni miqtë e Mi.”

“Bijtë e mi në të gjithë Universin,” Perëndia mund të na tregoj, “Unë dua që të kuptoni që bindja që vjen nga frika mund të prodhojë një karakter rebelues. Edhe po të më binden Mua me frikë, ju do të më kundërshtoni. Ju lutem, shkonin në Golgothë dhe shikoni se si kjo demonstron.”

Atje, si edhe në kopshtin e Getsemanës, Jezusi përjeton ndarjen me Atin. “Përse më ke braktisur? Përse më ke dorëzuar?” Ai thërret. Por vini re që Perëndia nuk vë një dorë shkatërruese mbi Birin e Tij.

Në këtë kohë në Golgothë Krishti është torturuar në mënyrën më mizore që armiqtë kishin në dispozicion. Nëse ata kishin mundësi ta digjnin Krishtin me zjarr të ngadaltë, ata do ta kishin zgjedhur atë në vend të kryqit.

Por kush kërkoi që Krishti të ishte trajtuar në këtë mënyrë? —disa nga shërbëtorët më të bindur të Perëndisë. Të paktën ata dukeshin të tillë.

Ata besojnë në Zotin Krijues dhe kanë respekt ndaj autoritetit dhe pushtetit të Tij. Ata besojnë në Shkrimet dhe i lexojnë ato gjatë gjithë kohës. Krishti i lavdëronte ata për këtë. (Gjoni 5:39,40) Ata i pranuan Dhjetë Urdhërimet dhe madje kishin shtuar edhe rregulla shtesë të cilat i ndihmonin ata që t'i bindeshin Zotit deri në detaj. Ata paguanin më shumë se dopion e së dhjetës. Ata hanin vetëm ushqim hallall. Dhe e veçonin veten nga jobesimtarët që të mos fëlliqëshin.

Ata mund të dukeshin si shërbëtorë të bindur, por ata nuk ishin miq të Perëndisë. Të paktën ata nuk janë miqtë e Krishtit dhe ata janë shumë të hutur rreth identitetit të Tij. Ata e akuzuan Krishtin që Ai duhet të ishte i demonizuar meqë e përshkruan Perëndinë në këtë mënyrë. (Gjoni 8)

Tani në emër të Zotit ata kërkojnë që Ai të torturohej deri në vdekje. Ata mendonin që Pronari i tyre hyjnor do të ishte i kënaqur me këtë shërbim besnik që ata po bënin.

Po zjarri i përjetshëm?

Shpesh herë Bibla e përshkruan shkatërrimin e të pabesëve me “një zjarr të përjetshëm.” Jezusi vet foli rreth ditës kur Ai do të jetë i detyruar të tregoj të humburit: **“Largohuni nga unë në zjarr të përjetshëm të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij.”** (Mateu 25:41)



Por çfarë është ky “zjarri i përjetshëm”? Profeti Isaia i përshkruan njerëzit që nuk janë shkatërruar nga “flakët e përjetshme.”

“Kush prej nesh do të mund të banojë me zjarrin gllabërrues? Kush prej nesh do të mund të banojë me flakët e përjetshme?”

Ai që ecën me drejtësi dhe flet drejt, ai që i përçmon fitimet e shtrëmbëra, që lëviz duart për të mos pranuar dhurata, që i mbyll veshët për të mos dëgjuar të flitet për gjak dhe sytë për të mos parë të keqen. (Isaia 33:14,15)

Lavdia që rrethon Perëndinë shpesh herë në Bibël është përshkruar të ketë pamjen e zjarrit. Kur Perëndia zbriti në Malin Sinai, **“pamja e lavdisë së Zotit**

dukej në sytë e bijve të Izraelit si një zjarr që digjej në majën e malit.” (Eksodi 24:17)

Kur Danieli përshkroi vëgimin e Qiellit, ai përshkroi fronin e Zotit si **“flokët e zjarrit dhe rrotat si zjarr përvëlues. Një lumë zjarri rridhte, duke dalë nga prania e Tij.”** (Danieli 7:9,10)

Kur Ezekieli përshkroi vëgimin e Tij të Zotit, ai sërish dhe sërish përdori epitetet e shkëlqimit dhe zjarrit: **“Ajo ishte një shfaqje e shëmbëlltyrës së lavdisë së Zotit.”** (Ezekiel 1:28) Kur ai përshkruan statusin e engjëllit Lucifer para rënies së tij, ai përshkroi atë duke qenë në praninë e Zotit, duke ecur **“në mes gurësh zjarri.”** (Ezekiel 28:14)

Madje kur një mik aq i besueshëm si Moisiu kërkoj që të shikonte lavdinë e Zotit, Perëndia iu përgjigj: **“Asnjë njeri nuk mund të më shikojë dhe të jetojë.”** (Eksodi 33:20) Megjithatë kur Moisiu erdhi pas bisedës me Zotin, fytyra e tij pasqyrore aq shumë lavdi hyjnore sa ai ishte detyruar të vishte një vello sipas kërkesës së njerëzve. (Eksodi 34:29-35)

Kur Perëndia tha që asnjë prej njerëzve të vdekshëm nuk mund të shikoj fytyrën e Tij dhe të jetoj, Ai nuk ishte duke kërcënuar që do të vriste çdo njeri i cili ishte kapur duke shikuar vjedhurazi. Për njerëzit, në statusin e tyre mëkatore, lavdia e Perëndisë do të ishte si zjarri konsumues.

Mëkati ndryshon mëkatarin aq shumë sa në fakt shkakton vdekjen e tij. Duke qenë jashtë harmonisë me Krijuesin, mëkatori nuk mund të duroj lavdinë jetë-dhenëse të pranisë së Tij.

Si atëherë Zoti mund të shpëtojë mëkatarët? Si mund t’u afroheshe Ai mjaft afër që të ishte e mundur të fitoj sërish besimin e tyre? Si mund t’u tregoheshe atyre që Ai është Miku nga i cili nuk ka pse të kenë frikë?

Përgjigjja e Zotit ishte që të dërgoj Birin e Tij me trup njerëzor. Edhe pse Krishti vet është **“shkëlqimi i lavdisë së Perëndisë,”** (Hebrenjve 1:3) Ai **“e zbraz veten e Tij . . . e u bë i ngjajshëm me njerëzit.”** (Filipianëve 2:7) Ai mbuloi shkëlqimin e lavdisë hyjnore të Tij me trupin njerëzor kështu që njerëzit mund të njohin Perëndinë pa rrezikun e të qënurit të konsumuar.

Një ditë Perëndia do të heq mbulesën nga lavdia e Tij. Ai dëshiron të kthejë botën në gjendje normale, ashtu siç ajo ka qenë në fillim. Në kopshin Edenit, Perëndia mund të ecte duke biseduar me prindërit tanë të parë pa asnjë mbulesë ndërmjetëse. (Zanafilla 3:8-10)

Por nga atë çast kur mëkati filloi ndryshimet vdekjeprurëse, Perëndia i hirshëm e mbuloi lavdinë e Tij. Siç shpjegon Pjetri, Ati ynë Qiellor është shumë i durueshëm ndaj nesh **“sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim.”** (2 e Pjetrit 3:9)

Pendim do të thotë ndryshimi i mendjes sonë. Perëndia i hirshëm vazhdon të na dhuroj kohën dhe shansin për të marr parasysh provat. Nëse ne e marrim vendim që Ai është i besueshëm dhe vazhdojmë ta besojmë në mënyrë

që të qëndrojmë me Të dhe të lejojmë Atë të na shërojë nga ajo që na ka bërë mëkati do vijë koha kur sërish do të jemi të aftë të jetojmë në këtë lavdi.



Moisiu dhe Elija ishin të shëruar ose ata nuk mundeshin të qendronin pranë Krishtit në Malin e Shpërftyrimit. Në atë ditë të paharrueshme dy ish-mëkatarët qendruan në lavdinë e zbuluar të Zotit.

Por kur Perëndia do të zbuloj lavdinë e Tij në fundin e botës, gjithçka që do të jetë jashtë harmonisë me Të do të konsumohet. Në atë ditë të mrekullueshme të shpëtuarit dhe të humburit do të qëndrojnë në “zjarrin gllabërrues,” dhe në “flakët e përjetshme,” të lavdisë së Zotit.

Pse të humburit do të jenë të vetmit që do të konsumohen? Nuk ka asgjë arbitrare në këtë. Nuk ka asnjë lidhje me jurisprudencën. Perëndia nuk do të jap urdhër: “Digjini këta, mbani ata!” Dallimi do të jetë në ne.

Kur Perëndia do të shikoj fëmijët e Tij rebel të panumërt duke vdekur, Ai do të qajë si në librin e profetit Oseas: **“Si mund të dorëzoj! Si mund të lejoj të largohesh!”**

Ndërsa Perëndia është duke qarë për humbjen e fëmijëve të Tij, unë nuk imagjinoj dot që ndonjëri prej të shpëtuarve do të festoj me gëzim këtë ndodhi siç e kam dëgjuar nga disa veta që do të bënin.

Unë i shikoj ata duke e rrethuar Atin ashtu siç Pjetri, Jakobi dhe Gjoni rrethonin Krishtin kur Ai vuajti në kopshtin e Gjetsemanës. Ndoshta Gjoni – ai që kishte vëzhguar Krishtin duke vdekur – do të thoshte: “Mos qaj, o Zot. Nuk ka asgjë më shumë që mund të kishe bërë.”

Paga e përgjigjeve

Mendoni – sa i kushtonte Atit, Birit dhe Frymës së Vërtetës t’u përgjigjej pyetjeve themelore – jo vetëm për të shpallur përgjigjet por edhe për të demonstruar të vërtetën.

Demonstrimi ishte aq i dhimbshëm që pa tjetër vetëm Miku më i mirë do të dëshironte të na e shfaqte atë. Dhe për shkakun që i vetmi që ishte i aftë për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve ishte vet Perëndia, vetëm Miku më i mirë mund të na tregonte këtë.

Fuqia e kryqit për të fituar miqtë

Kujtoni aktoren që tha: “Perënditë e feve të tjera janë më pak mizorë sesa Perëndia i Dhjatës së Vjetër!”

Një aktor tjetër qendronte pranë asaj. Ai nuk debatoi me atë sepse e kuptonte se çfarë e kishte drejtuar atë tek kjo pikpamje. Por ai shpalli që beson tek Perëndia. Në fakt, ai na tha, që ishte i krishter.

“Si u bërë besimtar?” e pyeta.

“Epo, nuk kam qenë i tillë gjithë jetën time,” mu përgjigj ai. “Kjo ndodhi në kohët e fundit. Dikush më dhuroi Ungjillin sipas Gjonit.”

“Çfarë lexove atje që të frymëzoi që të bëheshe i krishter?”

“Historia e kryqit,” mu përgjigj ai pa hezitim. “Ajo mënyrë se si Krishti sillej në kryq. Imagjino një Person aq të mirë të jetë të varur atje. Jezusi gjatë gjithë jetës së Tij kurrë nuk kishte bërë asgjë të keqe, kurrë nuk kishte lënduar njëri. Por ata e torturuan Atë deri në vdekje. Dhe ndërsa ata ishin duke e torturuar Krishtin, Ai tha që i falte ata. Dhe Ai tha që Ati është si Ai. Në Krishtin ishte diçka që më bënte të dëshiroja që të besoja në Atë. Dhe nëse Perëndia është si Krishti, unë pa tjetër do të besoj tek Ai. Kjo ishte ajo gjë që më frymëzoi të bëhesha i krishter.”

K

11. LIRIA E MIQËSISË

a lloj-llojë lirish që ne përfitojmë duke patur miqësinë që Krishti përshkruan tek Gjoni 15:15.

Ne jemi të lirë nga tirani, nga autoriteti arbitrar. Ne mund të bëjmë pyetje. Perëndia do që ne ta kuptojmë.

Ne jemi të lirë të flasim haptas dhe në mënyrë të qartë ashtu siç bënë Jobi dhe Davidi. Kur Davidi foli me Zotin, ai ishte shumë i çiltër rreth temës së bisedës. Nëse ai urrentë dikë, ai nuk u përpoq ta fshehtë këtë me “fjala të errta”. Nëse ai deshte të merrte hak ndaj armiqvë të tij, ai haptas kërkonte shkatërrimin e tyre.

“Me siguri, Ti do të vrasësh të pabesin, o Perëndi,” ai lut tek Psalmi 139:19.

Pastaj ai shtoi:

Më heto, o Perëndi, dhe njihe zemrën time; më provo dhe njihi mendimet e mia, dhe shiko në se ka tek unë ndonjë rrugë të keqe dhe më udhëheq nëpër rrugën e përjetshme. (vargjet 23, 24)

Davidi e dinte që Perëndia donte që ai të ishte i sinqert deri në detaj në marrëdhënien e tyre. Davidi jo gjithmonë kishte qënë kështu. Prandaj ai i lut tek Psalm 51:

“Por ty të pëlqen e vërteta që qëndron në thelb, dhe më mëson diturinë në sekretin e zemrës. . . . O Perëndi, krijo tek unë një zemër të pastër dhe përtëri tek unë një frymë të patundur (të drejtë).”

Liri nga frika

Të jesh një prej miqve të mirëkuptueshëm të Perëndisë do të thotë të mos kesh frikë nga vet Zoti. Është e qartë që nuk ke pse të kesh frikë nga Perëndia i cili do që ne të jemi miqtë e Tij. Ai kurrë nuk na ka kërcënuar: “Ji miku im ndryshe të ngordha.”

Madje kur do të përballemi me gjyqin, ne nuk duhet të kemi frikë. Kjo nuk është për shkakun që ne kemi një Mik ndërmjet nesh dhe Perëndisë së shenjtë. Zoti vet është Miku jonë.

Kjo liri nga frika mund të jetë e kontrolluar në atë çast kur do të takojmë Perëndinë ballë për ballë. Si mendoni – si do të ndiheni kur do të vini aq afër Perëndisë? Moisiu ishte aq i tronditur me respekt të madhë kur Perëndia zbriti në Mali Sinai sa ai tha: “Unë jam i frikësuar dhe dridhëm i tëri.” (Hebrenjve12:21) Por shumë shpëjt ai ishte i aftë t’i siguronte njerëzit që ata nuk kanë arsye për të patur frikë.

A do të zgjatë kjo liri nga frika në përjetësi? Si do të jetë kjo – të jetosh në praninë e Perëndisë i cili di gjithçka rreth nesh —gjithçka! A do të na përndjek Ai me kujtimet e të kaluarës sonë plotë mëkat?

Si e trajtoi Krishti gruan që shkeli kurorën dhe paditësit e saj

Për të gjetur përgjigjen ne vetëm duhet të vëzhgojmë se si Jezusi trajtoi mëkatarë të ndryshëm. Një prej shembuj më dramatik është historia e gruas që ishte kapur duke shkelur kurorën. Në përkthimin e *New International Version*, historia është si vijon:

“Si zbardhi dita [Jezusi] u kthye përsëri në tempull dhe gjithë populli edhi tek Ai; dhe Ai u ul dhe i mësonte. Atëherë farisenjtë dhe skribët i prunë një grua që ishte kapur duke shkelur kurorën dhe, mbasi e vunë në mes, i thanë Jezusit: “Mësues, kjo grua është kapur në flagrancë, duke shkelur kurorën. Por në ligj Moisiu na ka urdhëruar të vriten me gurë gra të tilla, por ti ç’thua?”

Ata ishin duke përdorur këtë pyetje si një kurth për të pasur diçka për ta paditur. Por Jezusi u përkul dhe shkruante me gisht në dhe. Dhe, kur ata vazhdonin ta pyesnin, Ai u drejtua dhe u tha atyre: “Kush nga ju është pa mëkat, le ta hedhë i pari gurin kundër saj!”. Pastaj u përkul përsëri dhe shkruante në dhe. Atëherë ata, e dëgjuan këtë dhe u larguan një nga një, duke filluar nga më të vjetrit e deri te të fundit; kështu Jezusi mbeti vetëm me atë grua, që qendronte atje në mes.

Jezusi atëherë u ngrit dhe i tha: “O grua, ku janë ata që të paditnin? Askush nuk të dënoi?” Dhe ajo u përgjigj: “Askush, Zot.” Atëherë Jezusi i tha: As unë nuk të dënoj; shko tani dhe largohu nga jeta e mëkatit.” (Gjoni 8:2-11)



Është e qartë që të krishterët e parë nuk e kuptuan se çfarë të bënin me këtë histori sepse ajo shfaqet në vende të ndryshme të dorëshkrimeve dhe nganjëherë nuk është përfshirë fare. Megjithatë shumë studiues janë dakort që kjo histori i përket Biblës. Nuk besohet që një histori e tillë do të ishte sajuar në ditët e Krishtit ose trilluar nga një murg tipik që kopjoi dorëshkrimet më vonë.

Studiues i shquar të Princeton-it Bruce Metzger, në librin e tij *The Text of the New Testament*, bie dakort që “historia . . . ka çdo shenjë të origjinës historike; asnjë murg asketik nuk do të trillonte një dialog që mbaronte vetëm me një qortim të butë nga ana e Krishtit.”

Disa udhëheqës fetarë e sollën këtë grua të shkretë në një përpjekje tjetër për të vënë Krishtin në kurth. Çdo përpjekje për ta kapur Atë në një grackë, Jezusi e përballoi me një aftësi dhe hir hyjnor.

Këtë rast për të siguruar mbeshtetjen e turmës, armiqtë e Krishtit bërën të sigurt që të merrnin prova të nevojshme. Para syvë të të gjithë turmës rreth tyre ata shpallin që “kjo grua është kapur në flagrancë, duke shkelur kurorën.”

Pas kësaj ata bënin pyetjen e tyre: “Ti e di se çfarë na mëson Moisiu rreth rasteve të tilla. Ti e di ligjin se çfarë duhet të bëhet me një grua të tillë. A bie Ti dakort që ajo duhet të jetë vvarë me gurë?” Publiku vëzhgoi me vëmendje se çfarë do të thoshte Jezusi.

Por Ai nuk tha gjë. Ai thjeshtë u përkul dhe filloi të shkruaj me gisht në pluhur. Një fllad i erës, disa gjurma dhe shkrimi do të zhdukeshe. Përgjigjja e Tij ishte ndërgjegj-vrasese: **“Kush nga ju është pa mëkat, le ta hedhë i pari gurin kundër saj .”**

Pse Jezusi nuk e tërhoqi gjithë turmën më afër duke thënë, “Më lejoni t’ju tregoj disa gjëra rreth paditësit të kësaj gruaje të gjorë.” A nuk e meritonin ata një poshtërim të tillë? Çfarë na tregon kjo rreth Zotit kur Biri i Tij nuk turpëroi publikisht këta burra fetar të vetëkënaqur?

Kjo është ajo se për çfarë Krishti erdhi për të na zbuluar. Zoti nuk gjen asnjë kënaqësi në turpin tonë kur mëkatet tona janë bërë publike.

Kur ata të gjithë ishin larguar Krishti u kthye tek gruaja dhe i tha me butësi: “As unë nuk të dënoj. Shko në shtëpi dhe mos mëkato më.” Me mirësjellje Ai përpoqi t’i rikrijojë kësaj gruaje të turpëruar respektin ndaj vetvetes.

Si e trajtoi Krishti Simonin

Simoni, një burr i pasur të cilin Krishti e kishte shëruar nga lebroza e ftoi Atë dhe miq të tjerë në shtëpinë e tij për një gosti. Tre nga miqtë më të afërm të Krishtit gjithashtu ishin të pranishëm: Llazari dhe motrat e tij – Marta dhe Maria. Maria është përshkruar nga Luka si “një grua e cila kishte jetuar një jetë amorale në qytet.” (Luke 7:37 perkthimi anglez)

Ndërsa ata ishin shtrirë mbrapa tavolinës, Maria kishte blerë një parfum shumë të shtrenjtë dhe i vajosi këmbët e Krishtit duke i fshirë ata me flokët e saj. Simonin e vëzhgoi këtë me një mosmiratim duke menduar në vetvete: **“Nëse ky njeri po të ishte profet, Ai do të dinte se çfarë lloj njeriu është ajo që po e prek Atë – sepse ajo është një mëkatare.”**

“Krishti u përgjigj: ‘Simon, kam diçka për të të thënë.’”

“‘Po, Mësues, fol,’ i tha ai.” (Luke 7:39,40)

Atëherë Krishti i tregoi një histori rreth dy huamarrësëve, të cilët ishin falur. Gjatë tregimit Simonin e kuptoi që Krishti kishte lexuar mendimet e tij. Ai filloi ta shikojë vetveten si një mëkatar më të keq sesa gruaja të cilën ai e kishte përçmuar, dhe tani ai filloi të mendoj, a do ta turpëronte Krishti atë para miqve të tij?

Asgjë nuk është më ofenduese për Zotin sesa një akuzë nga një njeri i cili jep të drejtë vetes. Por a e turpëroi Ai Simonin? A u tha Ai miqve të gostitjes: “Më lejoni t’ju tregoj diçka rreth zotit të shtëpisë?”

Në vënd të kësaj Zoti si gjithmonë bëri një gjë zemërbardhë. Ai me mirësjelljen e pranoi veprën spontane të Marisë. Dhe me të njejtin hir Ai korrigjoi Simonin pa e turpëruar atë para miqve të tij. Besoj, Simoni ishte prekur thellësisht nga kjo!

I paralizuari i Betesdës

Kur Jezusi takoi të paralizuarin tek pellgu i Betesdës, Ai nuk e turpëroi ose ndëshkoi atë për shkakun që ai nuk kishte patur një stil jetese të shëndetshëm gjatë rinisë. Ai thjeshtë e pyeti me mirësi: **“A dëshiron të bëhesh mirë? Atëherë mere vigun tënd dhe shko në shtëpi.”**

Më vonë Krishti e takoi atë prapë dhe i tha: **“Ti e di se çfarë e shkaktoi problemin tënd. Shko dhe mos mëkato më, që të mos të të bëhet një gjë më e keqe.”** (Gjoni 5:1-15)

Dishepujt me një sjellje të keqe

Imagjinoni Krishtin në sallën e sipërme atë natë para kryqëzimit, kur që të dymbëdhjetë dishepujt po grindeshin me njëri-tjetrin si fëmijë, “se cili nga ata duhej të konsiderohej më i madhi.” (Luka 22:24)



A i qortoi Krishti ata për budallëlliqet e tyre ose bërtiti për mosdashjen e larjeve të këmbëve të njëri-tjetrit? Në vënd të kësaj Ai u ngrit vet, mori peshqirin dhe legenin, dhe gjithë Universi vëzhgoi se si Krijuesi i madh gjunjëzohej për të larë dymbëdhjetë palë këmbë të pista. Ai madje lau këmbët e tradhëtarit të Tij - Juda.

Çfarë shansi të shkëlqyer humbën dishepujt – për të larë këmbët e Shpëtimtarit natën para vdekjes së Tij! Ah sikur një prej tyre të kishte dalë vullnetarisht: “O Zot, a mund të lajë këmbët e Tua?” çfarë përjetim të bukur ai do të fitonte për gjithë përgjeshin!

Por doli që Jezusi ishte i vetmi Person në atë dhomë atë natë i cili darkoi me këmbë të palara. Interesante se si ndiheshin engjëjt të cilët e vëzhguan këtë?

Imagjinoni përshtypjen e dishepujve ndërsa ata me radhë shikuan se si Krishti me duart e Tij të forta lau këmbët e tyre.

Jezusi mund t'i kishte parë ata në sy duke i thënë: “Ju nuk besoni që Ati im do të bëntë të njejtë gjë për ju, apo jo? Por nëse më keni parë Mua, ju keni parë Atin. Ati ju do aq shumë sa Unë. Nëse ndiheni rehat me Mua, do të jeni rehat edhe me Të.”

Juda

Më vonë Jezus shpalli që një prej tyre do ta tradhtojë Atë. Por Ai nuk ua dha emrin për ta turpëruar para gjithë grupit. Kur Ai i tha Judës të shkojë dhe ta bëjë shpejtë këtë gjë të tmerrshme, dishepujt e tjerë menduan që ai u dërgua për të blerë ushqime ose madje për të bërë bamirësi për të varfërit.

Pse Jezusi nuk e poshtëroi tradhëtarin e Tij para syve të të gjithëve? Pa dyshim ai e meritonte këtë. Mendoni pak se çfarë na tregon kjo gjë rreth Zotit nëse Jezusi nuk turpëroi tradhëtarin e Vet!

Pjetri, Jakobi dhe Gjoni

Më vonë atë natë në kopshtin e Gjetsemanit Jezusi e mori Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin më thellë në kopësht dhe filloi eksperiencën e Tij të tmerrshme të ndarjes nga Ati i Tij. Tre herë Ai erdhi tek dishepujt e përgjumur duke shpresuar të gjente ndonjë ngushëllim dhe inkurajim në agoninë e Tij.

Çfarë shans të mrekullueshëm humbën dishepujt – për të inkurajuar Birin e Perëndisë! Ah sikur të tre do t'i ishin afruar Krishtit dhe gjunjëzuar me Të gjatë lutjes së Tij? A nuk është kjo një gjë që miqtë e vërtetë duhet ta bëjnë? Çfarë kujtime të çmuara do të kishin këto tre burra! Por ata fjetën gjumë të rëndë, dhe Jezusi nuk i qortoi fare ata. Atij i dhimbsej që ata ishin tepër të lodhur për ta ndihmuar.

Pjetri

Pas disa orësh Pjetri shante duke u betuar për të provuar që ai nuk ishte dishepulli i Krishtit. Ai as nuk e njihte Atë!

Pastaj gjeli këndoi siç kishte parashikuar Krishti pas fjalëve guximtare të Pjetrit: që, edhe pse të gjithë do ta braktisin Krishtin, ai do të jepte jetën e tij për Atë.

Kur Pjetri dëgjoi gjelin, ai vështroi sytë tek Krishti për të parë nëse Ai e kishte vënë re. Edhe pse Krishti ishte në gjyq dhe tashme kishte vuajtur shumë, Ai merakosej më shumë për dishepullin e Tij mëkatar në oborr. Ai e pa Pjetrin në sy.

Sipas pikpamjës së Pjetrit ndaj Zotit, ai ndoshta priste zemërim dhe inat në fytyrën e Krishtit. Dhe ai sigurisht e meritonte! Por në vend të kësaj ai pa trishtim, zhgënjim dhe keqardhje – në fytyrën e Tij i cili natën e kaluar kishte larë këmbët e tij të pista.

Pjetri doli përjashta dhe qau me hidhërim. (Luka 22:54-62)

Pak më vonë Juda erdhi në gjykatë dhe hodhi në tokë tridhjetë monedha prej argjendi dhe rrefeu që ai kishte tradhëtuar gjak të pafajshëm. Atë çast ai gjithashtu vështroi sytë tek Krishti. Dhe ai pa të njejtën keqardhje dhe trishtim i cili kishte prekur zemrën e Pjetrit – fytyrën e Atij i cili një natë më përpara ishte gjunjëzuar për të larë këmbët e tij të pista. I prekur thellësisht Juda u largua dhe vari veten me litar. (Mateu 27:3-5)

Ah sikur Juda të kishte reaguar si Pjetri ndaj shikimit të Krishtit! Sikur Juda të kishte takuar Pjetrin i cili po qante dhe të dy dishepujt të ishin gjunjëzuar së bashku dhe të përjetonin rilindjen shpirtërore – çfarë skenë dramatike do të ishte për gjithë Universin për ta parë!

Imagjinoni si u ndje Pjetri atë të shtunë. Çfarë budallai kishte qënë ai gjatë 24 orëve të kaluara! Dy herë ai kishte folur vrullsisht në sallën e sipërme. Dy herë ai kishte turpëruar vetveten në kopshtin e Getsemanisë. Dhe gjatë gjykimit të Krishti ai ishte sjellë si një tradhëtar dhe frikacak! Tani Krishti kishte vdekur dhe nuk ishte asnjë mënyrë për të korrigjuar gabimet.

Nuk ka asnjë çudi që ai iku me vrap tek varri të dielën kur e mori vesh që varri ishte bosh.

Maria

Megjithatë pikërisht Maria ishte privilegjuar për të parë Krishtin e para dhe për ta sjellë këtë lajm të mirë dishepujve të tjerë. Nga të gjithë njerëzit pikërisht Maria – gruaja e cila kishte aq shumë probleme dhe dobësi! (Luka 8:2) Por Zoti zgjodhi pikërisht Marinë për këtë privilegj. Mendoni pak se çfarë na tregon kjo rreth Zotit nëse Maria ishte zgjedhur për këtë nder të madh.

Kur Maria e njohu Krishtin i cili qëndronte jashtë varrit, ajo ra tek këmbët e Tij për ta adhuruar. Dhe Jezusi i tha me butësi: **“Mos më prek tani, sepse ende nuk u ngjita te Ati im. Por shko tek vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre se unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj.”** (Gjoni 20:17)

Dëgjoni – Krishti i quajti vëllezër dishepujt e tij —burra të cilët e kishin zhgënjyer në çastin kur Ai kishte më shumë nevojë për ata!

Kur engjëjt konfirmuan urdhërin e Krishtit Marisë që ajo duhet të lajmërojë dishepujt rreth kësaj ndodhie, ata thonin: “Shko dhe thuaj dishepujve të tjerë, dhe veçanërisht Pjetrit që Jezusi është ringjallur dhe do t’i takojë ata në Galile.” (Marku 16:7; *shih edhe* Gjoni 20:19)

Sa bukur engjëjt shfaqin karakterin e Zotit duke shtuar: “sidomos thojini Pjetrit”! Engjëjt e admirojnë dhe adhurojnë Zotin për mënyrën se si Ai i trajton mëkatarët. Me sa qejfë ata kanë shtuar tek mesazhi: “Thojini Pjetrit”!

Ky është Zoti ynë me të cilën dua të kaloj përjetësinë. Prandaj edhe pse ne të gjithë kemi mëkatur, ne do të jemi rehat në prezencën e Tij, i cili na njeh ne aq mirë.

Ne s’kemi asnjë arsye për të patur frikë nga kujtesa e pafund e Zotit. Dëshira e Tij për të na falur nuk ka limit. Dhe Ai ka premtuar jo vetëm të na fal por të na trajtojë sikur ne kurrë nuk kishim mëkatur. **Ti... i ke hedhur prapa krahëve të tua të tëra mëkatet e mia. (Isaia 38:17) Ti do të hedhësh në fund të detit tërë mëkatet tona. (Mikea 7:19)**

Zoti nuk harron asgjë. Ai e di shumë mirë se si kemi jetuar. Edhe ne e dimë se çfarë mëkatarësh kemi qënë. Engjëjt i kanë vëzhguar të gjitha veprat tona. Por pavarësisht nga kjo Ati ynë Qiellor do të na trajtojë me dinjitet dhe respekt sikur ne gjithmonë të kishim qënë bijtë e Tij besnik.

A është ky vetëm një premtim ose Zoti në të vërtetë e ka shfaqur vullnetin e Tij të trajtojë ish-mëkatarët në këtë mënyrë? Pasi vdiq Mbreti David, Zoti foli me birin e tij Solomonin rreth atit të tij të famshëm.

Dhe Zoti i tha, **“Në rast se ti ecën në rrugët e mia duke iu bindur statutet dhe urdhërimet e mia, ashtu si bëri Davidi, ati yt, unë kam për t’i zgjatur ditët e tua.”** (1 Mbretërve 3:14) Por Davidi kishte bërë disa mëkate të rënda. Si mund ta kishte përshkruar Zoti Davidin duke mbajtur të gjitha urdhërimet e Tij?

Diçka kishte ndodhur me Davidin pas këtyre mëkateve. Ai kishte kuptuar që Zoti do sinqeritetin nga njeriu ynë i brendshëm. Kështu ai i kërkoi Zotit të kontrollojë zemrën e tij dhe të pastroj vendin me të cilën njeriu mendon. Duke iu përgjigjur lutjes së tij Zoti i dha një zemër të re dhe një frymë të drejtë. Dhe sërish Zoti kishte mundësi për të thënë që Davidi është **“njeri sipas zemrës sime.”** (Veprat 13:22. Krahasoni me 1 Samuelit 13:14)

Është e qartë që Zoti e ka seriozisht kur thotë që do të hedh mëkatet tona mbrapa krahëve të Tij. Në Mbretërinë Qiellore, nëse ne do të hyjmë atje, Zoti do të flas me njerëzit e tjerë rreth nesh sikur ne të kishim qënë gjithmonë miqtë e Tij besnikë. Dhe për të siguruar që ndihemi rehat, Zoti nuk do të lejojë asnjë thashëthem! (Romakët 1:29)

A do të jemi ne më rehat në praninë e Birit?

A preferoni të takoni së pari Atin apo Birin kur do të vini në Mbretërinë Qiellore? Unë kam pyetur për këtë gjë qindra njerëz. Shumica prej tyre më thanë që ndoshta ata do të preferonte të takonin në fillim Birin sesa Atin.

Por sikur ju të takoni në të vërtetë Krishtin së pari? Dhe pak më vonë Ai ju pyet a jeni gati për të takuar Atin.

A do të thoni: “Po, nëse Ti do të vish me mua”?

Tani ju qendroni me Krishtin para Atit të Lavdishëm. Koka jote është ulur dhe ti po vëzhgon dyshtemenë.

Por ti dëgjon një zë të ngrohtë duke thënë: “Mund të më shikosh në fytyrë, po deshe.”

Ti ngre kokën dhe shikon një fytyrë të dashur ashtu siç e ka edhe Biri. Ti fillon të kërkosh falje: “Më fal, o Zot, që pata frikë nga Ty. Në fakt Jezusi *ka thënë*: që ne nëse kemi parë Atë (Jezusin), të kemi parë edhe Ty. Ai na tha që Ti na do aq sa na do edhe Ai, dhe që Ti dëshiron që të jemi miqtë e Tu.”

“Nuk ka gjë,” thotë zëri i dashur. “Tani ti e di të vërtetën. Tani, a mund të jemi miq?”

“Nuk kam frikë nga vdekja”

Para disa vitesh unë varrosa një mik të ngushtë i cili ishte ish-studenti im. Ai kishte qënë oficeri i forcës ajrore dhe kishte udhëhequr më shumë se 50 sulme mbi Europë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kur lufta mbaroi, ai erdhi për të studjuar Dhjatën e Re në greqishtën e vjetër, duke u përgatitur për punën e pastorit. Ai ishte një student i shkëlqyeshëm. Shpesh herë ne biseduam rreth pikpamjes sonë ndaj Zotit.

Tridhjetë e pesë vitet e ardhshme ai shërbeu si një pastor i dashur. Ai vdiq nga kanceri. Kur e vizitova në spital, ai e mori dorën time dhe më tha me zë të ulët:

“E di, Grejëm, unë nuk kam frikë nga vdekja. Dhe ti e di arsyen. Ne kemi të njëjtën pikëpamje ndaj Zotit.”

12. MIQËSIA DHE LUFTA ME MËKATIN

P

ali siguroi besimtarët në Romë që për shkakun se jemi **“të shfajësuar me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë.”** (Romakëve 5:1)

Pyetja kryesore në këtë varg është: Çfarë do të thotë të jesh i “shfajësuar”? Fjala greke që përdor Pali në thelb ka kuptim të rregullojë diçka. The *Good News Bible* e përkthen këtë varg si vijon: **“Tani që ne nëpërmjet besimit jemi në rregull me Zotin, ne jemi në paqe me Atë.”**

Besimtarët-shërbëtorë e kuptojnë që ajo që duhet të rregullojnë midis atyre dhe Padronit të tyre të ofenduar është kryesisht një çështje juridike. Zgjidhja e këtij problemi, siç e kuptojnë ata, është falja dhe rregullimi i gjëndjes së tyre juridike. Ata e përdorin fjalën “shfajësim” me nënkuptimin e faljes dhe shpalljes që tani ata janë ligjerisht në rregull me Zotin. Ata thonë që kjo sjell paqe me Zotin, sepse tani ata nuk kanë më nevojë të kenë frikë nga zemërimi i Tij, ose nga ndëshkimi, ose të humbasin shpërblimin.

Por falja vet nuk jep paqe të vërtetë. Mos ju ka ndodhur në jetë që dikush ju ka falur për sjelljen tuaj të pahijshme, por pastaj nga turpi ju filluat ta shmangni atë person i cili ju ka falur? Zoti nuk do që ne, pasi jemi “të shfajësuar me anë të besimit,” të fillojmë ta shmangim Atë për shkakun e turpit. Ai do që të jemi miq të ngushtë.

Besimtarët-miq kanë një tjetër këndvështrim ndaj shfajësimit. Ata besojnë që problemi kryesor në jetët tona është çarja e besimit dhe e besueshmërisë. Prandaj për të rregulluar këtë gjë, ne duhet të restaurojmë besimin. Të rregullosh marrëdhënien me Zotin do të thotë ta besosh Atë dhe të jesh miku i Tij i besueshëm. Kjo patjetër do të thotë paqe. Pali vendos besimin, paqen, dhe marrëdhënien në rregull me Zotin, të gjitha së bashku në këtë varg. Dhe kjo ka kuptim për miqtë.

Por pse kemi luftë shpirtërore?

Apostulli Pal kishte shijuar paqen me Zotin për një kohë të gjatë. Megjithatë ai nuk kishte paqe me vetveten. Ai e pranoi këtë gjë duke u shkruar besimtarëve në Romë:

“Në fakt të mirën që unë e dua nuk e bëj; por të keqen që s'dua, atë bëj. Oh, njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga ky trup i vdekjes? (Romakëve 7:19,24)

Pali përpiqet të shpjegojë konfliktin e tij.

“E kam dëshirën për të bërë të mirën, por nuk ia gjej mënyrën. ...Unë, pra, po zbuloj këtë ligj: duke dashur të bëj të mirën, e keqja gjindet në mua. Në fakt unë gjej kënaqësi në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm, por shoh një ligj tjetër në gjymtyrët e mia, që lufton kundër ligjit të mendjes sime dhe që më bën skllav të ligjit të mëkatit që është në gjymtyrët e mia.” (Romakëve 7:18, 21-23)

“Një njeri i cili flet kështu nuk mund të jetë i konvertuar,” thonë disa besimtarë. Por shumë besimtarë të sinqertë kanë zbuluar nga përvojat e tyre personale që lufta e Palit mund të vazhdojë gjatë gjithë jetës së tyre. Patjetër, pavarësisht nga ajo, kur jeni në këtë luftë, zgjidhja mbetet e njëjtë: **“I falem nderit Perëndisë me anë të Jezu Krishtit, Zotit tonë!” (Romakëve 7:25)**

Fjala greke për “mjerë” mund të përfshijë edhe kuptimin “i lodhur nga punë të rëndë.” Pali duket si një shenjtor i cili përpiqet shumë, por lodhet nga mundime të vazhdueshme.

Duket që Pali po përshkruan kalimin nga një luftë e një shërbëtori në një luftë të një miku të kuptueshëm.

Edhe përpara se Pali të bëhej i krishterë, ai kishte qënë i devotshëm plotësisht ndaj Dhjetë Urdhërimeve. Ai u përmendi filipianëve që në zbatimin e ligjit ai ishte një “farisë,” që do të thotë që ai ishte i bindur deri në detaje. **“Sipas standartit të drejtësisë së ligjit,”** Pali pohonte që ai ishte **“i paqortueshëm.”** (Filipianëve 3:5,6)

Ai nuk kishte vjedhur gjë. Ai nuk kishte shkelur kurorën. Ai nuk kishte vrrarë njëri. Sipas kuptimit të tij në atë kohë, ajo çfarë ai i bëri Stefanit nuk ishte vrasje. Ajo ishte vetëm zbatimi i vullnetit të Zotit duke pastruar popullin nga herezitë. Ai madje gjithmonë kishte qënë besnik duke paguar të dhjetën. Në fakt, ai kishte mbajtur çdo rregull që dinte.

Por pasi Pali takoi Krishtin në rrugën për në Damask, ai filloi të hulumtojë Urdhërimet në imtësi. Ai dëgjoi që Krishti kishte mësuar që Zoti nuk dëshiron mbajtjen e jashtme dhe sipërfaqësore të ligjeve. Ajo është bindje që vjen nga shërbëtorët. Zoti shpreson që do të kuptojmë që Dhjetë Urdhërimet nuk janë fare arbitrare. Ato na përshkruajnë sjelljen e njerëzve të dashur, miqësor dhe të besueshëm, të cilët jo vetëm nuk vrasin por as nuk mbajnë inat. Ata jo vetëm nuk shkelin kurorën por as nuk kanë dëshirë për ta bërë këtë.

Pali më në fund e kuptoi që madje Moisiu kishte mësuar të njëjtën gjë. Kur Moisiu tha popullit të Izraelit që ata duhet të duanin të afërmit të tyre porsì vetveten, ai shtoi: **“Nuk do të urresh.”** (Levitiku 19:17)

Pali i kushtoi vëmendje të veçantë Urdhërimit të dhjetë. (Disa të krishterë e ndajnë urdhërimin rreth lakmisë në urdhërimet 9 dhe 10) Në dritën e mësimave të Moisiut dhe Jezusit, ai e kuptoi që **“Nuk do të dëshirosh”** përfshin edhe dëshirën për çdo gjë që është e keqe.

Kur Pali e kuptoi thellësinë e këtij Urdhërimi, ai, sipas rrëfimit e tij, u inatos. Ai ishte munduar aq shumë. Ndonjëherë ai madje kishte dëshiruar të shkelte njërin prej Dhjetë Urdhërimeve, por ai u kishte rezistuar me sukses këtyre tundimeve. A nuk e meritonte ai nderim për mosdorëzimin? **“Dhe a nuk e meritoj një nderim ekstra,”** mund të ketë menduar Pali, **“që në rininë time u kam rezistuar tundimeve më shumë sesa njerëzit e tjerë?”**

Por më vonë, acarimi i Palit ndaj urdhërimit “mos lakmo” u shndërrua në pajtim dhe admirim. T’i bindesh urdhërimit të dhjetë në fakt është çelës për t’i bindur të gjithë urdhërimeve të tjera. Të arrish një

gjendje kur nuk ke asnjë dëshirë për të mëkatuar do të thotë të marrësh atë çfarë Davidi kishte kërkuar – një zemër të re dhe një frymë të patundur. (Psalmi 51:10)

Pali nuk ishte më i shqetësuar për shpërblimin. Pse ai duhet të shpërblehej për atë që e bën diçka aq të dobishme për veten e tij? Dhe nëse e kemi fjalën për konfliktin e vazhdueshëm, Zoti ia bëri të qartë që ai nuk dënohet për luftën shpirtërore që ka. (Romakëve 8:1)

Mjekët nuk dënojnë pacientët e tyre

Mjekët nuk dënojnë pacientët e tyre që luftojnë me sëmundjen. Ata e dinë që shërimi do kohë. Ata nuk presin nga pacienti i plagosur të vrapojë në shtëpi direkt pas vizitës së parë.


Zoti punon si një mjek me zgjuarsinë e pashoq. Ai mund të shpëtojë dhe të shërojë çdo person i cili ka besim tek Ai. Ai nuk është aspak i kënaqur kur vijmë në zyrën e Tij vetëm për të marrë faljen. Ai propozon të na sjellë në gjendjen kur nuk do të kemi më nevojë të kërkojmë faljen. Ai na ofron të shërojë atë vend me të cilin mendojmë. Atëherë nuk do të shkelim më ato rregulla sepse nuk do të kemi më dëshirë t'i shkelim ato. Kështu të gjitha zakonet e këqija do të jenë të kaluara.

Për disa kjo tingullon si përsosmëri. Dhe për shumë besimtarë-shërbëtor kjo është pa tjetër një kërkesë e lodhshme. **“Duhet të jeni të përsosur”** është përkthim i shkëlqyeshëm të Goodspeed tek Mateu 5:48. Shërbëtorët shikojnë këto fjalë si një urdhër.

Kurse miqtë i shikojnë ato si premtim. Miqtë nuk dëshirojnë që Zoti të kërkojë diçka më pak se sa përsosmëria. A do t'i kërkonit mjekut që të mos ju shërojë plotësisht? A do të thoni: “75% e shëndetit më mjafton, faleminderit”?

Kërkesë apo ofertë bujare?

Për shërbëtorët, të cilët mendojnë që shpëtimi është zgjidhje të problemeve ligjore, përsosmëria është një tjetër kërkesë. Kurse për miqtë, të cilët e kuptojnë shpëtimin si shërim të dëmit të shkaktuar nga mëkati, përsosmëria është një ofertë jashtzakonisht bujare.



Shërbëtorët dëshirojnë të marrin faljen e plotë. Kurse miqtë duan shërimin e plotë.

Krishti nuk erdhi vetëm për të falur mëkatin. Ai erdhi për ta eliminuar atë. Siç shpjegon Pali, Zoti duke dërguar Birin e Tij “denoi mëkatin,” (NRSV) (Romakëve 8:3) ose “eliminoi mëkatin.” (Romakëve 8:3 GNB)

Falja nuk eliminon mëkatin. Mëkati nuk është diçka i shkruar në një libër për t'u falur herë pas here. Mëkati është diçka që ndodh brenda njerëzve. Mëkati është rebelimi dhe mosbesimi. Kjo është ajo që Krishti erdhi për ta eliminuar. Dhe antihelmi kundër mëkatit është e vërteta rreth Zotit.

“Edhe nëse flasim rreth përsosmërinë,” Mjeku hyjnor mund të therras nga mbrapa ndërsa po largohemi nga zyra e Tij. “Mos ki mërak fare për këtë. Unë e kam dizenuar universin në mënyrë që sipas ligjit njerëzit të bëhen të ngjashëm me atë peson që ata adhurojnë dhe admirojnë. Nëse mbeten miqtë e mi të besueshëm, përsosmëria do t'ju ndjek nga pas. Nuk po them që nuk do të keni më luftë. Por ajo nuk do të jetë më njësoj si përpara.”

Shërbëtorët luftojnë për ta mundur mëkatin duke u përpjekur ta fshijnë atë nga jetët e tyre. Miqtë e dinë që ata mund ta shtyjnë mëkatin përjashta vetëm duke e mbushur jetën e tyre me të vërtetën.

13. MIQËSIA DHE DOMËTHËNIA E SHLYERJES

Kohët e fundit mora një ftesë për një mbledhje fetare, qëllimi i së cilës ishte për të diskutuar rreth mësimi të krishter për shlyerjen.

Nëse një prej këtyre ftesave do t'i dërgoheshe Palit, ai do të ishte i habitur rreth temës së diskutimit.

“Çfarë do të thotë fjala ‘shlyerje?’ ” ai mund t’ju pyeste.

“A s’te kujtohet, Pal? Këtë fjalë e ke përdorur në letrën e drejtuar Romakëve.”

“Jo, nuk më kujtohet.”

“Po, po, nuk të them që ke përdorur fjalën shqipe.

E kam fjalën për fjalën grek të cilën ne e kemi përkthyer si ‘shlyerje.’ ”

“Epo,” thotë Pali, “ndoshta do të më kujtoheshe nëse përmendni vendin ku, sipas juve, e kam përdorur këtë fjalë.”

“Është në çerekun e dytë të letrës. Ne i kemi ndarë letrat e tua me kapituj dhe vargje, për të gjetur më lehtë citatin e duhur. Ne e quajmë këtë citat Romakëve 5:10, 11.”

“Ne ishim armiq të Zotit,” Pali fillon të përkthejë nga greqishtja, në ngjashmëri me përkthimin e *Good News Bible*, **“por Ai na bëri miqtë e Tij nëpërmjet vdekjes së Birit të Tij. Tani që jemi miqtë e Perëndisë, aq më shumë do të shpëtohem me anë të jetës së Krishtit! Por kjo nuk është gjithçka; ne gëzohemi për atë që Perëndia ka bërë nëpërmjet Zotit tonë Jezus Krisht, i cili tani na ka bërë miqtë e Perëndisë.”** (Romakëve 5:10,11)

“Ja, ku është vargu,” ju po ndërprisni Palin. “Ja, ne fund, ku lexove ‘i cili tani na ka bërë miqtë e Perëndisë.’ Ai është vendi ku e ke përdorur fjalën greke për shlyerje.”

“Jo, ajo fjala e thjeshtë me domëthënie ‘pajtim,’ ” korigjon Pali. “Dhe unë e ‘ngroha’ pak atë fjalë duke e përkthyer atë si ‘të miqësohem.’ ”

“Por,” vazhdon Pali, “nëse fjala juaj ‘shlyerje’ faktikisht do të thotë ‘pajtim’ ose ‘të bëjë miq’, mund ta përdor atë herë tjetër duke e përkthyer këtë tekst të letrës së Romakëve.

Më thuaj, miku im, çfarë kuptim në të vërtetë ka fjala ‘shlyerje?’ ”

Çfarë do të thotë “shlyerje”?

Nëse *King James Version* nuk kishte zgjedhur të përdorte fjalën “shlyerje” (“atonement”) tek Romakëve 5:11, ne nuk do të kishim këtë pyetje. Faktikisht, ky është i vetmi vend ku shfaqet fjala shlyerje në gjithë Dhjatën e Re të *King James Version*. Dhe pranë vargut redaktorët kanë shtuar një shënim duke i kujtuar lexuesit që në origjinal kjo është një fjalë e thjeshtë me domëthënie “pajtim”.

Nëse doni në të vërtetë të gjeni domëthënie origjinale të fjalëve në anglisht, shikoni tek fjalori *Oxford English*. Atje do të gjeni zhvillimin historik të fjalëve dhe domëthëniet e tyre.

Vëllimi i parë na shpjegon që fjala “atonement” (shlyerje) u krijua nga tre pjesa: “at”, “one” dhe “ment.” At-one-ment. Ky fjalor i madh na tregon se si në shekullin e 13 fjala “atonement” u përdor me domëthënie “të jesh një,” “të jesh në harmoni,” e kundërta të “të jesh në konflikt.”. Dhe folja “to atone” në ato ditë kishte kuptimin “të bëjë një,” “të bashkojë.”

Paqëbërësit akoma përpiqen të bashkojnë armiq të bëjnë ata një.

Ndryshimet e mëvonshme të fjalës

Të gjithë fjalorët bien dakort që domëthënia origjinale për “shlyerje” ose “atonement” ishte “harmonia, marrëveshje, pajtim, bashkim.”

Dhe folja “to atone” ka patur domëthënie “të restaurosh marrëdhënien miqësore midis personave të cilët kanë qenë në grindje ose në mosmarrëveshje, dmth. të pajtojë.”

Megjithatë sot këto domethënie janë parë si arkaike dhe të dala nga përdorimi. Por mbani mend që në vitin 1611, kur komiteti i Mbretit Xhejms vendosën të përdorin fjalë “atonement” tek Romakëve 5:11, ata e kuptuan atë në domethënien e vjetër ose arkaike.

Me kalimin e kohës fjalë “atonement” u përdor më shumë me domethënien “zbutje, të shlyej gabime, të paguajë gjobën për të kënaqur kërkesa ligjore.”



Siç komenton Oxford English Dictionary: “Këtu ideja e pajtimit ose ribashkimit është praktikisht e humbur në dritën e ligjit dhe gjobave.”

Edhe sot ne shpesh herë përdorim fjalën “të atone” me domethënien të shlyesh fajin me anë të gjobave ose ndonjë penaliteti tjetër.

Për shembull, imagjinoni sikur burri vjen në shtëpi me vonesë dhe nuk mund të sjellë nusen në restorant siç i ka premtuar asaj – për përjetorin e tyre të martesës! Gjatë rrugës ai në deshpërim blen çokolatat e saja të preferuara dhe një tufë të madhe me trëndëfila të bukur. Këto dhurata ai i penduar ia prezanton nuses tek dera. (Në teologji kjo quhet *zbutje* ose *pajtim* – në anglisht - *propitiation*).

Pas mundimeve të shumta, ai rikrijon të paktën ndonjë nivel komunikimi me nusen. Atëhere nusja ofron një zgjidhje. “O burr,” shpall ajo, “ti mund të shlyesh fajin tënd duke më sjellë mua në restorant çdo të hënë deri në fund të këtij viti.”

Ja, kjo është shlyerja në kuptimin e sotshëm të kësaj fjale. Dhe ka shpresë që kjo shlyerje do të përfundojë si ribashkim i burrit dhe gruas. Bashkim ose unitet është kuptimi origjinal i fjalës “atonement”, e cila tani përkthehet si shlyerje.

Çfarë ka thënë Jezusi rreth shlyerjes?

Kur dikush më pyet se çfarë mendoj rreth kuptimit të shlyerjes, nganjëherë i them: “Më pëlqen ajo çfarë ka thënë Krishti rreth saj.”

“Por Krishti kurrë nuk ka folur rreth shlyerjes, apo e kam gabim?”

Unë bie dakort që Krishti kurrë nuk e ka përdorur këtë fjalë – as ndonjëri tjetër tek Shkrimet, duke përfshirë Palin. Por besoj që Krishti kishte shumë për të thënë rreth shlyerjes. Pa tjetër, nëse e kuptojmë atë fjalë në domethënien “arkaike” – si pajtim dhe miqësi. Ja, për shembull, çfarë Ai i tha Atit të Tij në lutjen e famshme tek Gjoni 17.

“Tani unë nuk lutem vetëm për ta,” Jezusi u lut për dishepujt e Tij, “por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre, që të gjithë të jenë një.” (Gjoni 17:20,21) Ja, ky është pajtim ose unitet. **“Ashtu si ti, o Atë, në mua dhe unë në ty që edhe ata të jenë një në ne,”** vazhdoi Jezusi.

Çfarë do të thotë të jesh “në dikë”? Nëse Jezusi është në mua dhe unë jam në Të, dhe Ai është në Atin dhe Ati është në Të – dua të kuptoj cili është në cilin ose a në të vërtetë dikush është brenda tjetrit?

Të jesh “në” ndonjë person tjetër është kuptuar nga shumë veta si “unitet me,” dhe shpesh herë ashtu edhe përkthehet. Uniteti që Zoti deshiron me miqtë e Tij është aq i ngushtë sa ajo ngjan sikur të jesh “në” njëri-tjetrit. Edhe pse jemi persona individual, mund të jemi në një unitet aq të ngushtë me njëri-tjetrin sikur të jemi një.

Marrëdhënia midis Atit dhe Birit në Bibël prezantohet si modeli themelor i pajtimit ose unitetit (at-one-ment). **“Dhe unë u kam dhënë atyre lavdinë që më ke dhënë,”** Krishti u lut Atit të Tij, **“që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një.”** (Gjoni 17:22)

Sa kushtoi pajtimi?

Disa herë Krishti shpjegoi se sa do të kushtonte të pajtonte universin e Tij, familjen e Tij në unitet. Ai përdori fjalën që nganjëherë përkthehet si “shpërblësë,” ose “haraç.” (Mateu 20:28) Atëherë Ai tregoi se sa do t’i kushtonte ajo.

“ ‘Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t’i tërheq të gjithë tek unë.’ (Por Ai i thoshte këto për të treguar nga ç’llojë vdekjeje duhet të vdiste.) ” (Gjoni 12:32,33)

“Unë do t’i tërheqë të gjithë tek unë,” tha Krishti. Jo vetëm qëniet njerëzore por edhe engjëjt janë tërhequr më afër në unitet me Zotin kur ata meditojnë rreth kuptimit të kryqit.

Pali ra dakort me këtë kuptim. Ai foli rreth planit të Zotit “**të përmbledhë të gjitha gjërat në Krishtin, edhe ato që janë në qiej edhe ato që janë mbi dhe.**” (Efesianëve 1:10)

Në një tjetër letër Pali shpjegoi që: “**Atit i pëlqeu... përmes Tij (Krishtit) t’i pajtojë të gjitha me veten e Tij; pasi bëri paqe, përmes gjakut të Tij në kryq; përmes Tij, si ato mbi tokë, si ato në qiej.**” (Kolozianëve 1:19, 20)

Paqe në univers

Në çfarë kuptim universi ka nevojë për sakrificën e Krishtit që sjell paqe? A ka patur familja qiellore e Zotit ndonjë rrezik uniteti?

Për ata të cilët janë të aftë të marin seriozisht librin e fundit të Biblës – Zbulesa 12 tregon rreth luftës që filloi në Qiell.

Nga Zanafilla deri në Zbulesë mund të lexojmë rreth shkaqeve dhe pasojave të kësaj lufte, dhe pse nevojiteshe vuajtja dhe vdekja e Krishtit për të fituar luftën dhe për të themeluar paqen në përjetësi.

Familja e Zotit ka qënë në unitet para se të fillonte lufta. Në ato ditë të gjithë fëmijët e Zotit kishin besim tek njëri-tjetri. Secili prej tyre kishte besim në Atin e tyre Qiellor, dhe Ai kishte mundësi t’i besonte atyre. Dhe ku ka besim reciprok dhe besueshmëri, ka edhe paqe, harmoni dhe unitet.

Çfarë shkoi gabim?

Fatkeqësisht lind një konflikt i mosbesimit deri në pikën e rebelimit të hapur dhe në luftë. Përçarja dhe mosmarrëveshja zuri vendin e unitetit dhe harmonisë. Kështu lindi mëkati në univers. Siç shpjegon Gjoni,



mëkati është shkelje e ligjit dhe rebelim. (1 Gjonit 3:4) Ose, siç e përshkruan Pali, mëkati është besimi i thyer. (Romakëve 14:23)

Qëllimi i planit të shpëtimit ishte të restaurohej ky besim, t’i jepej fund rebelimit dhe kështu të themellojë paqen edhe një herë në të gjithë universin. Të gjithë fëmijët e Zotit janë të përfshirë në këtë luftë në mënyrë të pashmangshme.

Disa e shikojnë këtë si një zhgënjim ose madje si ofendim, kur mësojnë që Krishti nuk vdiq kryesisht vetëm për ta. Por nëse Zoti nuk e fiton këtë luftë dhe nuk restauron paqen në familjen e Tij, shpëtimi jonë nuk ka kuptim. Kush do të dëshironte të jetojë përjetësisht në një univers në luftë?

Pa këtë kuptim të gjërë të konfliktit, që përfshin të gjithë universin, është e vështirë të kuptojmë shpjegimin e Palit që Krishti derdhi gjakun e Tij për të sjellë paqe, pajtim, dhe unitet tek të gjithë fëmijët e Zotit si në tokë, si në tokë. Kurse njohja rreth luftës dhe çështjeve të saj na ndihmon të shikojmë më gjërë pamjen e kryqit dhe planin e shpëtimit dhe pajtimit.

Uniteti të cilën dëshiron Zoti nuk urdhërohet e as nuk lind nga frika ose detyrimi. Gjatë historisë njerëzore shumë despotë janë përpjekur të mbajnë unitetin me anë të vrazhdësisë dhe terrorit. Por ky lloj uniteti nuk zgjat për shumë kohë. Ju e dini shumë mirë se çfarë ka ndodhur në disa shtete brenda viteve të fundit.

Harmonia që dëshiron Zoti është përshkruar në Dhjatën e Re si “**uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë.**” (Efesianëve 4:13) Njerëzit të cilët duan dhe besojnë në të njëjtin Jezus dhe në të njëjtin Zot, janë natyrisht të tërhequr nga njëri-tjetri. E njëjta e vërtetë rreth Zotit që i çliron ata nga tirania dhe frika, i bashkon ata në unitet më të ngusht. Miqtë e një Zoti miqësor shijojnë unitetin me njëri-tjetrin.

Ja, ku kuptimi i kryqit ka aq shumë rëndësi. Ku ka frikë, nuk ka miqësi as unitet. Kryqëzimi na tregon që nuk kemi pse të frikësohemi prej Zotit. Kur Zoti thotë: “Ji miku im,” Ai nuk thotë: “Ji miku im ndryshe do të të ndëshkoj, do të vras.” Ju nuk flisni kështu me miqtë të tu, apo jo — sidomos kur dëshironi të vazhdoni miqësinë tuaj. Dhe pikërisht miqësia është qëllimi dhe kuptimi i pajtimit.

Pajtimi do të thotë të miqësohemi

Pali e përmbledh këtë në një mesazh të bukur drejtuar besimtarëve në Korint. Ky mesazh bëhet edhe më i rëndësishëm, nëse mësojmë që Pali, kur shkruajti këtë letër, sapo kishte kaluar një periudhë të gjatë dhe të dhimbshme të urrejtjes dhe mosbesimit nga ana e Korintasve. Por përpjekjet e tij për pajtim më në fund dolën me sukses. Në gëzimin e unitetit të restauruar, Pali shkroi:

“Prandaj nëse dikush është në Krishtin, është një krijesë e re; të gjitha u bënë të reja. Por të gjitha janë nga Perëndia që përmes Jezu Krishtit na shndërroi nga armiq në miq të Tij dhe na dha detyrë t’i bëjmë edhe të tjerët miqtë e Tij. Mesazhi ynë është që Zoti e bëri të gjithë njerëzimin mik të Tij nëpërmjet Krishtit. Zoti nuk ua llogariti atyre fajet e tyre dhe na ka dhënë mesazhin që thotë që Ai i bën ata miqtë e Tij. Jemi pra ambasadorë të Krishtit, sikur Perëndia t’ju lutej nëpërmjet nesh; ju lutemi në vend të Krishtit: lejoni Perëndinë t’ju shndërrojë ju nga armiq në miq të Tij. (2 Korintasve 5:17-20)

Në këtë tekst, fjala që kemi përkthyer si “të miqësohesh,” ose “të shndërrojë në miq,” është fjala greke shpesh herë e përkthyer si “pajtim”—pikërisht kjo fjalë në *King James Version* është përkthyer si “shlyerje.”

Domëthënë – unë mund të kthehem në shtëpi?

Një prej shëmbëlltyrave më të famshme të Zotit ishte rreth pajtimit. Krishti na tregoi rreth një djali i cili e harxhoi kot jetën e vet dhe trashëgimin e pronës së të atit në kënaqësitë vet-shkatërruese. Tani pa asnjë kokërr leku në xhep, duke vuajtur urie, ai gjeti punë si bari derrash.

Atje në stallën e derrave ai filloi të kujtojë se sa mirë ishte në shtëpi dhe të mendojë si të gjente mënyrën se si të bindte atin e tij të ofenduar ta lejonte atë që të jetojë sërish atje.

Mendimet e tij do të ishin shumë ndryshe nëse ai do ta dinte që ati përditë vëzhgonte rrugën duke shpresuar ta shikonte atë duke u kthyer për në shtëpi. Fatkeqësisht, biri nuk e njihje atin mjaft mirë.

Ai filloi të gjejë mënyrën se si t’i mbushte mendjen atit që të hapte derën e shtëpisë për atë. Ati i tij mund të ishte shumë i zemëruar me atë.

Ndoshta më mirë të flasë së pari me nënën dhe ajo mund të më ndihmojë të bind atin të më fali dhe që të më jap edhe një mundësi tjetër.

Dhe patjetër, gjithë ato lekë që kam harxhuar kot. Unë do të kem nevojë të gjejë ndonjë mënyrë se si t’i ripaguj ato.

“Unë e di se çfarë do bëj,” vendosi biri. “Unë do t’i kërkoj atij të më trajtojë si një prej shërbëtorëve të tij.” Kështu ai u nis për në shtëpi duke e përsosur fjalimin e tij gjatë rrugës.

Nëse ai do të kishte ngritur kokën, ai do të kishte parë atin duke vëzhguar rrugën për atë. **“Por kur ishte ende larg, i ati e pa dhe pati dhembshuri; u lëshua vrap, u hodh mbi qafën e tij dhe e puthi.**

“Dhe i biri i tha: ‘O atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje dhe nuk jam i denjë të quhem biri yt.’

“Por i ati u tha shërbëtorëve të vet: ‘Sillni këtu rrobën më të mirë dhe vishjani, i vini një unazë në gisht dhe sandale në këmbë. Sillni viçin e majmur dhe thereni; të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im ishte i vdekur dhe u kthye në jetë, ishte i humbur dhe u gjet.’ ” (Luka 15:20-24)

Më në fund biri mësoi të vërtetën rreth atit të tij. Ai ende nuk kishte mbaruar fjalimin e tij të përgatitur. Ati i tij e kishte falur shumë kohë më përpara. Por ai nuk kishte ardhur në shtëpi për ta zbuluar atë. Tani falja e atit e drejtoi atë në pendim të vërtetë.

Ndërsa djali plangprishës qëndronte në përqaftimin e atit, ai filloi të përjetojë pajtimin në kuptimin origjinal të fjalës.

Shërbëtoret e kuptojnë pajtimin si korrigjim. Miqtë e kuptojnë pajtimin si miqësinë e rikrijuar.

Vëllai i madh ishte vetëm një shërbëtor

Kur vëllai i madh dëgjoi zhurmën e festës, ai e kundërshtoi se kjo gjë ishte shumë e padrejtë.

“‘Ja,’ ” ai iu ankua atit të tij, “‘kaq vite po të shërbej dhe kurrë s’kam shkelur asnjë nga urdhrat e tu, e megjithatë kurrë s’më dhe një kec që të gëzohem me miqtë e mi. Por, kur erdhi ky djali yt, që prishi pasurinë tënde me kurva, ti there për të viçin e majmur!’ ”

Atëherë i ati i tha, ‘O bir, ti je gjithmonë me mua, dhe gjithë të miat janë të tuat. Por duhet të festojmë dhe të gëzohemi, sepse ky vëllai yt ishte i vdekur, dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet.’ ” (Luka 15:29-32)

Në merakun e tij për drejtësinë vëllai i madh refuzoi të marrë pjesë në festë. Dhe shëmbëlltyra nuk na tregojnë nëse ai ndryshoi mendje.

14. KEMI NDEJUR MJAFTË AFËR KËTIJ MALI

Mali Sinai është i famshëm për Dhjetë Urdhërimet që Zoti ia paraqiti bashkë me shumë rregulla të tjera për të cilat Ai e dinte që njerëzit kishin nevojë. Pasi populli ishte udhëzuar mirë e mirë, Zoti i tha atyre, që erdhi koha për të vazhduar udhëtimin. **“Ju keni ndenjur mjaftë afër këtij mali; çoni çadrat, vihuni në lëvizje.”** (Ligji i Përtërirë 1:6,7)

Populli i Izraelit kishte nevojë të ndalonte tek mali. Ata kishin nevojë për të gjitha rregullat dhe udhëzimet, madje edhe për “fjalët e errta” të ritualëve dhe ceremonive. Ata kishin nevojë për vetëtimë dhe bubullima ashtu siç kishin nevojë edhe për mrekullira të ujit dhe “bukës së engjëjve”. Dhe Zoti i cili i drejtoi ata në Sinai ishte i njëjti i cili më vonë në sallën e sipërme shpjegoi: “Unë parapëlqej që të jeni miqtë e mi.”

Kur Israeli më në fund hyri në Kanaan, ata morën me vete pllakat e Dhjetë Urdhërimeve. Ah sikur ata të kishin jetuar sipas këtyre ligjeve të dashurisë, atëherë Toka e Premtuar do të bëheshe një vend jashtzakonisht i sigurt dhe i këndshëm për të jetuar.

Por ama shumë shpejt njerëzit filluan të injoronin Urdhërimet e Zotit. Dhjata e Vjetër thotë rreth kësaj kohe: “Secili bënte atë që i dukej e drejtë në sytë e tij.” (Gjyqtarët 21:25, shih. Edhe Gjyqtarët 17:6) Disa prej gjërave që ata bënë na tmerron gjatë leximit të librit të Gjyqtarëve.

Shumë veta e harruan Atë i cili i kishte shpëtuar nga skllavëria e Egjiptit dhe u kishte premtuar të ardhmen e shkëlqyer në tokën “ku rrjedh qumësht dhe mjaltë.” (Eksodi 3:8) Madje disa udhëheqës u kthyen sërish tek idhujtaria.



Në mes të Dhjetë Urdhërimeve Zoti kishte përfshirë një rregull të dizenuar për të ndihmuar popullin e Tij të mos harrojë Krijuesin dhe Shpëtimtarin e tyre, dhe t'i kujtojë të gjitha gjërat që Ai ka bërë për ta. Ky ishte ligji i Sabatit javor.

Fatkeqësisht, shërbëtorët kishin tendencë që të shikonin këtë ligj si një kërkesë veçanërisht të mundimshme. “Ti nuk do të bësh asgjë të këndshme në ditën e së Shtunës,” ishte mënyra se si ata e lexuan këtë rregull.

Madje edhe sot disa nga shërbëtorët e përshkruajnë pushimin e së Shtunës si një kërkesë arbitrare, e cila vetëm tregon autoritetin e Zotit dhe vë në provë gadishmërinë tonë për t’iu bindur Atij.

Por Krishti erdhi për të na treguar që nuk ka asgjë arbitrare tek Zoti. Siç shpjegonte Pali, ligjet e Zotit u shtuan për të na ndihmuar, për të na mbrojtur në injorancën dhe papjekurinë tonë, dhe për të na çuar sërish në besim. Kjo duhet të jetë e vërteta edhe rreth Sabatit javor.

Fatmirësisht, miqtë e Zotit na kanë shpjeguar qëllimin e këtij ligji. Isaia madje thotë që nëse nuk kënaqemi në ditën e së Shtunës, nuk jemi duke e mbajtur atë në të vërtetë gjithsesi! (Isaia 58:13)

Është e qartë që zbatimi i së Shtunës nuk urdhërohet as nuk detyrohet. “Kënaquni në ditën e së Shtunës ndryshe do t’ju ndeshkoj!” Një urdhër e tillë nuk ka kuptim. Nëse fëmija juaj nuk e ka qejf spinaqin, a do ta detyronit atë të thoshte: “Sa i shijshëm është ai!” ndryshe do ta dënonit?

Por çfarë jep kënaqësi në mbajtjen e së Shtunës javore? Nëse lexojmë pjesën tjetër të Biblës, gjejmë disa arsye shumë të rëndësishme.

Shërbëtorët të cilët bëjnë gjëra vetëm për shkakun që ata janë të urdhëruar, e shikojnë të Shtunën si një kufizim të lirisë së tyre — një kufizim të cilin një shërbëtor besnik është gati për ta pranuar.

Kurse miqtë e kuptojnë të Shtunën si një monument të miqësisë, një përmendore të themelit të lirisë dhe besimit.

Disa parapëlqejnë të qëndrojnë tek Sinai

Besimtarët-shërbëtorë kanë tendencë të zgjasin shumë qëndrimin tek Mali Sinai, duke gjetur udhëzime dhe siguri në kodin e madh të rrëgjullave dhe simbole të faljes dhe shpëtimit që u dhanë atje.



Disa shërbëtorë parapëlqejnë “fjalët e errta.” Ato i japin një sens misteri dhe frike e përzierë me nderim. Dhe kjo, më sa duket, u jep disa udhëheqësve fetare një ndikim dhe fuqi të vëçantë. Shërbëtorët më pak ditur i shikojnë ata si “administratorë të mistereve të Perëndisë.” (1 Korintasve 4:1)

Por “misteret” e Zotit nuk janë për t’u veshur me perçen e fshehtësisë, siç praktikohej në fetë mistike që ishin shumë popullore në kohën e Palit. Sekretet e Zotit janë për t’u zbuluar plotësisht dhe për t’u bërë të njohur për të gjithë. (Kolosianëve 1:25,26) Në fakt, Dhjata e Re e përshkruan sekretin më të rëndësishëm të Zotit si “Vet Jezu Krishtin.” (Kolosianëve 2:2,3) Dhe Krishti nuk erdhi për të fshehur të vërtetën. Përkundrazi, ai erdhi për të na sqaruar atë sa më mirë.

Disa besimtarë i kujtojnë me mallë vetetimet dhe bubullimat e Sinait. “Ah sa mirë do të ishte,” kam dëgjuar disa duke thënë, “nëse Zoti do të ngrinte zërin e Tij edhe në kohën tonë të pabesë!”

Kurse miqtë kujtojnë që shpella, ku Zoti foli me Elian me “shushuritje të ëmbël”, gjithashtu ishte në Malin Sinai. (1 Mbretërve 19:8-13)

Nga shërbëtorë në miq

Unë njoh shumë veta të cilët kanë pranuar ofertën e Gjonit 15:15. Ata e shijojnë lirinë e miqësisë aq shumë sa shpesh herë flasin se si mund ta ndajë atë me njerëzit e tjerë. Sigurisht miqësia nuk dëtyrohet dot. Pali, duke qënë miku i Zotit, këshilloi: **“Gjithsëcili të jetë plotësisht i bindur në mendjen e vet.”** (Romakëve 14:5)

Çfarë mund të bëjnë miqtë është të inkurajojnë tjerët të konsiderojnë të njëjtën provë që ata e kanë gjetur shumë bindëse. Dhe kjo do të thotë të gjithë dëshmi – duke përfshirë edhe “aspekte mizore të Shkrimeve”. Shpesh herë imazhi i Zotit dhe i shpëtimit është bazuar në tekste të zgjedhura nga Bibla por jo në Biblën e tërë. “Pak nga kjo dhe një çik nga ajo,” thonë disa shërbëtorë besnikë. Por tekset e tjera?

Detaje të mbetura

Ka kuptim që dikush i cili pohon që pranon Biblën si burimi i besueshëm, duhet të ndërtojë kuptimin, modelin, filozofinë dhe imazhin ndaj Zotit dhe shpëtimit në përmbajtjen e të gjithë 66 libra në të. Nëse ka diçka në Bibël që nuk përputhet me modelin tim, atëherë është e qartë që e kuptoj gabimisht tekstin ose modeli im ka nevojë për zgjerim ose përmirësim.

Kur isha 16 vjeç, mora pjesë në klasën e automekanikëve në Kaliforni. Të gjithë student e kishin shumë për zemër mësuesin tonë të respektueshëm, zotin Grab. Ai na ndau në çifte dhe çdo çifti iu dha një makinë që kishte dal në pension.

Puna jonë ishte të çmontonim makinën, veçanërisht motorrin. Neve na duhej të gërvishnim shtyllat, pastronim kllapat dhe të bënim punë të tjera që ishin të zakonshme 55 vite më përpara. Pastaj na duheshe t’i montonim të gjitha detajet sërish së bashku.

Pas kësaj erdhi rradha e provimit. Nëse makina ndizej e kishim fituar provimin. Ndryshe . . . Në fakt, nuk më kujtohet se çfarë ishte alternativa, por makina jonë u ndez me një plasje dhe zhurmë si hungërimë. Disa studentë hipën në makinë dhe ne si fitimtarë bëmë një xhiro rreth lagjes.

Kishte vetëm një problem. Na kishin mbetur ca detaje. Por zoti Grab ishte shumë i mëshirshëm dhe na lejoi të kalojmë gjithësesi. Por unë patjetër nuk doja të udhëtoja me këtë makinë në asnjë mënyrë. Jo pa ato detaje të mbetura!

Para ca kohësh mora një studim të Biblës për Ungjillin e Gjonit. Një prej qëllimeve të pohuara të këtij botimi ishte, të inkurajojë njerëzit të lexonin Biblën si të tërë. Me interes të veçantë e hapa tek Gjoni 16:26 për të lexuar se çfarë do të thoshte ky studim për atë tekst. Ju kujtohet që ky është vargu ku Jezusi u thotë dishepujve të Tij “e hapur dhe e qartë” që Ai nuk do të ketë asnjë nevojë t’i lutej Atit për ne, sepse vet Ati na do fort.

Por nuk gjeta asnjë koment për këtë varg. As ndonjë shpjegim, pse ky varg ishte përjashtuar. Kur i shkrova dhe e pyeta me respekt për këtë çështje, autori më shpjegoi që nuk e gjeti mënyrën se si të përfshijë këtë varg në modelin tradicional. Kjo më kujtoi detaje të mbetura të makinës së gjimnazit.

Imazhi i Zotit në të gjithë 66 librat e Biblës

Gjatë vitëve që kam kaluar me privilegj të udhëheq studimet e Biblës nëpërmjet të gjitha 66 librave të Biblës, pikësynimi jonë i vetëm ka qënë – të zbulojmë imazhin e Zotit. Ne nuk e kemi harxhuar kohën duke debatuar se si Zoti vendosi dinozaurët në arkën e Noes! Por ne kemi bërë pyetjen – *çfarë llojë Zoti do t’i mbyste të gjithë njerëzit?*

Më kujtohet dita kur një shenjtorë 84 vjeç u ngre në këmbë para 300 vetave. “Dua t’ju them diçka,” ajo tha me një zë të prerë, “Unë e kam dashur Zotin gjatë gjithë jetës time. Por tani që kemi studiuar të gjithë 66 librat e Biblës, unë jo vetëm që e dua Atë, por tani Ai madje më pëlqen!”

Kënaqësi e veçantë ka qënë të studioje Biblën në tërësi me fëmijët. Ata janë shumë të çiltër në pyetjet dhe vëzhgimet e tyre.

Një pasdite sapo kishim arritur tek mësimi i Dhjatës së Vjetër rreth “sy për sy dhe dhëmb për dhëmb.” (Eksodi 21:24; Mateu 5:38-42) Lindi pyetja – pse Krishti tha që ne nuk duhet të veprojmë më kështu? Në vend të kësaj ne duhet të kthejmë faqen tjetër. Unë i pyeta fëmijët se çfarë do të bënin nëse dikush u thyente dhëmbin. Pas disa sugjerimesh tetë vjeçari Kejsi ndau vendim të menduar mirë.

“Së pari unë do t’i thyeja një prej dhëmbave të tij. Pastaj unë do të ktheja faqen tjetër!”

Në një tjetër rast ne ishim duke biseduar rreth përmendjeve të shumta në Bibël që Zoti do të shkatërrojë të pabesët. Unë i pyeta fëmijët nëse nënat e tyre u kanë thënë ndonjëherë: “Bëj atë që të them ndryshe të vrava?”

“Po!” gjithë grupi mu përgjigj me gëzim.



“Si mendoni, a e kanë seriozisht?” i pyeta.

“Sigurisht që jo,” mu përgjigj Tina e vogël. “Ne e dimë që kjo është thjeshtë një figurë letrare.”

“A mendoni që edhe Zoti përdor një figurë letrare?” vazhdova me pyetjen tjetër. Ata pohuan që nuk mendojnë kështu. “Atëherë a do të thotë kjo që nënat tuaja ju duan më shumë sesa Zoti?”

Pas një pauzë të gjatë Kejsi ishte i vetmi që theu heshtjen. Pasi ai i kishte konsideruar nënkuptimet serioze, gjithçka që ai mund të thoshte ishte: “Uaaa!”

Unë mund t’u thoja fëmijëve që zgjidhja më e mirë për këto probleme është thjeshtë të ndalojmë të pyeturit dhe të kemi besim tek Zoti. Por ky, sigurisht, do të ishte fundi i udhëtimit tonë nëpër Bibël. Fëmijët e zgjuar lodhen shumë shpejt kur të rriturit e mirëinformuar i tregojnë se në çfarë ata duhet të besojnë.

Por jam i sigurt që Zoti kënaqet duke i dëgjuar fëmijet duke folur rreth Atij ashtu siç kemi folur në grupin tonë. Dhe pikërisht liria – dhe siguria – të flasin sinqerisht rreth Zotit i inkurajoi ata të vazhdojnë leximin e

libri pas librit nëpër të gjithë 66 librave të Biblës.

Faleminderit për të gjitha 66

Në udhëtimin e fundit për në Britani, dëgjova rreth një vajzë të vogël me emrin Leilani, e cila i kishte shkruar letra Zotit. Unë gjithashtu mesova që pavarësisht nga mosha e saj e vogël, ajo kishte lexuar që të gjitha librat e Biblës. Ajo kishte vendosur që Zoti i përshkruar në të gjitha 66 librat e Biblës është një Person shumë i veçant.

Prandaj ika në Skoci për të takuar atë. Në kopshtin e saj të shtëpis në Edinburg Leilani lexoi disa prej letrave të saj. “Kjo është e preferuara ime,” më tha ajo.

I dashur Zot,

*Faleminderit që më ke krijuar, dhe faleminderit për të gjithë 66 librat —
39 në Dhjatën e Vjetër dhe 27 në Dhjatën e Re — kështu që ne mund të mësojmë më shumë rreth Teje.*

*Mikja Jote,
Leilani.*

P.S. Ne të gjithë e dimë që Bibla është e vërtetë.

15. MIQTË TË NJË ZOTI MIQËSOR

Në Anglinë Veriperëndimore, afër kufijve të saj me Skocinë, jeton një bari i fort por i dashur. Ne dëgjuam që ai sapo ishte bërë i krishterë. Prandaj e vizituam për të zbuluar se çfarë e bëri atë të marri këtë vendim. Kështu e pyeta se çfarë i mbushi mendjen atij të bëhej besimtar.

“Ishte shoqja ime Alisa,” tha ai duke tundur kokën drejt një gruaje me fytyrë jashtëzakonisht miqësore.

“Na tregoni se çfarë bëri ajo,” e pyeta.

“Ah, ajo thjeshtë me mori në një udhëtim nëpër të gjithë Biblën dhe doli që ky libër kishte kuptim.”

Një prej shenjave të miqësisë së vërtetë me Zotin është xhelozia për reputacionin e Mikut tonë Qiellor. Abrahami, Moisiu dhe Jobi të gjithë treguan besnikëri të tillë. Kështu edhe Alisa. Ajo donte që njerëzit të shikojnë Zotin ashtu siç Ai është dhe kjo fitoi zemrën e bariut.

E kam vënë re që miqtë e Perëndisë janë veçanërisht të interesuar që fëmijët e tyre të shikojnë Zotin si Mikun e tyre më të mirë. Pasi kisha vizituar shumë kisha të boshatisura në Britani, erdha tek një në Londër e cila, sipas fjalëve, ishte e mbushur plotë-e-për-plotë çdo javë. Katër vajza më lejuan të bisedoja me ta pas adhurimit.

“Kur do të shkoni në Qiell, kë dëshironi të takoni së pari — Zotin Atë apo Jezusin, Birin e Tij?”

Pa hezitim një prej vajzave mu përgjigj: “Nuk ka asnjë ndryshim. Krishti ka thënë: **‘Nëse më keni parë mua, e keni parë edhe Atin.’**”

Besoj që patjetër ndonjë mik i Perëndisë e ka ndihmuar këtë vajzë të zgjuar të arrijë në këtë pikëpamje.

Kur pyes se çfarë duhet të bëjmë për të sjellë njerëzit e hutuar sërish në kishë, disa thonë që skeptikët e tillë duhet të mësojnë se si të mos bëjnë pyetje të shumta por të shfaqin më shumë besim. Disa madje shtojnë paralajmërimin nga Hebrejve që: **“Pa besim nuk mund të fitosh pëlqimin e Zotit.”** (Hebrejve 11:6) Mua kjo më duket si muhabet i shërbetorëve. Dhe pikërisht ky qëndrim ka kthyer shumë njerëzit në botë kundër Zotit.

Miqtë e Perëndisë do të dëshirojnë të kuptojnë pse njerëzit si Lorena dhe familja e saj ndjejnë që mësimet e krishterë nuk kanë më kuptim? Kemi patur shumë shprehje të errta duke folur rreth Zotit dhe shpëtimit. Nëse Jezusi jetonte me ne, Ai do të shkonte dhe do të fliste qartë dhe haptas me Lorenën dhe familjen e saj, me kasapin Beri, me varrmihësin dhe me motoçiklistët. Ata si fëmijët e Zotit meritojnë një shans për ta kuptuar.

Është privilegji jonë i madh që ne si miqtë e Perëndisë shërbejmë si ndërmjetës për njerëz të tillë, ashtu si Moisiu shërbente për popullin e Izraelit.

Kur e pyeta një nxënës të krishter se çfarë duhet të bëjmë për njerëzit si Lorena, ai mu përgjigj pa hezitim: “Thjesht tregoni historira rreth Jezusit.”

Të tregojmë rreth Jezusit është të tregojmë rreth sallës së sipërme dhe çfarë u tha dhe u bëri Zoti atje dishepujve të Tij. Kjo do të thotë të shpjegojmë që Zoti nuk vlerëson asgjë më shumë sesa lirinë dhe miqësinë e fëmijëve të Tij kudo që të jenë.

Të tregojmë rreth Jezusit do të thotë të inkurajojmë njerëzit të pyesin *më shumë* pyetje, jo më pak. Sigurisht, jo pyetjet qesharake dhe banale, por për të zbuluar të vërtetën rreth Zotit. Ata që dëshirojnë të flasin për Zotin duhet të jenë të parët që inkurajojnë njerëzit që të pyesin.



Të ndjekim shembullin e Krishtit do të thotë t'u japim njerëzve liri për t'i thënë me respekt madje predikuesit më të arsimuar: “Unë nuk e kuptoj se çfarë thatë rreth Zotit. Më fal që po ju them këtë, por predikimi juaj ishte “fjalë të errta” për mua.”

Të ndjekim shembullin e Krishtit gjithashtu do të thotë të kemi shumë respekt për shërbëtorët. Nëse ata në frikën e tyre ndaj Zotit kanë nevojë për siguri që ata kanë një Mik ndërmjet tyre, miqtë e Perëndisë do të tregojnë që në fakt ata kanë një ndërmjetës të tillë miqësor. Ndoshta më vonë do të keni një shans për të shpjeguar që Miku midis tyre dhe Zotit është vet Zoti.

Për shërbëtorët komplimenti më i madh që ata dëshirojnë të dëgjonë nga Zoti është: “Të lumtë, shërbëtori im i mirë dhe besnik.” Kush mund të kërkojë më shumë?

Por për ata që kanë pranuar ofertën bujare të Gjonit 15:15, ka edhe një tjetër kompliment për t'u pritur: “Faleminderit, bijtë e Mi, që më thatë të vërtetën. Faleminderit që jeni miqtë e Mi.”